REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

ASCAP

# UDHËZUESI
# PËR PRAKTIKËN E PUNËS
# SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL
# SHKOLLOR

## (RISHIKUAR)

Qershor
2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

Nr.5261 Prot. Tiranë, më 26.08.2025

**URDHËR**

**Nr. 414, datë 26.08.2025**

**PËR**
**MIRATIMIN E "UDHËZUESIT PËR PRAKTIKËN E PUNËS SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL SHKOLLOR (RISHIKUAR)"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, pikës 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shkronjës "d" të pikës 5 të vendimit nr.98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar" (ASCAP) dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Orjana Osmani",

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e "Udhëzuesit për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor (rishikuar)" , bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. "Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor" miratuar me shkresën me nr.2116/6 prot, datë 27.07.2022, shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ORJANA OSMANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT - TIRANË

Dokumenti “Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor” u hartuan nga Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS).

**Hartimi i dokumentit u koordinua nga:**

Esion Zgjana

**Përgatitja e dokumentit:**

Rezarta Pullazi

Orsjola Miha

Anisa Asllanaj

Ornela Belba

Jona Hila

Ermilinda Zgjana

Lediona Asabella

Elediona Murati

**Redaktimi letrar:**

Zija Kurti

**Redaktimi shkencor:**

Esion Zgjana

Olta Jaçellari

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

# TABELA E PËRMBAJTJES

**TABELA E PËRMBAJTJES** .......... 2
**LISTA E MODELEVE** .......... 6
**SHKURTIME** .......... 7
**HYRJE** .......... 8
**PJESA E PARË** .......... 10
**FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË NIVEL SHKOLLE** .......... 10
**ROLI, DETYRAT DHE BASHKËPUNËTORËT E PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË SHKOLLA** .......... 11
Format e komunikimit me mësuesit, me drejtuesit dhe me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore .......... 14
Komunikimi që ka nevojë të dokumentohet .......... 14
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË PRINDIT NË SMIP** .......... 18
**KËRKESA PËR REFERIM TEK PUNONJËSIT E SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË SHKOLLË** .......... 20
**NDARJA E INFORMACIONIT ME PERSONAT E INTERESIT** .......... 22
Miratimi i informuar .......... 23
Ndarje e informacionit .......... 25
**PLANIFIKIMI VJETOR** .......... 27
Model i planit vjetor .......... 27
Matrica e raportimit për veprimtaritë e realizuara .......... 32
Analiza vjetore e punës për punonjësit e shërbimit psiko-social .......... 36
Vlerësimi i nevojave për shërbimin psiko-social .......... 41
Vlerësimi i nevojave për mësuesit .......... 41
Vlerësimi i nevojave për prindërit .......... 44
**ZHVILLIMI I VEPRIMTARIVE PARANDALUESE** .......... 46
Planifikimi i veprimtarive parandaluese .......... 46
Realizimi për veprimtaritë parandaluese .......... 47
Raportimi për veprimtaritë parandaluese .......... 49
**PLANIFIKIMI I VEPRIMTARIVE VLERËSUESE** .......... 51
Vlerësimi në kushtet e emergjencës .......... 51
Vlerësimi i nxënësve me Aftësi të Kufizuara (AK) .......... 51
Veprimet e punonjësit rast pas rasti .......... 52
**SHKALLA E VLERËSIMIT TË RISKUT PËR NXËNËSIT** .......... 56
Vlerësimi psiko-edukativ i nxënësit .......... 64
Formate për veprimtaritë vlerësuese .......... 68
**PLANIFIKIMI I NDËRHYRJEVE** .......... 85

PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES NË NIVEL IA-JE ... 85
PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES NË NIVEL KLASE ... 85
PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES NË NIVEL INDIVIDUAL ... 85

**PLANIFIKIMI I NDËRHYRJEVE PËR ÇRREGULLIME TË NDRYSHME ... 99**

PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES PËR ÇRREGULLIMET E ANKTHIT NË FËMIJËRI DHE NË ADOLESHENCË ... 99
FORMAT MË TË CILAT MUND TË SHFAQET ANKTHI TE FËMIJËT DHE TEK ADOLESHENTËT ... 100
*Ndërhyrja në kontekstin shkollor* ... 104
*Referimi* ... 107
PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES PËR TRAUMAT NË FËMIJËRI DHE NË ADOLESHENCË ... 108
*Format në të cilat mund të shfaqet trauma* ... 108
*Ndërhyrja në kontekstin shkollor* ... 112
*Referimi* ... 116
PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES PËR ÇRREGULLIMET SPECIFIKE TË TË NXËNIT NË FËMIJËRI DHE NË ADOLESHENCË ... 116
*Ndërhyrja në kontekstin shkollor për vështirësinë në të nxënë* ... 119
REFERIMI ... 126
ÇRREGULLIMET E SJELLJES DHE TË KONTROLLIT TË IMPULSIT ... 128
*Ndërhyrja në kontekstin shkollor* ... 130
*Referimi* ... 132
PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES PËR RASTET E BRAKTISJES SË SHKOLLËS ... 133
*Referimi* ... 137
PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES PËR RASTET E VARËSISË NË FËMIJËRI DHE NË ADOLESHENCË ... 137
*Shenjat me të cilat mund të shfaqen varësitë te fëmijët dhe tek adoleshentët* ... 138
*Ndërhyrja në kontekstin shkollor* ... 140
*Referimi* ... 144
PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES PËR RASTE ME ÇRREGULLIME HUMORI NË FËMIJËRI DHE NË ADOLESHENCË ... 144
*Format me të cilat mund të shfaqen çrregullimet e humorit në fëmijëri dhe në adoleshencë* ... 145
*Ndërhyrja në kontekstin shkollor* ... 145
*Referimi* ... 150
ÇRREGULLIMET E TË NGRËNIT ... 151
*Format me të cilat mund të shfaqen:* ... 151
*Ndërhyrja në kontekstin shkollor* ... 152
*Referimi* ... 155

**PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES PËR RASTET E DHUNËS ... 156**

*Format e dhunës* ... 156
*Roli dhe përgjegjësitë e institucioneve arsimore* ... 158
*Dokumentimi dhe menaxhimi i rastit* ... 159
*Referimi* ... 164
INSTRUMENTI PËR RAPORTIMIN INDIVIDUAL TË DHUNËS NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ... 165
INSTRUMENTI PËR RAPORTIMIN VJETOR TË DHUNËS NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ... 169

PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES PËR RASTET E BULLIZMIT NË SHKOLLË ..... 174
NDËRHYRJA NË KONTEKSTIN SHKOLLOR ..... 177
PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES DHE MENAXHIMI I KONFLIKTEVE NË SHKOLLË ..... 181
PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES PËR SITUATAT E EMERGJENCËS ..... 188
*Çfarë ndodh nëse një emergjencë natyrore ose civile përjetohet, ndërkohë që nxënësit dhe mësuesit janë në klasë? ..... 188*
*Grupi për menaxhimin e emergjencave (GME) ..... 190*
UDHËZIME TË DOBISHME PËR TË FOLUR ME FËMIJËT RRETH SIGURISË NË SHKOLLË ..... 190
NDËRHYRJA NË KONTEKSTIN SHKOLLOR ..... 192
NDIHMA E PARË PSIKOLOGJIKË NË MJEDISET E SHKOLLËS (NPP) ..... 196
KUR MUND TË JETË E NEVOJSHME NDIHMA E PARË PSIKOLOGJIKE? ..... 196
PARIMET KRYESORE PËR OFRIMIN E NPP ..... 198
KËSHILLA PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL: ÇFARË DUHET TË KEMI PARASYSH GJATË OFRIMIT TË NDIHMËS SË PARË PSIKOLOGJIKE? ..... 199
NDËRHYN ..... 201
REFERIMI ..... 202

**PLANIFIKIMI DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE PËR AFTËSINË E KUFIZUAR ..... 203**

*Ngritja e komisionit të ak-së në shkollë ..... 204*
*Funksionimi i komisionit të ak-së në shkollë ..... 206*
*Bashkëpunimi i komisionit të AK-së me drejtorinë e IA-së ..... 211*
*Vlerësimi periodik i nxënësve me AK ..... 212*
PUNONJËSI SHPSSH-SË NDËRHYN NË DY MËNYRA: ..... 218
REFERIMI ..... 221
REFERIMI PËR MBROJTJE ..... 221
REFERIMI PËR SHËRBIME ..... 222

**PJESA E DYTË ..... 226**

**FUNKSIONIMI I NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL ..... 226**

MONITORIMI I SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL ..... 227

**FUNKSIONIMI I PROCESIT TË SUPERVIZIMIT ..... 229**

DETYRAT DHE FUNKSIONI I SUPERVIZORIT TË NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL ..... 229

**VEPRIMTARIA E KOMISIONIT MULTIDISIPLINAR PËR AFËSINË E KUFIZUAR PRANË ZVAP-SË ..... 234**

**PJESA E TRETË–SHTOJCA ..... 236**

SHTOJCA 1: VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NGA DREJTORIA ..... 237
SHTOJCA 2: VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NGA DREJTUESI I NJËSISË ..... 240
SHTOJCA 3: LISTA E KONTROLLIT PËR VLERËSIMIN FILLESTAR TË SITUATËS SË NXËNËSIT ME SJELLJE RADIKALE/EKSTREMISTE ..... 244
SHTOJCA 4: LISTA E KONTROLLIT PËR VLERËSIMIN E SJELLJES SË NXËNËSVE ..... 247
SHTOJCA 5: LISTA E KONTROLLIT PËR REAGIMIN NDAJ KONFLIKTIT ..... 250
SHTOJCA 6: LISTA E KONTROLLI PËR RREGULLIMIN EMOCIONAL (MOSHA 6-11VJEÇ) ..... 252
SHTOJCA 7: LISTA E KONTROLLIT PËR SHPREHITË EMOCIONALE (MOSHA 12 - 15 VJEÇ) ..... 254

SHTOJCA 8: LISTA E KONTROLLIT PËR VLERËSIMIN FILLESTAR MBI PROBLEMATIKA TË HUMORIT TE FËMIJËT E GRUPMOSHËS 6-12 VJEÇ....256
SHTOJCA 9: VLERËSIMI I RISKUT PËR VETËVRASJE....259
SHTOJCA 10: INVENTARI I DEPRESIONIT I BECK-UT....262
SHTOJCA 11: GAD-7 (INSTRUMENT PËR VLERËSIMIN E ANKTHIT)....268
SHTOJCA 12: INTERVISTË E STRUKTURUAR PËR VLERËSIMIN E SIMPTOMAVE TË TRAUMËS....269
SHTOJCA 13: VETËVLERËSIMI TE FËMIJËT (ARSIMI FILLOR)....270
SHTOJCA 14: INSTRUMENTI I VETËVLERËSIMIT....272
SHTOJCA 15: VLERËSIMI I VARËSISË NGA INTERNETI....278
SHTOJCA 16: LISTA E KONTROLLIT PËR DUHANIN GRUPMOSHA 13-18 VJEÇ....281
SHTOJCA 17: VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË....283
*Çrregullimet gjuhësore* .... *284*
*Shkalla e vlerësimit për çrregullimet e të folurit:* .... *288*
*Çrregullimi i pragmatizmit të komunikimit* .... *290*
*Belbëzimi*.... *292*
*Çrregullimet e spektrit të autizmit* .... *294*
*Çrregullimet e inhibimit*.... *296*
*Çrregullimet në lexim*.... *298*
*Çrregullimet në shkrim* .... *301*
*Çrregullimet në matematikë* .... *303*
*Çrregullimet motore* .... *305*
*Çrregullimet e lëvizjeve stereotipike*.... *307*
SHTOJCA 18: KONTRATË BESIMI ME NXËNËSIN PËR NDRYSHIMIN E SJELLJES....309
SHTOJCA 19: PYETËSOR PËR KLIMËN NË SHKOLLË....311
SHTOJCA 20: GJENDJA PSIKO-EMOCIONALE (PËR NXËNËS)....317
SHTOJCA 21: PYETËSOR PËR PRINDËRIT....319
SHTOJCA 22: PYETËSOR PËR BULLIZMIN....321
SHTOJCA 23: PYETËSOR PËR MARRËDHËNIET ME BASHKËMOSHATARËT....324
SHTOJCA 24: PYETËSOR PËR SJELLJET E RREZIKSHME....326
SHTOJCA 25: PYETËSOR PËR PËRDORIMIN E INTERNETIT....328
**BIBLIOGRAFI.... 330**
***WEBLOGRAFI*....332**

# LISTA E MODELEVE

Modeli 1. Kërkesë për referim tek punonjësit e shërbimit psikosocial........................21
Modeli 2. Formati për miratimin e informuar nga prindi..............................................24
Modeli 3. Plani vjetor ......................................................................................................28
Modeli 4. Matrica e realizimit .........................................................................................33
Modeli 5. Analiza vjetore e punës së shërbimin psiko- social.......................................37
Modeli 6. Instrument për vlerësimin e nevojave (për mësues)...................................42
Modeli 7. Instrument për vlerësimin e nevojave (për prindër) ....................................44
Modeli 8. Struktura e planifikimit për veprimtaritë parandaluese ...............................47
Modeli 9. Struktura e raportimit për veprimtaritë parandaluese ................................49
Modeli 10. Shkalla e vlerësimit të riskut për nxënësit ..................................................58
Modeli 11. Vlerësimi psiko social i nxënësit ...................................................................61
Modeli 12. Vlerësimi psiko edukativ i nxënësit..............................................................65
Modeli 13. Harta sociale për klasën ................................................................................68
Modeli 14. Formulari për vëzhgimin e nxënësit ............................................................71
Modeli 15. Formulari për fokus grup...............................................................................73
Modeli 16. Raporti për aktivitetet vlerësuese ...............................................................75
Modeli 17. Formular për vizita në shtëpi........................................................................77
Modeli 18. Formular i vlerësimit të gjendjes sociale......................................................79
Modeli 19. Formulari i këshillimit në grup......................................................................86
Modeli 20. Formular i këshillimit/konsultimit individual ...............................................88
Modeli 21. Formular këshillimi/konsultimi me mësues/prindër ..................................90
Modeli 22. Formati i dosjes individuale AF/AMU...........................................................91
Modeli 23. Formati i dosjes personale AMU/AML .........................................................95
Modeli 24. Plani i ndërhyrjes për nxënësit me vështirësi në të nxënë......................126
Modeli 25. Instrumenti për raportimin individual të dhunës nga institucionet e arsimit parauniversitar........................................................................................165
Modeli 26. Instrumenti për raportimin vjetor të dhunës nga institucionet e arsimit parauniversitar ...............................................................................................169
Modeli 27. Relacion mbi menaxhimin e konfliktit........................................................184
Modeli 28. Formular për vlerësimin psiko-social në situatë emergjence................195
Modeli 29. Ngritja së komisionit për AK në shkollë.....................................................205
Modeli 30. Vendimi i komisionit AK në shkollë ...........................................................207
Modeli 31. Plani vjetor të komisionit AK......................................................................209
Modeli 32. Vlerësimi i ecurisë për nxënësit me AK.....................................................213
Modeli 33. Vlerësimi i ecurisë për nxënësit me AK që nuk ndiqen me PEI .............216
Modeli 34. Formulari i raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje........................221
Modeli 35. Referimi për shërbime.................................................................................224
Modeli 36. Kërkesa për supervizim...............................................................................231

# SHKURTIME

| | |
|---|---|
| **MAS** | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| **UP** | Urdhri i psikologut |
| **AKAP** | Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar |
| **DRAP** | Drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar |
| **ZVAP** | Zyra vendore e arsimit parauniversitar |
| **IA** | Institucioni arsimor |
| **NJSHPSSH** | Njësia e shërbimit psiko-social në shkollë |
| **PSHPSSH** | Punonjësi i shërbimit psiko-social në shkollë |
| **PSH** | Psikologu shkollor |
| **PSSH** | Punonjësi social shkollor |
| **SPZ** | Struktura policore e zonës |
| **OSSH** | Oficeri i sigurisë në shkollë |
| **NJMF** | Njësia e mbrojtjes së fëmijëve |
| **PMF** | Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës |
| **GTN** | Grupi teknik ndërsektorial |
| **KMD** | Komisioni multidisiplinar |
| **AK** | Aftësia e kufizuar |
| **PEI** | Plani edukativ individual |
| **KML** | Komisioni mjeko-ligjor |
| **KMCAP** | Komisioni i caktimit të aftësisë për punë |
| **QKSHM** | Qendra komunitare e shëndetit mendor |
| **PMS** | Plani i modifikimit të sjelljes |
| **PIM** | Plani individual i mbrojtjes |
| **PKMSH** | Plani koordinues i mbështetjes sociale |
| **OJF** | Organizatë jofitimprurëse |
| **OBSH** | Organizata Botërore e Shëndetit |

# HYRJE

Ky dokument është një udhëzues praktik, mbi procedurat që duhen të ndiqen nga punonjësit e shërbimit psiko-social shkollor, në identifikimin, në vlerësimin, në ndërhyrjen dhe në parandalimin e problematikave me të cilat nxënësit, prindërit dhe mësuesit përballen në shkollë dhe në familje. Udhëzuesi synon të ofrojë një kornizë të unifikuar veprimesh institucionale, të cilat janë në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, si dhe në mbështetje të suksesit të tyre akademik dhe social. Ky dokument u rishikua pas miratimit të dy dokumenteve shumë të rëndësishme për punën e shërbimit psiko-social si "Korniza e Vlerësimit të Shërbimit Psiko-Social" dhe "Metodologjia e Vlerësimit të Jashtëm dhe të Brendshëm të Shërbimit Psiko-Social", si dhe nga nevoja për ndryshime te lindura nga praktika e punës. Udhëzuesi përmban detyrat e përgjithshme (funksionale) të psikologut dhe të punonjësit social, pikëtakimet dhe ndryshimet midis dy profileve të punonjësve, nga të cilët përbëhet shërbimi psiko-social shkollor. Udhëzuesi paraqet formate të dokumenteve tip, nga praktika të cilat do të përdoren nga çdo punonjës i shërbimit psiko-social në institucionet arsimore, lidhur me veprimtarinë vlerësuese, parandaluese dhe të ndërhyrjes, për dokumentimin e punës në mënyrë të unifikuar, në përputhje me standardet profesionale dhe me parimet etike, Kornizën e Vlerësimit të shërbimit psiko-social dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Jashtëm dhe Të brendshëm të shërbimit psiko-social. Gjithashtu, paraqiten në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë, fenomenet me të cilat punonjësi i shërbimit psiko-social shkollor mund të përballet në përditshmërinë e tij, si rastet e dhunës, abuzimit, etj.

Udhëzuesi është mbështetur në praktikën e punës së punonjësve të shërbimit psiko-social, që prej fillimit të funksionimit të këtij shërbimi, në praktikat dhe botimet ndërkombëtare, në nevojat e identifikuara të punonjësve, në raport me rolin në institucionet arsimore (IA), në ndërhyrjet dhe në dokumentimin e punës së tyre.

Ky udhëzues iu vjen në ndihmë punonjësve të shërbimit psiko-social në institucionet arsimore publike dhe private, njësive të shërbimit psiko-social, komisionit të aftësisë së kufizuar në shkolla, komisionit multidisiplinar pranë zyrave

vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), për IA, institucionet që monitorojnë e inspëktojnë punën e shërbimit, etj.

Përgjatë gjithë ndryshimeve në sistemin arsimor paraunivesitar, vitet e fundit, problematikat më të cilat u përballë shoqëria jonë, prej vitit 2019 (tërmeti, pandemia etj.), dhe problematikave të reja që mund të identifikohen në të ardhmen, ky udhëzues synon të orientojë punonjësit e shërbimit psiko-social, në ofrimin e shërbimeve efektive dhe profesionale, në përputhje me nevojat aktuale të shërbimit dhe të përfituesve të tij.

# PJESA E PARË

# FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË NIVEL SHKOLLE

# ROLI, DETYRAT DHE BASHKËPUNËTORËT E PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË SHKOLLA

Punonjësit e shërbimit psiko-social shkollor kanë rol të rëndësishëm, në **promovimin** dhe mbështetjen, suksesin akademik dhe social të nxënësve, duke ofruar shërbime në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Në rolin e ndërmjetësuesit dhe të lehtësuesit të marrëdhënieve, punonjësi i shërbimit psiko-social bashkëpunon me mësues (kujdestarë, lëndorë, ndihmës), me persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe me profesionistë të tjerë, për të krijuar një mjedis të sigurt në mbështetje të të nxënit duke ndikuar gjithashtu, në forcimin e lidhjes familje-shkollë-komunitet me nxënësin në qendër.

Punonjësit e shërbimit psiko-social në shkolla kanë në fokus të punës, **identifikimin** sa më herët të situatës në të cilën gjendet nxënësi me problematika, të tilla si: sjellore, psiko-emocionale, ndërvepruese, problematika të shëndetit mendor, braktisjes shkollore, social-ekonomike dhe vështirësi në të nxënë, duke hartuar plane individuale parandaluese, bazuar në nevojat e identifikuara.

Punonjësit e shërbimit psiko-social në shkolla **vlerësojnë** te nxënësit, kapacitetet për të mësuar, zhvillimin social-emocional të nxënësit, identifikojnë faktorët biologjikë, psikologjikë, kulturorë, ekonomikë dhe mjedisorë që ndikojnë të nxënit dhe zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësitë sociale

Punonjësit e shërbimit psiko-social **ndihmojnë** punonjësit arsimorë, personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe nxënësit, në parandalimin ose eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve dhe anasjelltas, të nxënësve ndaj bashkëmoshatarëve dhe përfshirjes së tyre në sjellje abuzive, të tilla si: konsumimi i duhanit, i alkoolit, i drogës etj. Punonjësit ndihmojnë në zhvillimin e aftësive sociale dhe organizuese, problem-zgjidhëse, mendimin kritik dhe krijues, përmirësimin e vetvlerësimit, etj.

Punonjësit e shërbimit psiko-social **informojnë** punonjësit e institucionit arsimor, për zhvillimet tipike të moshës të nxënësve dhe për problemet që hasin nxënësit gjatë të mësuarit dhe të nxënit. Ndihmojnë mësuesit (kujdestarë, lëndorë dhe ndihmës) për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasa. Administrojnë dhe interpretojnë teste psikologjike, kur të jenë të disponueshme (nga psikologu), dhe plotësojnë dosjet individuale, për rastet e nxënësve që kanë përfituar nga shërbimi psiko-social. Raportojnë me shkrim, për çdo rast të provuar apo të dyshuar, për abuzim të nxënësve nga punonjës arsimorë, nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit, apo persona të tjerë, te drejtuesi i NJSHPS-së, dhe institucione të tjera sipas detyrave që ngarkon ligji.

Punonjësit e shërbimit psiko-social shkollor **ndërhyjnë,** për të ndihmuar nxënësit të zgjidhin problemet e përshtatjes, për zgjidhjen e konflikteve, për parandalimin e abuzimit, për ndërtimin e imazhit pozitiv për veten, për zhvillimin e aftësive social-emocionale dhe edukimin e tyre në shkollë, nëpërmjet këshillimit/konsultimit individual dhe në grup me nxënës, gjithashtu, konsultojnë personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në funksion të përmbushjes të mirëqenies së përgjithshme psiko-emocionale të nxënësve, por zhvillojnë gjithashtu edhe veprimtari të tjera ndërgjegjësuese/informuese që i vlerësojnë të rëndësishme për shkollën bazuar nga nevojat e vlerësuara në komunitetin shkollor, planifikimit vjetor, udhëzimeve, etj.

Punonjësit e shërbimit psiko-social **zhvillojnë veprimtari ndërgjegjësuese/informuese,** në kuadër të ditëve ndërkombëtare, të specifikuara në udhëzimin përkatës të fillimit të vitit shkollor.

Punonjësit e shërbimit psiko-social shkollor **referojnë** rastet, pranë institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve me të cilat bashkëpunojnë, në interesin më të lartë të fëmijës, dhe pranë institucioneve shëndetësore të cilat ofrojnë shërbime të shëndetit mendor. Këto institucione janë njësia për mbrojtjen e fëmijëve (PMF/NJMF) pranë çdo njësie administrative dhe institucione të tjera të cilat ofrojnë shërbime. Personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, pas vlerësimit të nevojave të nxënësit, i jepet një rekomandim me shkrim.

**Në shkolla ku shërbimi psiko-social përfaqësohet vetëm nga punonjësi social**, ai është përgjegjës për realizimin e të gjitha veprimtarive të përshkruara në këtë

udhëzues, me përjashtim të testeve psikologjike. Në këtë rast, punonjësi social është kryetar i komisionit të AK-së në shkollë dhe realizon vlerësimin psiko-social të fëmijës me aftësi të kufizuar (sipas formatit përkatës). Punonjësi social kryen vizita në familje, vetëm në raste kur vlerësohet e nevojshme prej tij/saj dhe në bashkëpunim me punonjësin e mbrojtjes së fëmijës (PMF).

**Në shkolla ku shërbimi psiko-social, përfaqësohet vetëm nga psikologu**, ai është përgjegjës për realizimin e të gjitha veprimtarive të përshkruara në këtë udhëzues, me përjashtim të vlerësimit të gjendjes sociale të nxënësit dhe të vizitave në familje. Psikologu është kryetar i komisionit të AK-së në shkollë dhe realizon vlerësimin psiko-social të fëmijës me aftësi të kufizuar (sipas formatit përkatës). Harton, administron dhe interpreton teste psikologjike, kur janë të disponueshme.

**Në rastet kur shërbimi përfaqësohet nga të dy punonjësit**, punonjësi social planifikon dhe realizon veprimtari ndërgjegjësuese/informuese me nxënës, prindër dhe me mësues, kryesisht me natyrë sociale, ndërsa psikologu shkollor planifikon dhe realizon veprimtari ndërgjegjësuese/informuese me nxënës, prindër dhe me mësues, kryesisht me natyrë psikologjike. Psh punonjësi social realizon aktivitete ndërgjegjësuese/informuese që përfshin tema si: Antitrafikimi, të drejtat e fëmijëve, bullizmi, komunikimi, marrëdhëniet mësues nxënës, marrëdhëniet familjare, braktisja shkollore, interneti i sigurt, pasojat e konsumimit të drogës, alkolit dhe duhanit, etj. Psikologu realizon aktivitete ndërgjegjësuese/informuese që përfshin tema si: shëndeti mendor, menaxhimi i stresit, ankthit, përshtatja dhe socializimi, motivimi dhe ndikimi i tij në të nxënë, aftësia e kufizuar, etj. Por sigurisht që kjo ndarje është rekomanduese pasi disa veprimtari mund të realizohen nga të dy punonjësit në bashkëpunim. Punonjësi i shërbimit psiko-social zbaton veprimtaritë e parashikuara në planin vjetor ose veprimtaritë bazuara në nevojat specifike të shkollës, të identifikuara gjatë vitit shkollor. Veprimtaritë mund të jenë në formën e parandalimit, të vlerësimit dhe të ndërhyrjes, për çështje që shërbimi psiko-social i ka në fokus të veprimtarisë së tij, brenda IA-së.

# Format e komunikimit me mësuesit, me drejtuesit dhe me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore

Komunikimi i punonjësit të shërbimit psiko-social në institucionet arsimore, me drejtuesit, me mësuesit, me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe me nxënësit, mund të jetë formal dhe joformal.

Gjatë komunikimit formal kërkohet dokumentimi i tij, në një nga format zyrtare, sipas formateve përkatëse (regjistrimi i të dhënave, relacione etj.). Komunikimi kërkohet të realizohet në mjedisin ku ofrohet shërbimi ose brenda mjediseve të institucionit arsimor.

# Komunikimi që ka nevojë të dokumentohet

Dokumentohen:

- Referimi i nxënësit nga mësuesi, nga drejtuesi dhe nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, për të cilin kërkohet shërbim sipas formatit tip të dhënë në Modelin 1.
- Miratimi i informuar sipas formatit tip, të paraqitur në udhëzues jepet nga prindi vetëm kur do të aplikohet test psikologjik, do të kryhet vlerësim psikologjik/social dhe kur nxënësi ndiqet me seanca këshillimi për një kohëzgjatje (2 – 4 seanca). Miratimi i informuar merret vetëm një herë dhë është i vlefshëm për sa kohë prindi nuk tërhiqet nga dakordësia.
- Të dhënat e marra nga mësuesit kujdestarë për gjendjen sociale të klasës.
- Çdo këshillim/konsultim i realizuar në mjedisin ku ofrohet shërbimi me mësues, me nxënës, me persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, duke e pasqyruar në regjistrin e të dhënave, në formë elektronike, fizike ose në çdo formë që punonjësi zgjedh për të mbajtur këto të dhëna.
- Çdo takim me persona të tjerë (mësues, persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, PMF, persona të afërt të fëmijës etj.), i cili vlerësohet i nevojshëm

për t'u realizuar, për shkak të ndërhyrjes së planifikuar,duke e pasqyruar në dosjen personale të fëmijës.

- Në rastet kur te punonjësi i shërbimit psiko-social referohen/raportohen raste rreth situatave me natyrë sensitive (raste dhune, abuzimi, probleme të etikës në komunikim, raste diskriminimi etj.), nga persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, mësues, drejtues etj., komunikimi dokumentohet nëpërmjet një procesverbali.
- Çdo rast konflikti nxënës -nxënës, nxënës -mësues, mësues -mësues, mësues-prind apo çdo aktor tjetër i komunitetit shkollor i përfshirë në konflikt për të cilin punonjësi psiko-social ka ndërhyrë për të menaxhuar situatën, dokumentohet nëpërmjet një proces-verbali.
- Takimet në grupe me nxënës, me mësues dhe me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, dokumentohen në formatin përkatës (skedë këshillimi në grup, raport veprimtarie, etj.).
- Rastet që punonjësi i shërbimit psiko-social referon për shërbime, pranë qendrave të shëndetit mendor, njesisë për mbrojtjen e fëmijëve/punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve  apo në institucione te tjera dokumentohen sipas formatit tip për vlerësimin dhe/ose referimin.
- Nuk nevojitet dokumentimi i komunikimeve për rastet kur punonjësi i shërbimit psiko-social njofton për organizimin e veprimtarive informuese/ndërgjegjësuese me mësues dhe/ose persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore. Njoftimi i këtyre veprimtarive realizohet përkatësisht, në bashkëpunim me drejtuesit dhe/ose mësuesit.
- Një formë tjetër komunikimi më personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore është edhe *Fletorja Digjitale e Komunikimit* në platformën SMIP.

Punonjësi i shërbimit psiko-social njofton individualisht ose në grup për të gjithë nxënësit e klasës nëpërmjet *Fletorjes Digjitale e Komunikimit* në sistemin SMIP, personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, për të informuar ata në kohë reale për nxënësit sipas fushës së përgjegjësisë që ata mbulojnë.

Kjo fletore digjitale ju vjen në ndihmë punonjësve të shërbimit psiko-social si një nga format e komunikimit me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore. Punonjësi i shërbimit psiko-social raporton në mënyrë të përshtatshme me gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për komunitetin e prindërve. Punonjësi i shërbimit

shpreh arsyen përse po bëhet ky raportim, rrezikun që paraqet kjo situatë për nxënësin, personi/personat që identifikuan situatën, aktorë të tjerë të informuar dhe/ose të përfshirë në menaxhimin e situatës. Përshkruan gjithashtu llojin e situatës, reagimet e manifestuara nga nxënësi, vendndodhjen, veprimet e ndërmarra deri në momentin që bën raportimin si dhe rekomandime për personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për veprimet në vazhdimësi në interesin më të lartë të fëmijës, duke i'u referuar elementëve të përshkruara në vijim:

***Arsyeja e raportimit***. *Informimin për situatën në të cilën është gjendur fëmija.*

***Në këtë situatë fëmija*** *juaj ka përjetuar shqetësime me natyrë: sjellore, shëndetësore, emocionale, tjetër*

***Fëmija paraqet:*** *rrezik për veten, rrezik për të tjerët, rrezik për veten dhe të tjerët*

***Përshkruhet arsyeja e raportimit:*** *Raportimi bëhet me fjalët të thjeshta dhe të kuptueshme për prindin, duke e përmbledhur situatën e fëmijës. Raportimi kryhet për incidentet që paraqesin rrezik për jetën, sigurinë, shëndetin apo mirëqenien e fëmijës ose të të tjerëve dhe pasi janë bërë të gjitha përpjekjet për të komunikuar me prindërit/kujdestarët e fëmijës por kjo nuk është arritur me mënyrat e zakonshme të komunikimit. Pavarësisht këtij raportimi duhet të vazhdojnë përpjekjet për të komunikuar drejtpërdrejtë me prindërit/kujdestaret e fëmijës. Ky raportim duhet të kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur por gjithmonë brenda asaj dite pune.*

***Personi/personat*** *që kanë identifikuar dhe kanë ndihmuar në menaxhimin e situatës.*

***Reagimet e manifestuara nga fëmija që mund të përfshihen në përshkrim,*** *si: Të qara, humbje ndjenjash, vështirësi në frymëmarrje, mpirje muskujsh, shtrëngim në kraharor, marrje mendsh, djersitje, të vjella ose të përziera, rrahje të shpeshta zemre ose shtrëngim në zemër, veprime kompulsive, melankoli, trishtim që zgjat në kohë, impulsivitet, gjendje e irrituar, vështirësi e theksuar në përqendrim, hiperaktivitet, mungesë e theksuar oreksi, mungesë e theksuar gjumi, i folur i çorganizuar që nuk përputhet me realitetin, mungesë interesi për të marrë pjesë në aktivitetet e zakonshme, shok emocional, gjendje frike dhe ankthi të theksuar ndaj situatave apo vendeve të zakonshme, gjendje ankthi, ankth social, atak paniku, sjellje vetë-dëmtuese, shpërthime zemërimi, sjellje agresive, etj.*

***Veprimeve të ndërmarra deri më tani:*** *Takim më nxënësin, Takim me personat e përfshirë, Takim me nxënësit e klasës, Takim me mësues kujdestar, Ndihma e parë psikologjike, Ndërmjetësim i konfliktit, Raportim i menjëhershëm, Takim me prindër të nxënësve të përfshirë, etj*

***Rekomandime për ju si prindër:*** *Kontakt të menjëhershëm me shkollën, Kontakte më të shpeshta me shkollën, Monitorimi i sjelljes së fëmijës në shtëpi, Monitorim i sjelljes së fëmijës në komunitet dhe personave me të cilët shoqërohet, Vlerësimi i gjendjes së fëmijës të mjeku specialist, Informim i rregullt i shkollës mbi gjendjen e fëmijës, Kalimi i kohës cilësore me fëmijën, etj.*

Punonjësi i shërbimit psiko-social identifikohet me kredencialet e tij/saj automatikisht në SMIP si punonjës i IA-së ku ushtron profesionin. Drejtohet në dritaren për raportim tek prindi, përzgjedh klasën përkatëse dhe emrin e nxënësit për të cilin po kryhet raportimi.

Përgjegjësinë për raportimin e situatave e ka cilido punonjës i shërbimit psiko-social. Në shkollat ku shërbimi përfaqësohet nga dy apo më shumë punonjës të shërbimit psiko-social, raportimin mjafton ta bëj vetëm njëri punonjës. Në rastet ku situata po menaxhohet nga të dy punonjësit psiko-social, ata vendosin me kompromis se cili prej tyre do të bëjë raportimin në SMIP.

# FORMULARI I NJOFTIMIT TË PRINDIT NË SMIP

Punonjësi i shërbimit psiko-social do të ketë një dritare të dedikuar në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) për komunikimet e tij më prindërit apo personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.

Hapësira e dedikuar do të shërbej për të rritur komunikimin efektiv dhe në kohë reale punonjësit të shërbimit psiko-social dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.

Kjo hapësirë e dedikuar do të përdoret nga punonjësi i shërbimit psiko-social në këto momente kryesore:

**1 Kur identifikohen shqetësime në sjelljen apo emocionet e fëmijës**

- Nxënësi paraqet ndryshime të papritura në sjellje (agresivitet, tërheqje, ankth).
- Ka vështirësi në përshtatjen sociale ose ndërveprimin me bashkëmoshatarët.
- Ka shenja të stresit, depresionit, dhunës ose bullizmit.

*Qëllimi*: Informimi i prindërve, mbështetje për ndërhyrje të përbashkët.

**2 Kur ka probleme të dukshme në mësimnxënie**

- Nxënësi ka rënie të ndjeshme në rezultate.
- Tregon mungesë përqendrimi ose vështirësi të vazhdueshme në detyra.

*Qëllimi*: Bashkëpunim me familjen për të kuptuar shkaqet dhe për të ndërtuar strategji ndihmëse.

**3 Kur nxënësi ka kërkuar ndihmë vetë**

- Nëse një nxënës i është drejtuar vetë psikologut ose punonjësit social dhe ka ndarë diçka të rëndësishme (p.sh., përjetim dhune në shtëpi apo në shkollë).

*Qëllimi*: Mbështetje, ndërhyrje ose referim, sipas rastit dhe në përputhje me protokollet e mbrojtjes së fëmijëve.

### 4 Kur ka mungesa të shpeshta ose shenja neglizhimi

- Nxënësi mungon shpesh pa arsye të justifikuar.
- Ka mungesë veshjeje të përshtatshme, ushqimi, apo kujdesi bazë.

*Qëllimi*: Të kuptohet nëse ka probleme familjare ose nevojë për ndërhyrje të mëtejshme.

### 5 Në kuadër të vlerësimeve dhe mbështetjes psiko-sociale

- Punonjësi i shërbimit psiko-social kërkon të zhvillojë vlerësime të thelluara dhe ka nevojë për informacion nga familja.
- Kërkohet bashkëpunim për plan mbështetës individual.

### 6 Për të përforcuar aspekte pozitive

- Jo gjithmonë kontakti ndodh për arsye negative: mund të lidhet edhe me përparimin emocional, zhvillimin pozitiv, angazhimin në aktivitete të veçanta etj.

Plotësimi i kësaj dritareje do të realizohet nga punonjësi i shërbimit psiko-social pas vlerësimit të rrezikut dhe adresimit të zgjidhjeve të mundshme. Gjithashtu ky komunikim do te behët për çdo rast tjetër që punonjësi vlerëson të nevojshme

Plotësimi i kësaj dritareje në hapësirën e dedikuar për komunikimet midis punonjësit të shërbimit psiko-social dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, nuk përjashton mundësinë e nevojës së pranisë fizike të tyre në mjediset e shkollës.

# KËRKESA PËR REFERIM TEK PUNONJËSIT E SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË SHKOLLË

Kërkesa për referim tek punonjësit e shërbimit psiko-social në shkollë bëhet për të adresuar situata ku një nxënës paraqet shqetësime që tejkalojnë kompetencën e mësuesit, drejtuesit apo stafit të zakonshëm pedagogjik, dhe kërkojnë një vlerësim më të thelluar emocional, social apo zhvillimor. Kjo kërkesë shërben si pikënisje e një procesi mbështetës që synon mirëqenien e nxënësit dhe parandalimin e problemeve më serioze në të ardhmen.

Arsyet kryesore pse bëhet një kërkesë për referim:

- Shfaqje e sjelljeve të pazakonta ose shqetësuese
- Ndryshime të papritura në sjellje ose performancë akademike
- Dyshime për dhunë, abuzim apo neglizhencë
- Nevoja për vlerësim zhvillimor apo diagnozë të mundshme
- Raste të mungesës së motivimit apo përjashtimit social
- Situata që kërkojnë ndërmjetësim me prindërit apo komunitetin

Kush bën kërkesën për referim?

- Mësuesi i klasës/lëndës
- Mësuesi kujdestar
- Drejtori i shkollës
- Prindërit/vetë nxënësi
- Oficer i sigurisë në shkollë
- Komisionet e ndryshme në nivel shkolle

Qëllimi i referimit është që të sigurohet që çdo nxënës të marrë mbështetjen e duhur në kohën e duhur, të parandalohet përkeqësimi i vështirësive, dhe të promovohet mirëqenia emocionale, sociale dhe akademike e tij brenda një mjedisi të sigurt shkollor.

**Modeli 1. Kërkesë për referim tek punonjësit e shërbimit psikosocial**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ________**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR __________**

**SHKOLLA_____________________________**

Data: __/___/_____

Persononi që kryen referimin: ________________________________________

Pozicioni: -Mësues - Prind/kujdestar ligjor -Tjetër

Personi për të cilin po kryhet referimi: ________________________________________

Emri, mbiemër: _______________ Mosha __________________ Klasa: ____________

Emri i prindit/kujdestarit ligjor__________________

Kontakti i prindit/kujdestarit ligjor:_________________

- Arsyeja e kërkesës (përshkruaj shqetësimin):

________________________________________________________________________

- Si ka ndikuar problemi tek nxënësi në drejtim të

- Ecurisë në mësime a. Shumë pak b. Mesatarisht c. Shumë
- Ruajtjes së marrëdhënieve të shëndetshme a. Shumë pak b. Mesatarisht c. Shumë
- Sjellja a. Shumë pak b. Mesatarisht c. Shumë

- Ndërhyrja/puna e kryer deri tani nga mësuesit/prindërit/të tjerët

________________________________________________________________________

__________________________________________________________________

Emër Mbiemër i referuesit: ___________ Firma_____

Ky dokument mbledh dhe përpunon të dhëna personale në përputhje me Ligjin Nr. 124/2024 për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale.

# NDARJA E INFORMACIONIT ME PERSONAT E INTERESIT

Punonjësi i shërbimit psiko-social në institucionet arsimore, përgjatë ndërhyrjeve të drejtpërdrejta, në interesin më të lartë të nxënësit, në përputhje me "Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", të sigurojë miratimin e informuar të personit që ushtron përgjegjësinë prindërore sipas rasteve të parashikuara në këtë rregullore. Punonjësi i shërbimit psiko-social sigurohet që individi që e jep miratimin e informuar për shërbimet psiko-sociale të shkollës, të jetë plotësisht i informuar për natyrën e shërbimeve dhe çdo gjë tjetër, përsa i përket kufijve të kompetencës, të konfidencialitetit, si dhe të ruajtjes së informacionit, referuar parimeve për etikën profesionale.

Personat që ushtojnë përgjegjësinë prindërore mund të japin miratimin e tyre, për shërbimet individuale për fëmijët e tyre, të ofruara nga punonjësi i shërbimit psiko-social në çdo formë: me shkrim individualisht, me shkrim në grup ose verbalisht.

Për veprimtari në nivel shkolle, klase, fokus-grupe, pyetësorë dhe takime individuale me nxënësit, për raste që vlerësohen si emergjenca, nuk nevojitet miratimin e informuar nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.

Punonjësi i SHPS-ës mund të presë një nxënës në zyrë dhe, pasi të kuptojë problematikën e fëmijës, të informojë prindin për ndjekjen e seancave të këshillimit pas 2 ose 4 takimeve pasi ka vlerësuar nevojën për një ndërhyrje më afatgjatë, ka evidentuar problematika që cenojnë mirëqenien e nxënësit dhe ka rekomanduar trajtimin brenda shkollës. *Në rastet, kur prindi refuzon që nxënësi të marrë shërbim nga punonjësi i SHPS-së së shkollës, për situata të cilat vlerësohen emergjente apo që cenojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës, ai duhet të vërtetojë se nxënësi po e merr shërbimin sipas nevojës, jashtë institucionit.*

Punonjës i SHPS-ës përdor një ndërmjetës (PMF-ja, supervizori ose drejtuesi i NJSHPS-ës), për të lehtësuar komunikimin me prindin në ato raste kur ka të dhëna, se prindi refuzon shërbimin të cilin vetë nxënësi e kërkon apo kur prindi shkakton, rëndon apo neglizhon situatën emocionale të fëmijës, si dhe në rastet kur nxënësi

manifeston sjellje që cenojnë mirëqenien e tij/saj ose të nxënësve të tjerë dhe prindi vazhdon të jetë refuzues ndaj shërbimit psiko-social. Në këto raste kërkohet ndërhyrje e mëtejshme, punonjësi kërkon bashkëpunimin dhe ndihmën e PMF-ës, për të garantuar mirëqenien më të lartë psikologjike, emocionale dhe sociale të të miturit.

# Miratimi i informuar

Ky dokument i vjen në ndihmë punonjësit të shërbimit psiko-social shkollor, për të dokumentuar miratimin e informuar, nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijës. Ky format plotësohet rast pas rasti kur punonjësi vlerëson nevojën e marrjes së miratimit të informuar me shkrim.

**Modeli 2. Formati për miratimin e informuar nga prindi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ________**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR __________**

**SHKOLLA_____________________________**

**Miratim i informuar**

Bazuar në urdhrin nr. ___, datë ______, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", kreu ___ neni __ dhe neni __, pika __, punonjësi i shërbimit psiko-social (PSHPS) në institucionin arsimor, kërkon nga ju, si prind/kujdestar ligjor i fëmijës, të plotësoni formularin e mëposhtëm:

Unë ______________________________________________, prindi/kujdestari ligjor i fëmijës ____________________________________, në klasën ___________________,

pasi jam informuar për natyrën e shërbimeve dhe ruajtjen e të dhënave personale deklaroj se punonjësi i shërbimit psiko-social:

- ☐ Ka miratimin tim për kontakte, për këshillime/konsultime dhe për vlerësime individuale, nëse paraqitet nevoja, gjatë qëndrimit të nxënësit në institucionin arsimor.
- ☐ Nuk ka miratimin tim.

Prindi/kujdestari ligjor _________________________________

(emri mbiemri i prindit/kujdestarit ligjor, firma)

Data _____/_____/________

Ky dokument mbledh dhe përpunon të dhëna personale në përputhje me Ligjin Nr. 124/2024 për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale.

# Ndarje e informacionit

Ndarja e informacionit me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore

Rastet kur punonjësi i shërbimit psiko-social ndan informacion, me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, janë kryesisht rastet kur identifikohen situata që kanë lidhje me:

1. Problematika të sjelljes;
2. Problematika të abuzimit me substanca;
3. Problematika të shëndetit mendor;
4. Problematika të zhvillimit apo të vështirësisë në të nxënë;
5. Problematika të ngacmimit ose të abuzimit seksual etj.
6. Çdo situatë tjetër në të cilën fëmijës i 25enohet mirëqenia, shëndeti, siguria, jeta, etj.

Kur personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, kërkojnë të informohen me shkrim ose kërkojnë raporte vlerësimi të gjendjes psiko-emocionale të fëmijës në shkollë, punonjësi i shërbimit psiko-social ka për detyrë, të hartojë një informacion përmbledhës dhe përgjithësues mbi ecurinë mësimore, frekuentimin e shkollës, marrëdhëniet me moshatarët dhe me mësuesit dhe/ose gjendjen psiko-emocionale. Ky informacion nuk është raport i një vlerësimi psikologjik, por bazohet kryesisht, në informacionin e ndarë nga mësuesit, në informacionin e marrë nga vëzhgimi dhe nga takimet e punonjësit me fëmijën.

Ky informacion hartohet, vetëm me kërkesën më shkrim nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, dhe përcillet zyrtarisht me shkresë përcjellëse nga drejtoria e IA-së.

Kur personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore nuk lejojnë kontaktin e shërbimit psiko-social të shkollës me fëmijën, për vlerësimin, për këshillimin/konsultimin apo për ndërhyrje, ose për raste kur punonjësi i shërbimit psiko-social ka konflikt interesi, atëherë:

1. Përdoret një ndërmjetës (PMF-ja, supervizori ose drejtuesi i NJSHPS-së), për të lehtësuar komunikimin e prindit me psikologun apo me punonjësin social.

2. Tërhiqet nga rasti, duke argumentuar arsyet dhe propozon gjetjen e një eksperti/grupi ekspertësh nga NJSHPS-ja.
3. Referon te NJMF/PMF-ja, privimin e shërbimeve jetike për fëmijën.

### Ndarja e informacionit me drejtuesit e IA-së

Punonjësi i shërbimit psiko-social raporton te drejtuesi i IA-së, ato raste për të cilat vlerësohet e nevojshme ndarja e informacionit, kur:

- vihet në rrezik jeta e nxënësit;
- cenohet interesi më i lartë i nxënësit;
- kërkohet, për të gjitha rastet, një plan ndërhyrjeje në nivel shkolle.

*Drejtuesit të IA-së i cilësohet rëndësia e ruajtjes dhe e respektimit të konfidencialitetit për informacionin e ndarë.*

### Ndarja e informacionit me mësuesin

Punonjësi i shërbimit psiko-social ndan informacionet me mësuesin, kur vlerëson që ky informacion do të ndihmojë, në:

- përmirësimin e arritjeve të të nxënit dhe në performancën shkollore;
- përmirësimin e marrëdhënieve mes nxënësve;
- integrimin dhe në përshtatjen e nxënësit në shkollë;
- rastet kur mësuesi është një nga aktorët e rëndësishëm, në zbatimin e planit të ndërhyrjes.

*Mësuesit i cilësohet rëndësia e ruajtjes dhe e respektimit të konfidencialitetit për informacionin e ndarë.*

# PLANIFIKIMI VJETOR

Punonjësi i shërbimit psiko-social në institucionet arsimore, planifikon veprimtari brenda institucionit, për çdo institucion arsimor ku ofron shërbimin. Planifikimi vjetor i veprimtarisë së shërbimit psiko-social në institucionet arsimore, realizohet në përputhje me nevojat e institucionit (plani vjetor i shkollës), me gjetjet e analizës vjetore të vitit shkollor të mëparshëm, të strategjive kombëtare, të udhëzimit të çdo fillimi të vitit shkollor dhe të planit vjetor të NJSHPS-së.

Punonjësit e shërbimit psiko-social shkollor planifikojnë veprimtaritë, që ky shërbim do të ofrojë për nxënësit, për stafin e shkollës dhe për personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, pasi ka vlerësuar nevojat e tyre.

Plani vjetor i hartuar dhe i firmosur nga punonjësi i shërbimit psiko-social për çdo institucion arsimor, miratohet zyrtarisht nga drejtuesi i institucioni me fillimin e viti shkollor.

## Model i planit vjetor

Punonjësi i shërbimit psiko-social harton planin vjetor, për çdo institucion arsimor ku ofron shërbimin, dhe  dorëzon një kopje të tij, në drejtorinë e institucionit arsimor dhe në njësinë e shërbimit psiko-social pranë ZVAP-së. Një model i planit vjetor përshkruhet në modelin 3.

**Modeli 3. Plani vjetor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ________**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR __________**

**SHKOLLA_____________________________**

**Plani vjetor i shërbimit psiko-social**

**Viti shkollor _______-________**

Hartoi:________________________

Miratoi:________________________

Punonjës i SHPS　　　　　　　　　　　　　　　Drejtor

**LEGJENDË**

Rubrika **FUSHA** do të përcaktohet si më poshtë:

**Fusha 1- Zhvillimi socio-emocional**: Përfshin aktivitetet parandaluese, vlerësuese dhe ndërhyrëse me qëllim trajtimin e problematikave sjellore dhe të shëndetit mendor duke ofruar mbështetje të përshtatshme dhe individuale ku nxënësi të ketë mundësi të zhvillohet emocionalisht

**Fusha 2- Procesi i të nxënit:** Përfshin aktivitetet parandaluese, vlerësuese dhe ndërhyrëse që synojnë të arrijnë zhvillimin e aftësive individuale të nxënësit në përfshirjen e tij aktive dhe zhvillimine potiencialin tëtij të plotë në procesin e të nxënit.

**Fusha 3- Sjellja dhe marrëdhëniet :** Përfshin aktivitetet parandaluese, vlerësuese dhe ndërhyrëse që synojnë krijimin e një mjedisi mirëbesimi dhe bashkëpunimi, respektimine të drejtave të individëve me të cilët ata ndërveprojnë duke trajtuar me

ndjeshmëri dhe siguruar trajtim të barabartë për përmirësimin e marrëdhënieve dhe ndërtimin e një komuniteti të shëndetshëm shkollor.

**Fusha 4- Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin:** Përfshin aktivitetet parandaluese, vlerësuese dhe ndërhyrëse për ta përfshirë aktivisht familjen dhe komunitetitn në jetën shkollore.

| **Nr** | **Tema e veprimtarisë** | **Rezutatet e pritshme** | **Lloji i aktivitetit** | **Fusha** | **Forma e dokumentimi** | **Personi përgjegjës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Shtator - tetor** | | | |
| 1 | Analiza e gjendjes sociale të shkollës | Përfitimi i një pasqyre të detajuar mbi gjendjen sociale të nxënësve të shkollës. | Vlerësim | 1, 2 dhe 3 | Statistka përmbledhëse e të të dhënave sociale | Punonjësi social, mësuesit kujdestar |
| 2 | Krijimi i bazes së të dhënave për nxënësit me Aftesi të Kufizuara | Identifikimi i fëmijëve në bazë klase e shkolle, Hartimi i PEI | Vleresim Ndërhyrje | 2 dhe 3 | Formular Vëzhgimi, formular fokus-grup etj Konsultime me prindër dhe mësues | Psikologu, mësuesit ndihmes |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Dita Botërore e Shëndetit Mendor<br><br>(10 Tetor) | Prindër të informuar dhe ndërgjegjësuar në lidhje me shqetësimet e shëndetit mendor më të shpeshta për grup-moshën e fëmijëve të tyre dhe informim për mënyrat se si të kërkojnë ndihmë. | Parandalim | 1 dhe 3 | Struktura per prlanifikimin e aktivitetit.<br><br>Material teorik<br><br>Struktura e realizimit te aktivitetit | Punonjesi SHPS |
| 4 | | | | | | |
| 5 | | | | | | |
| **Nëntor** | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

| Dhjetor | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

**Shënim:** Fushat plotësohen duke iu referuar legjendës, dhe aktiviteti mund të përfshijë një ose më shumë fusha.

# Matrica e raportimit për veprimtaritë e realizuara

Çdo muaj, punonjësi i shërbimit psiko-social plotëson, për çdo institucion ku ofron shërbimin, matricën e raportimit për veprimtaritë e realizuara. Kjo matricë ruhet në dosjen e punonjësit dhe një kopje e saj i dorëzohet drejtuesit të institucionit arsimor.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara muaj pas muaji, punonjësi raporton në fund të çdo periudhe (një herë në tre muaj), të dhënat për çdo shkollë, pranë njësisë së shërbimit psiko-social.

**Modeli 4. Matrica e realizimit**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _______**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ________________**

**SHKOLLA__________________________**

## Matrica e realizimit

## I. Të dhëna statistikore

| **Përshkrimi** | **Nr. i temave** | **Nr. i nxënësve** | **Nr. i temave** | **Nr. i mësuesve** | **Nr. i temave** | **Nr. i prindërve** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Veprimtari ndërgjegjësuese | | | | | | |
| 2. Pyetësor | | | | | | |
| **Përshkrimi** | **Nr. i nxënësve** | **Nr. i takimeve** | **Nr. i mësuesve** | **Nr. i takimeve** | **Nr. i prindërve** | **Nr. i takimeve** |
| 1. Këshillim/konsultime individuale | | | | | | |
| 2. Këshillim në grup | | | | | | |
| 3. Menaxhim konflikti | | | | | | |
| 4. Referime në NjShPS | | 5. Vlerësime psiko-sociale | | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 6. Referime në NjMF + NjShPS | | 7. Vlerësime psiko-edukative | |
| 8. Referime në QSHKM | | 9. Vlerësim të gjendjes sociale të nxënësit | |
| 10. Referime në institucione të tjera | | | |

| **Referime të rasteve të dhunës** | **Të shkaktuara** | | |
|---|---|---|---|
| | **Nga nxënës** | **Nga mësues** | **Nga prindër** |
| 1. Në drejtori | | | |
| 2. Në NjShPS | | | |
| 3. Në NjMF | | | |
| 4. Në polici | | | |
| **Përshkrimi** | **Të reja** | **Në vazhdim** | **Të mbyllura** |
| 1. Dosje te nxënësve | | | |
| 2. Dosje të nxënësve në trajtim të transferuara në shkolla të tjera. | | | |

***Shënim:*** *në tabelën e mësipërm do të plotësoni vetëm me numër. Edhe në rast se nuk ka veprimtari të kryer do të plotësoni me 0. Dosje e mbyllur konsiderohet kur problematika e nxënësit është e mbyllur edhe pse fëmija vijon të jetë në institucion.*

## II. Të dhëna mbi veprimtaritë vlerësuese.

| **Veprimtaria** | **Kampionimi** | **Qëllimi** | **Realizuar nga** |
|---|---|---|---|
| Pyetësor me nxënës<br>Tema: .... | 100 nx | Çfarë synon të masë pyetësori | Punonjësi i cili realizon pyetësorin |
| Pyetësor me prindër<br>Tema: ..... | | | |
| Pyetësor me mësues<br>Tema: ..... | | | |
| Fokus grup me nxënës<br>Tema: ..... | | | |
| Etj. | | | |

## III. Të dhëna mbi ndërhyrjet e kryera

| **Veprimtaria** | **Nr. i takimeve** | **Problematika të hasura** | **Realizuar nga:** |
|---|---|---|---|
| Ndërhyrje në nivel individual | 4 | | |
| Ndërhyrje në nivel klase | 9 | | |
| Ndërhyrje në nivel shkolle | 5 | | |

## IV. Të dhëna mbi veprimtaritë parandaluese.

| **Nr.** | **Tema dhe Veprimtaria** *(specifiko grupin )* | **Nr i pjesëmarrësve në total** | **Realizuar nga:** |
|---|---|---|---|
| 1 | Siguria në internet Aktivitet ndërgjegjësues me nxënës | 120 nxënës | PSHPSSH |
| **2** | Aktivitet ndërgjegjësues me prindër | 15 prindër | **PSH** |
| **3** | Aktivitet ndërgjegjësues me mësues | 23 mësues | **PS** |
| **4** | Aktivitet ndërgjegjësues me qeverinë e nxënësve | 18 senatorë | |
| **5** | Etj | | |

**Punonjësi i SHPSSH**

***Punonjësit e shërbimit psiko-social zgjedhin të plotësojnë bashkë ose vecmas matricën e realizimit. Në këtë rast punonjësit ka detyrim të japin informcionin statistikor të përbashkët në Pikën I dhe të pasqyrojnë të ndarë veprimtarinë për pikat e tjera.***

# Analiza vjetore e punës për punonjësit e shërbimit psiko-social

Në kuadër të arsimit gjithëpërfshirës, për një shkollë të sigurt dhe për krijimin e një klime të ngrohtë dhe miqësore për secilin fëmijë, punonjësit e shërbimit psiko-social shkollor përqendrohen, përveç aspekteve të tjera, edhe në evidentimin e problematikave dhe të arritjeve të përqendruara te nxënësit, si dhe çdo aktor tjetër në institucion arsimor.

Analiza vjetore e punës është dokument i cili pasqyron pikërisht këtë aspekt dhe përqendrohet në dokumentimin e punës, sipas llojit të veprimtarisë (parandalimi, vlerësimi dhe ndërhyrja) të punonjësit të shërbimit psiko-social në institucionin arsimor.

Metodologjia e punës për analizën vjetore, do të bazohet në analizën e matricave të realizimit të punonjësit të shërbimit psiko-social, ku përfshihen:

- Rezultatet e pyetësorëve me nxënës, me mësues, me persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, të zhvilluar gjatë vitit.
- Marrja e informacioneve nga sesionet informuese, hartat sociale, vëshgimet, raportimet/referimet nga mësuesit dhe nga vetë nxënësit.
- Realizimet e këshillimeve/konsultimeve.
- Realizimet e fokus grupeve.

**Modeli 5. Analiza vjetore e punës së shërbimin psiko- social**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ________________**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR __________**

**SHKOLLA "__________________________"**

**Analiza e punës së shërbimit psiko-social në shkollën "____________________".**

## I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I ZHVILLIMIT PSIKO-EMOCIONAL, MIRËQENIES MENDORE E FIZIKE TË FËMIJËVE DHE PROCESIT TË TË NXËNIT NË SHKOLLËN ________________________________ GJATË VITIT SHKOLLOR____________________.

***Bazuar në nevojat e shkollës, si dhe mbështetur në planin vjetor të SHPSSH-së, temat të cilat janë trajtuar gjatë vitit shkollor, janë:***

1. Antitrafikimi i qenieve njerëzore.
2. Roli i psikologut në institucionin arsimor.
3. Të drejtat e fëmijëve.
4. Shëndeti mendor.
5. Mbrojtja e fëmijës në shkollë.
6. –
7. –

## II. TË DHËNA MBI VEPRIMTARITË PARANDALUESE, VLERËSIMET DHE NDËRHYRJET E KRYERA

| Përshkrimi | Numri | Probleme të evidentuara | Hapat e ndërmarrë për kapërcimin e tyre | Rezultati i arritur |
|---|---|---|---|---|
| 2.1 Pyetësorë të kryer | | | | |
| 2.2 Seminare/aktivitete ndërgjegjësuese me nxënës | | | | |
| 2.3 Seminare/aktivitete ndërgjegjësuese me persona të cilët ushtrojnë përgjegjegjësinë prindërore | | | | |
| 2.4 Seminare/aktivitete ndërgjegjësuese me mësues | | | | |
| 2.5 Këshillim/konsultim individual me nxënës | | | | |
| 2.6 Këshillim në grup me nxënës | | | | |
| 2.7 Këshillim në grup me mësues | | | | |
| 2.8 Këshillim/konsultime individuale me mësues | | | | |
| 2.9 Këshillim/Konsultime me persona të cilët ushtrojnë përgjegjegjësinë prindërore | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2.10 Referime pranë NJMF-ës | | | | |
| 2.11 Referime në institucione të tjera (polici, QKSHM etj.) | | | | |
| 2.12 Menaxhim të konflikteve | | | | |

## III. PUNA E KOMISIONIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR PËR NXËNËSIT ME AK

### a. Statistika për nxënësit me AK

| Nr. | Iniciale t e nxënësit | Klasa | Datëlindja | M/f | Diagnoza | Kmcap/kml (po/jo) | Vlerësim kmd (po/jo) | Arsyeja e mosvlerësimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |

### b. Veprimtaria e komisionit

(përshkruani shkurtimisht veprimtarinë vjetore të komisionit të shkollës)

### c. Problematika të vlerësuara nga komisioni i shkollës

(listoni problematikat e evidentuara nga komisioni i shkollës, lidhur me ecurinë e nxënësve, punën individuale të mësuesve ndihmës, punën e mësuesve të klasës dhe atyre lëndorë, integrimi i këtyre nxënësve brenda shkollës, nevoja të paplotësuara, arritje pozitive etj.)

## IV. REZULTATET E ARRITURA GJATË PUNËS VJETORE PËR TË GJITHA PROBLEMATIKAT E SIPËRPËRMENDURA

- **Vështirësitë e ndeshura gjatë punës në shkollë**
- **Arritje pozitive të dukshme**
- **Bashkëpunime**

## V. ÇËSHTJET KU DO TË FOKUSOHET PLANI VJETOR PËR VITIN E ARDHSHËM SHKOLLOR

1.

2.

### Vlerësimi i nevojave për shërbimin psiko-social

Në fund të çdo viti shkollor, punonjësit e shërbimit psiko-social realizojnë vlerësimin e nevojave. Qëllimi i vlerësimit të nevojave është të evidentojë problematikat e hasura gjatë vitit, si dhe shërben si tregues për ndërtimin e planevetëndërhyrjes,të veprimtarive vlerësuese dhe parandaluese/informuese për vitin e ardhshëm shkollor. Ky vlerësim synon të marrë informacion, në lidhje me nevojat kryesore të mësuesve, të prindërve dhe të nxënësve.

Instrumentet e pasqyruara në figurat 6 dhe 7, janë model që u vijnë në ndihmë punonjësve të shërbimit psiko-social shkollor, për vlerësimin e nevojave, në bashkëpunim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe me mësuesit. Bazuar në kontekstin e institucionit arsimor, punonjësit e shërbimit psiko-social përzgjedhin ose hartojnë instrumenta që përmbushin nevojat e tyre për vlerësim.

Vlerësimi i nevojave të nxënësve konsiderohet si proces, i cili evidentohet gjatë vitit shkollor nga punonjësit e shërbimit psiko-social, rezultatet e të cilit u bashkëngjiten të dhënave të marra nga vlerësimi i nevojave të mësuesve dhe të prindërve, në fund të vitit shkollor.

Metodologjia e përdorur me nxënësit gjatë viti shkollor, bazohet në:

- Anketime
- Pyetësorë
- Intervista
- Fokus grupe
- Seminare/aktivitete ndërgjegjësuese, informuese
- Konsultime
- Etj.

# Vlerësimi i nevojave për mësuesit

Metodologjia e përdorur me mësuesit, në fund të vitit shkollor, bazohet në:

- Takimet informuese
- Konsultimet

- Anketimet, për të cilat mund të përdoret instrumenti i pasqyruar në modelin 6.

**Modeli 6. Instrument për vlerësimin e nevojave (për mësues)**

*I nderuar mësues,*

*Ky pyetësor realizohet nga shërbimi psiko-social në shkollë dhe ka për qëllim vlerësimin e nevojave tuaja, në lidhje me shkollën, në funksion të bashkëpunimit me ju, si partner kryesor, në përmirësimin e punës dhe në përmbushjen e qëllimeve tona të përbashkëta, në dobi të nxënësve.*

Gjinia**:** F M

**1- Ju lutemi, zgjidhni përgjigjen më afër nevojave tuaja për ndihmë. Përgjigjet e mundshme:**

1. Aspak nevojë për ndihmë në këtë fushë.
2. Pak nevojë për ndihmë në këtë fushë.
3. Nevoja e moderuar për ndihmë në këtë fushë.
4. Nevoja e madhe për ndihmë në këtë fushë.
5. Nevoja shumë e madhe për ndihmë në këtë fushë.

- _____ Komunikimi me drejtorin.
- _____ Komunikimi me mësues të tjerë.
- _____ Komunikimi me prindërit.
- _____ Organizimi dhe menaxhimi i klasës sime.
- _____ Ruajtja e disiplinës së nxënësve.
- _____ Menaxhimi i kohës dhe i punës sime.
- _____ Motivimi i nxënësve.
- _____ Ndihma e nxënësve me nevoja të veçanta.
- _____ Menaxhimi i stresit.

- _____ Ndihma për nxënësit me vështirësi në të nxënë
- _____Ndihma për nxënësit me nevoja të veçanta.
- _____ Zhvillimi i të menduarit kritik për nxënësit
- _____ Menaxhimi i stresit në punë
- Tjetër ______________________________

**2. Sipas mendimit tuaj, çfarë duhet bërë/ndryshuar/përmirësuar, me qëllim lehtësimin e punës suaj në shkollë?**

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

**3. Ju lutemi, tregoni llojin e seminareve/trajnimeve që do të dëshironi të bëni/të merrni pjesë:**

- Menaxhimi i klasës.
- Vështirësia në të nxënë.
- Aftësia e kufizuar dhe roli i mësuesit në gjithëpërfshirje.
- Komunikimi mësues-nxënës.
- Konfliktet dhe menaxhimi i tyre.
- Stresi në punë (burnout).
- Të tjera:_________________________________________________________.

**4- Çfarë lloj mbështetjeje shtesë duhet t'ju ofrojë gjatë vitit shkollor, shërbimi psiko-social?**

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

**5. Cilat janë nevojat tuaja më të rëndësishme, që mund të adresohen te shërbimi psiko-social në shkollë?**

______________________________________________________________________________

____________________________________________________

# Vlerësimi i nevojave për prindërit

Metodologjia e përdorur me prindërit në fund të vitit shkollor, bazohet në:

- Takimet informuese
- Konsultimet
- Anketimet, për të cilat mund përdoret instrumenti i pasqyruar në modelin 7.

**Modeli 7. Instrument për vlerësimin e nevojave (për prindër)**

*I nderuar prind,*

*Ky pyetësor realizohet nga shërbimi psiko-social në shkollë dhe ka për qëllim vlerësimin e nevojave tuaja në lidhje me shkollën, në funksion të bashkëpunimit, si partner kryesor në përmirësimin e punës sonë dhe në përmbushjen e qëllimeve tona të përbashkëta, në dobi të nxënësve.*

**Gjinia**: F M

**1. Ju informoheni për ecurinë e fëmijës tuaj nëpërmjet (mund të rrethoni edhe më shumë se një alternativë):**

a) Mbledhjeve informuese çdo muaj në shkollë.
b) Takimeve të herë pas hershme me mësuesen kujdestare dhe me mësuesit lëndorë.
c) Bisedave me fëmijën tuaj.
d) Komunikimit me telefon/platforma elektronike.

**2. A jeni në dijeni të problemeve që shfaq fëmija juaj në shkollë?**

**a-** Po **b-** Jo **c**- Nuk shfaq probleme

**Nëse po, ato janë** (rretho):

- Probleme të sjelljes.
- Rezultate të dobëta në mësime.
- Probleme me mësuesit.
- Probleme me shokët e klasës.
- Ngarkesë mësimore.

- Mungesa pa arsye.
- Apo ndonjë problem tjetër____________________________.

4. **Ju lutemi, tregoni llojin e temave për të cilat do të dëshironit të merrnit informacion?**

- Përmirësimi i aftësive tuaja prindërore.
- Menaxhimi i konflikteve.
- Komunikimi me adoleshentët dhe zhvillimi i marrëdhënieve të forta me ta.
- -Fëmijëria dhe zhvillimi fizik dhe emocional.
- -Komunikimi me fëmijët dhe me adoleshentët etj.
- -Tema të sugjeruara nga ju: ______________________________________________.

5. **A do të ishit të gatshëm, të merrni pjesë në takime të tilla informuese:**

**a**- Po **b**- Jo **c**- Nuk kam mundësi

Nëse jeni përgjigjur **"po",** ju lutemi shkruani emrin dhe numrin tuaj të telefonit.

Emri_________________________ Numër telefoni__________________

6. **Si mendoni se mund ta përmirësoni bashkëpunimin tuaj këtë vit me shërbimin psiko-social në shkollë.**

_____________________________________________________________________________

_____________________________________________________________________________

7. **Nëse keni ndonjë ide/koment/sugjerim tjetër për shërbimin psiko-social në shkollë, ju lutem shkruajeni:**

_____________________________________________________________________________

_____________________________________________________________________________

# ZHVILLIMI I VEPRIMTARIVE PARANDALUESE

Veprimtaritë parandaluese zhvillohen nga punonjësit e shërbimit psiko-social, për t'u ardhur në ndihmë nxënësve, prindërve dhe mësuesve në formë informimi/ndërgjegjësimi. Këto veprimtari janë të planifikuara kryesisht, në planin vjetor të punonjësve të shërbimit psiko-social në shkolla, por, sipas nevojës, mund të planifikohen dhe mund të realizohen (ose zëvendësohen) me veprimtari të tjera, të cilat pasqyrohen në planifikimin mujor. Në raste emergjencash, këto veprimtari mund të kryen edhe pa u planifikuar dhe pasqyrohen në matricën mujore të realizimit.

## Planifikimi i veprimtarive parandaluese

Punonjësi i shërbimit psiko-social planifikon në planin vjetor, veprimtari parandaluese të cilat:

a. i ka vlerësuar si të dobishme për grupmoshat me të cilat punon;
b. i ka vlerësuar si emergjente, pasi ka kryer vlerësimin e nevojave dhe analizën vjetore për SHPS-ën;
c. i ka caktuar, në kuadër të ditëve ndërkombëtare, në kalendarin vjetor.

Punonjësi i shërbimit psiko-social realizon veprimtari parandaluese me nxënësit:

a. sipas planifikimit vjetor;
b. sipas nevojave të shkollës në planin mujor;
c. pa planifikim, por të vlerësuara si emergjente.

Punonjësi i shërbimit psiko-social dokumenton veprimtaritë parandaluese të realizuara, me relacion përmbledhës, sipas formateve të miratuara.

**Koha dhe mënyra e realizimit të veprimtarive parandaluese**

Punonjësi i shërbimit psiko-social i realizon veprimtaritë parandaluese (të planifikuara ose sipas nevojës), në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës dhe vetëm duke shfrytëzuar hapësira, që nuk cenojnë procesin mësimor.

# Realizimi për veprimtaritë parandaluese

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Për planifikimin e veprimtarive parandaluese me nxënës, me mësues dhe me prindër, punonjësi i shërbimit psiko-social mundtë përdorë instrumentin, si në modelin 8.

**Modeli 8. Struktura e planifikimit për veprimtaritë parandaluese**

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ________**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR __________**

**SHKOLLA____________________________**

Tema: ______________________________

Kohëzgjatja: _____________________

Qëllimi: ______________________________

Grupi i targetuar: ________________________

Lloji i veprimtarisë:

- Bisedë informuese
- Seminar
- Lojëra psiko-emocionale
- Fokus grup

Metodologjia e veprimtarisë:

Hapi 1:

Hapi 2:

Hapi 3:

Rezultatet e pritshme:

1. ____________________
2. ____________________
3. ____________________
4. ____________________

# Raportimi për veprimtaritë parandaluese

Punonjësi i SHPSH-ës, bazuar në planin vjetor, përkatësisht në fushën parandaluese, realizon në nivel klase dhe shkolle, veprimtari me natyrë psiko-sociale. Formati "Raport veprimtarie" i vjen në ndihmë punonjësit të SHPSSH-ës, të dokumentojë veprimtaritë e kryera. Formati plotësohet një herë për një temë, pavarësisht nga numri i veprimtarive që janë kryer rreth kësaj teme apo numrit të nxënësve/aktorëve të tjerë të interesuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Modeli 9. Struktura e raportimit për veprimtaritë parandaluese**

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ________**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR __________**

**SHKOLLA______________________________**

**Raport veprimtarie**

<table>
<tr><td colspan="2">Titulli i aktivitetit:</td><td colspan="2">Data/datat:<br>_____/_____/________</td><td>□ Klasë<br>□ Shkollë</td></tr>
<tr><td colspan="5">Totali i numrit të pjesëmarrësve:</td></tr>
<tr><td>Nr. i mësuesve:</td><td>Nr. i nxënësve:</td><td colspan="2">Nr. i prindërve:</td><td>Pjesëmarrës të tjerë:</td></tr>
<tr><td colspan="5" align="center">PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT</td></tr>
</table>

| |
|---|
| |
| **REZULTATET E ARRITURA** |
| |
| **REKOMANDIME** |
| |
| **Bashkëpunëtorë në aktivitet:** |
| |

**Punonjësi i shërbimit psiko-social:**_______________________________________

**PLANIFIKIMI I VEPRIMTARIVE VLERËSUESE**

Veprimtaria vlerësuese, e planifikuar në institucionet arsimore nga punonjësit e shërbimit psiko-social, realizohet duke u bazuar në:

- Vlerësimin e nevojave në nivel njësie të shërbimit psiko-social.
- Vlerësimin e nevojave të shkollës.

Veprimtaria vlerësuese mund të planifikohet në planin vjetor/mujor, por mund të realizohet edhe jashtë planit, në kushtet e nevojës.

Veprimtaria vlerësuese e paplanifikuar realizohet në ato raste, kur te punonjësit e shërbimit psiko-social identifikojnë apo u referohen/raportohen problematika, të cilat pengojnë zhvillimin normal dhe ecurinë e fëmijës në mbarëvajtjen në shkollë. Në rastet kur vlerësimi i situatës kërkohet nga një person apo institucion tjetër jashtë IA-së, atëherë punonjësi i shërbimit psiko-social shkollor e përcjell informacionin, vetëm nëpërmjet drejtuesit të IA-së.

# Vlerësimi në kushtet e emergjencës

Punonjësi i shërbimit psiko-social, në situatat emergjente, zgjedh instrumente të përshtatshme ose i harton ato, në përputhje me nevojat e situatës. Punonjësi i shërbimit psiko-social, pasi ka mbledhur informacionet/të dhënat e duhura, i analizon dhe planifikon ndërhyrje në bazë të gjetjeve. Punonjësi i shërbimit psiko-social merr kohën e nevojshme (deri në dy javë), për të vlerësuar në mënyrë të detajuar situatën, dhe shprehet me rekomandime për çdo aktor që do të jetë pjesë e menaxhimit të situatës.

# Vlerësimi i nxënësve me Aftësi të Kufizuara (AK)

Për të kryer vlerësimin e nevojave të nxënësit, punonjësi i shërbimit psiko-social në shkollë, duhet fillimisht të bëjë dallimin midis nxënësve që paraqesin vështirësi në të nxënë dhe nxënësve të cilët kanë një aftësi të kufizuar. Vlerësimi i këtyre nxënësve kryhet me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e nevojave, në aspektin e arritjeve dhe zhvillimit psiko-emocional. Punonjësi i shërbimit psiko-social kryen vlerësim periodik dhe/ose sipas nevojës të nxënësve me nevoja të veçanta pasi ka

marrë miratimin e informuar nga prindi/kujdestari ligjor i fëmijës. Punonjësi SHPSSH-së kryen vlerësim periodik ose sipas nevojës (1-2 herë në vit) në rastet, kur:

A. Nxënësi është i pajisur me raport mjekësor dhe prindi i ka vendosur në dispozicion shkollës raportin, i cili vërteton vështirësinë dhe/ose aftësinë e kufizuar të fëmijës.
B. Për nxënësin, referohet nga një ose disa mësues se ka vështirësi për t'iu përgjigjur kërkesave të procesit mësimor, se manifeston vështirësi të vëmendjes dhe të përqendrimit, vështirësi të të folurit dhe të komunikimit, vështirësi për të ndjekur dhe për të zbatuar rregullat në klasë, vështirësi të ndërveprimit social etj.
C. Gjatë veprimtarive në klasa (vëzhgim, parandalim, lojëra etj.), identifikon nxënës që paraqesin problematika në komunikim, në ndërveprim, në vëmendje, në sjellje etj.
D. Prindi referon se nxënësi paraqet vështirësi në përmbushjen e detyrave shkollore, në menaxhimin e sjelljes, në krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve ndërpersonale dhe/ose manifeston sjellje agresive.

# Veprimet e punonjësit rast pas rasti

**Rasti A**: Nxënësi është i pajisur me raport mjekësor dhe prindi i ka vendosur në dispozicion shkollës raportin, i cili vërteton vështirësinë dhe/ose aftësinë e kufizuar të fëmijës.

Veprimet që ndiqen nga punonjësi:

1. Njihet me raportin mjekësor dhe me specifikat e diagnozës/vështirësisë/çrregullimit.
2. Vëzhgon nxënësin 2-4 orë, gjatë procesit mësimor dhe qëndrimit në mjediset e klasës/shkollës, gjatë një periudhë të paktën dyjavore. Gjatë vëzhgimit plotëson instrumentet/listat e kontrollit, sipas specifikave.
3. Merr informacion nga mësuesi kujdestar dhe/ose mësuesit lëndorë mbi vështirësitë e nxënësit, të referuara prej tyre.
4. Merr informacionin e nevojshëm nga prindi (anamnezë, historikun, shërbimet terapeutike që ka marrë nxënësi, nëse ka marrë etj.).
5. Kryen vlerësimin në prani ose jo të prindit, në mjedis të përshtatshëm e konfindencial dhe informon prindin për rezultatet e vlerësimit.

6. Informon mësuesin/mësuesit për vështirësitë dhe për nevojat e nxënësit, gjatë kohës së qëndrimit në shkollë.
7. Kopja e vlerësimit i bashkëlidhet dosjes së nxënësit, kur paraqitet për vlerësim të nevojave dhe për përfitimin e mbështetjes me mësues ndihmës, pranë komisionit multidisiplinar në ZVAP, dosjes së nxënësit në shkollë dhe mund t'i jepet prindit, me kërkesë të tij.

**Rasti B:** Kur nxënësi referohet nga një ose disa mësues, se ka vështirësi për t'iu përgjigjur kërkesave të procesit mësimor, manifeston vështirësi të vëmendjes dhe të përqendrimit, vështirësi të të folurit dhe të komunikimit, vështirësi për të ndjekur dhe për të zbatuar rregullat në klasë, vështirësi të ndërveprimit social etj.

Veprimet që ndiqen nga punonjësi:

1. Vëzhgon nxënësin 2-4 orë gjatë procesit mësimor dhe qëndrimit në mjediset e klasës/shkollës, të paktën për një periudhë dyjavore. Gjatë vëzhgimit plotëson instrumentet/listat e kontrollit sipas specifikave.
2. Merr informacion nga mësuesi kujdestar dhe/ose mësuesit lëndorë mbi vështirësitë e nxënësit, të referuara prej tyre.
3. Zhvillon me klasën 1-2 aktivitete ndërvepruese, për identifikimin e vështirësive të referuara.
4. Zhvillon takim individual me prindin, për të marrë informacion mbi gjendjen dhe vështirësitë e fëmijës dhe e informon prindin për nevojën e një vlerësimi nga punonjësi SHPS-ës në shkollë.
5. Nëse ka konstatuar se vështirësitë e referuara janë prezentë, kryen vlerësimin në një mjedis të përshtatshëm e konfindencial në shkollë dhe informon prindin për rezultatet e vlerësimit.
6. Referuar rezultateve të vlerësimit, punonjësi SHPS-ës vepron si vijon, në varësi të ecurisë:

   - Referon rastin për vlerësim të shëndetit mendor dhe pajisje me raport mjekësor.
   - Harton plan ndërhyrjeje dhe trajton rastin në bashkëpunim me prindin dhe me mësuesit.
   - Referon rastin pranë punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në njësinë administrative, kur prindi refuzon ofrimin e shërbimeve të

rekomanduara për plotësimin e nevojave, në interesin më të lartë të fëmijës.

**Rasti C**: Gjatë veprimtarive në klasa (vëzhgim, parandalim, lojëra etj.) identifikon nxënës që paraqesin problematika në komunikim, në ndërveprim, në vëmendje, në sjellje etj.

Veprimet që ndiqen nga punonjësi:

1. Merr informacion nga mësuesi kujdestar dhe/ose mësuesit lëndorë mbi vështirësitë e nxënësit të vëzhguar.
2. Vëzhgon nxënësin 2-4 orë gjatë procesit mësimor dhe qëndrimit në mjediset e klasës/shkollës, për një periudhë të paktën dyjavore.
3. Zhvillon takim individual me prindin, për të marrë informacion mbi gjendjen dhe vështirësitë e fëmijës, dhe informon prindin për nevojën e një vlerësimi nga punonjësi SHPS-ës në shkollë.
4. Kryen vlerësimin në një mjedis të përshtatshëm e konfindencial në shkollë dhe informon prindin për rezultatet e vlerësimit.
5. Referuar rezultateve të vlerësimit punonjësi SHPS-ës vepron si vijon, në varësi të ecurisë:

- Referon rastin për vlerësim të shëndetit mendor dhe pajisje me raport mjekësor.
- Harton plan ndërhyrjeje dhe trajton rastin në bashkëpunim me prindin dhe me mësuesit.
- Referon rastin pranë punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në njësinë administrative, kur prindi refuzon ofrimin e shërbimeve të rekomanduara për plotësimin e nevojave, në interesin më të lartë të fëmijës.

**Rasti D:** Prindi referon se nxënësi paraqet vështirësi në përmbushjen e detyrave shkollore, në menaxhimin e sjelljes, në krijimin dhe në mbajtjen e marrëdhënieve ndërpersonale dhe/ose manifeston sjellje agresive.

Veprimet që ndiqen nga punonjësi:

1. Zhvillon takim individual me prindin, për të marrë informacion të zgjeruar mbi gjendjen dhe vështirësitë e fëmijës.
2. Merr informacion nga mësuesi kujdestar dhe/ose mësuesit lëndorë mbi vështirësitë e nxënësit, të pretenduara nga prindi.
3. Vëzhgon nxënësin 2-4 orë gjatë procesit mësimor dhe qëndrimit në mjediset e klasës/shkollës, përgjatë një periudhe të paktën dyjavore.
4. Kryen vlerësimin në një mjedis të përshtatshëm e konfindencial në shkollë dhe informon prindin për rezultatet e vlerësimit.
5. Referuar rezultateve të vlerësimit, punonjësi i shërbimit psiko-social vepron si vijon:

- Referon rastin për vlerësim të shëndetit mendor dhe/ose pajisje me raport mjekësor.
- Harton plan ndërhyrjeje dhe trajton rastin në bashkëpunim me prindin dhe me mësuesit.
- Referon rastin pranë punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në njësinë administrative, kur prindi refuzon ofrimin e shërbimeve të rekomanduara për plotësimin e nevojave në interesin më të lartë të fëmijës.

# SHKALLA E VLERËSIMIT TË RISKUT PËR NXËNËSIT

Vlerësimi i hershëm i faktorëve të rrezikut që ndikojnë në sjelljen, mirëqenien dhe zhvillimin e një nxënësi është një proces thelbësor në punën e përditshme të shërbimit psiko-social në shkollë. Për këtë qëllim, është hartuar një instrument që mundëson vlerësimin e rrezikut individual të secilit nxënës përmes një strukture të ndarë në pesë fusha kryesore: sjellja, shëndeti, emocionet, përformanca akademike dhe faktorët socialë.

Ky instrument është ndërtuar mbi bazën e një shkalle vlerësimi Likert 1–5, ku çdo pohim vlerësohet në funksion të shpeshtësisë dhe intensitetit me të cilin shfaqet. Pra, nuk mjafton vetëm prania e një sjelljeje ose gjendjeje – por sa e fortë është ajo dhe sa shpesh ndodh. Kjo qasje e kombinuar synon të japë një pasqyrë më të plotë dhe të saktë të riskut real që një nxënës mund të përjetojë.

**Faktorët që analizohen dhe rëndësia e tyre:**

**Sjellja**

Në këtë fushë vlerësohen modele të sjelljes që mund të tregojnë një rrezik të lartë për përfshirje në veprime të dhunshme, kundërshtuese apo të izoluara. Sjelljet si agresiviteti i përsëritur, sfidimi ndaj autoritetit, mungesa e empatisë apo përdorimi i gjuhës fyese nuk duhen parë thjesht si probleme disiplinore, por si sinjale paralajmëruese për shqetësime më të thella emocionale ose mjedisore.

**Shëndeti**

Faktorët shëndetësor përfshijnë çrregullime të shëndetit mendor, pasoja nga trauma të pashëruara, probleme neurologjike, varësi nga substancat ose efekte anësore nga trajtime farmakologjike. Gjendjet shëndetësore që prekin sistemin nervor dhe zhvillimin njohës mund të ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si nxënësi sillet, mëson dhe ndërvepron me të tjerët.

**Gjendja emocionale**

Kjo është ndoshta një nga fushat më të ndjeshme dhe shpesh më pak të dukshme. Mungesa e aftësisë për të menaxhuar emocionet, vetëvlerësimi i ulët, ndjenja e

përjashtimit, frika ose ndjeshmëria ndaj padrejtësive, janë shenja që kërkojnë vëmendje të menjëhershme. Nxënësit që nuk ndihen të sigurt emocionalisht, shpesh zhvillojnë mekanizma mbrojtës që mund të keqinterpretohen si sjellje problematike.

**Performanca akademike**

Vështirësitë e përsëritura në të nxënë, mungesat në orë, nota të ulëta dhe mungesa e motivimit për të mësuar nuk janë thjesht tregues të paaftësisë ose dembelizmit, por mund të jenë pasqyrim i sfidave më të thella emocionale, sociale ose mendore. Kur një nxënës ndjen se shkolla nuk i ofron mundësi suksesi, ndjenja e dështimit shndërrohet në një barrë që ushqen vetëpërjashtimin dhe rrezikun për braktisje.

**Mjedisi social dhe familjar**

Asnjë vlerësim nuk mund të jetë i plotë pa analizuar kontekstin në të cilin jeton nxënësi. Konfliktet familjare, varfëria, mungesa e mbështetjes prindërore, përfshirja në grupe problematike, ekspozimi ndaj dhunës apo diskriminimit janë faktorë të jashtëm, por me ndikim të thellë dhe të drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe sjelljen e nxënësit.

**Rëndësia e instrumentit për ndërhyrje të hershme**

Duke vlerësuar secilin nga këta faktorë përmes këtij instrumenti, psikologët dhe punonjësit socialë të shkollës mund të identifikojnë nxënësit në risk dhe të hartojnë plane individuale ndërhyrjeje që adresojnë burimet e vështirësive, dhe jo vetëm simptomat e tyre. Ky vlerësim bëhet baza për kontakt të strukturuar me prindërit, për të ndërtuar një bashkëpunim efektiv shkollë–familje, si dhe për të marrë vendime për referim në shërbime të specializuara, nëse është e nevojshme.

**Modeli 10. Shkalla e vlerësimit të riskut për nxënësit**

Emër Mbiemër ______________________________________

Klasa ________________________________________

Punonjësit e shërbimit psiko-social vlerësojnë sipas shkallës likert 1-5 (1 ulët, 5 shumë e lartë) rrezikun në të cilën mund të gjendet nxënësi sipas fushave. Për të vlerësuar shkallën e matjes për secilin nga faktorë punonjësi i shërbimit psiko-social do të marrë në konsideratë intensitetin dhe shpeshtësinë (frekuenca) për secilin faktor.

| Nr. | Pohimi | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Faktorët sjellor** | | | | | |
| 1. | Sjellje agresive të përsëritura | | | | | |
| 2. | Mungesë empatie për të tjerët | | | | | |
| 3. | Vështirësi në kontrollin e impulsit | | | | | |
| 4. | Ndjeshmëri e ulët ndaj pasojave të veprimeve | | | | | |
| 5. | Përdorim i gjuhës fyese ose kërcënuese | | | | | |
| 6. | Shfaqje e zemërimit në mënyrë të papërshtatshme | | | | | |
| 7. | Sjellje sfiduese ndaj autoritetit | | | | | |
| 8. | Izolim social ose vështirësi në krijimin e marrëdhënieve | | | | | |
| 9. | Nënvlerësim i normave dhe rregullave sociale | | | | | |
| 10. | Kërkimi i vëmendjes përmes sjelljeve provokuese | | | | | |
| 11. | Ndikim nga modele dhune në familje ose komunitet | | | | | |
| 12. | Mungesë përfshirjeje në aktivitete pozitive jashtë mësimit | | | | | |
| 13. | Qëndrim armiqësor ndaj bashkëmoshatarëve | | | | | |
| | **Faktorët shëndetësor** | | | | | |
| 14. | Çrregullime të shëndetit mendor (si çrregullimi i sjelljes, ADHD, çrregullime të humorit) | | | | | |
| 15. | Traumat psikologjike të pashëruara | | | | | |
| 16. | Abuzimi me substanca psikoaktive (alkool, drogë) | | | | | |
| 17. | Dëmtime neurologjike ose tronditje në tru | | | | | |
| 18. | Probleme të theksuara me gjumin (pagjumësi, çrregullime të ritmit cirkadian) | | | | | |
| 19. | Çrregullime të ankthit ose depresionit të patrajtuar | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 20. | Deficite në zhvillimin njohës ose vonesa zhvillimore | | | | | |
| 21. | Çrregullime të spektrit autik me shfaqje të sjelljeve impulsive ose agresive | | | | | |
| 22. | Ndikimi i efekteve anësore të medikamenteve | | | | | |
| 23. | Ushqyerje e dobët ose çrregullime të të ushqyerit që ndikojnë në gjendjen emocionale | | | | | |
| **Faktorët emocional** | | | | | | |
| 24. | Vështirësi në menaxhimin e emocioneve (si zemërimi, frustrimi, trishtimi) | | | | | |
| 25. | Vetëvlerësim i ulët | | | | | |
| 26. | Ndjenja të forta të refuzimit ose përjashtimit | | | | | |
| 27. | Ndjenja të pafuqisë ose humbjes së kontrollit | | | | | |
| 28. | Mungesë e sigurisë emocionale në mjedisin familjar ose shkollor | | | | | |
| 29. | Ndjenja të akumuluara të padrejtësisë ose hakmarrjes | | | | | |
| 30. | Mungesë e aftësive për të shprehur ndjenjat në mënyrë të shëndetshme | | | | | |
| 31. | Frikë e vazhdueshme ose ankth i pamenaxhuar | | | | | |
| 32. | Tendenca për të përjetuar situatat neutrale si kërcënuese | | | | | |
| 33. | Ndjenja të theksuara ziliqarie ose krahasimi me të tjerët | | | | | |
| **Faktorët akademik** | | | | | | |
| 34. | Vështirësi të vazhdueshme në të nxënë | | | | | |
| 35. | Nota të ulëta | | | | | |
| 36. | Mungesë motivimi për të mësuar | | | | | |
| 37. | Ndjenja dështimi ose zhgënjimi në mjedisin shkollor | | | | | |
| 38. | Mungesë mbështetjeje pedagogjike individuale | | | | | |
| 39. | Pjesëmarrje e ulët në orë dhe mungesa të shpeshta | | | | | |
| 40. | Mungesë përfshirjeje në aktivitete pozitive shkollore | | | | | |
| 41. | Ndjenja që shkolla nuk ofron mundësi suksesi | | | | | |
| **Faktorët social** | | | | | | |
| 42. | Mjedis familjar me konflikte, dhunë apo neglizhencë | | | | | |
| 43. | Varfëri dhe kushte të vështira ekonomike | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 44. | Mungesë mbështetjeje nga prindërit ose kujdestarët ligjor | | | | | |
| 45. | Shokë ose modele sociale me sjellje të dhunshme | | | | | |
| 46. | Përfshirje në grupe problematike ose banda | | | | | |
| 47. | Mungesë e përfshirjes në aktivitete sociale pozitive | | | | | |
| 48. | Diskriminim, stigmatizim ose përjashtim social | | | | | |
| 49. | Margjinalizim kulturor ose etnik | | | | | |
| 50. | Ekspozim i shpeshtë ndaj dhunës në komunitet | | | | | |
| **Total** | | | | | | |

**Legjendë:**

- Faktorët sjellor - përfshihen përdorimi i substancave, shkelje e rregullave, mbajtja e mjeteve të rrezikshme, sfidimi kundërshtimi i vazhdueshëm etj.
- Faktorët shëndetësor - përfshihen sëmundje akute, kronike.
- Faktorët emocional – përfshihen mungesa e aftësisë për të identifikuar, verbalizuar, menaxhuar emocionet si dhe për të kuptuar emocionet e të tjerëve.
- Faktorët akademikë – përfshihen rezultatet mësimore, notat e ulëta, frekuentimi i shkollës, vështirësi në mësime.
- Faktorët social- përfshihen aftësia për të krijuar, mbajtur marrëdhënie respekti me personat e tjerë, presioni nga bashkëmoshatarët, përjashtimi social.

**Vlerësimi:**

50-75 pikë nivel shumë ulët Ii rrezikut

76-125 pikë nivel i ulët i rrezikut

126-175 pikë nivel i moderuar i rrezikut

176-225 pikë nivel i lartë i rrezikut

226-250 pikë nivel shume i lartë i rrezikut

**Modeli 11. Vlerësimi psiko social i nxënësit**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ________**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR __________**

**Datë_________________**

**VLERËSIM PSIKO-SOCIAL**

Nxënësi/nxënësja_____________, i/e datëlindjes ______________, i/e moshës ________________, aktualisht ndjek klasën __________________ dhe është/nuk është i/e pajisur me KML/KMCAP.

Diagnoza e përcaktuar nga komisioni mjeko-ligjor ose KMCAP, nëse ka:_____________________.

Gjatë vëzhgimeve të fëmijës në klasë, bisedave, konsultimeve me fëmijën, me mësuesin kujdestarë, me mësuesit e lëndëve dhe me prindërit, vlerësimit të bërë në aspektin zhvillimor motorik, gjuhësor, sjellor, mendor, social, mësimor, gjendja psiko-sociale shfaqet, si më poshtë:

***Zhvillimi motorik (fin dhe global):***

_____________________________________________________________________

_____________________________________________________________________

***Gjuha dhe komunikimi:***

_____________________________________________________________________

_____________________________________________________________________

***Ndjenjat, afekti dhe gjendja emocionale:***

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

***Sjellja:***

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

***Të menduarit (funksioni intelektual, orientimi, njohja me mjedisin rrethues, përqendrimi, vëmendja, kujtesa, gjykimi, niveli i vetëdijes):***

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

***Funksionimi social:***

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

***Ecuria mësimore:***

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

***Marrëdhëniet me prindërit, me mësuesin, me bashkëmoshatarët:***

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

***Gjendja sociale-ekonomike në familje:***

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

***Vlerësoj se nxënësi paraqet këto problematika:***

_______________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________

***Rekomandoj që nxënësi*** ______________________________:

________________________________________________________________________

**Punonjësi i shërbimit psiko-social**

____________________________

Ky dokument mbledh dhe përpunon të dhëna personale në përputhje me Ligjin Nr. 124/2024 për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale.

# Vlerësimi psiko-edukativ i nxënësit

Vlerësimi psiko-edukativ kryhet nga psikologu i shkollës. Ai përmban të dhëna mbi aftësitë të fëmijës, për t'iu përgjigjur detyrave si nxënës, aftësitë sociale siç janë krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve me bashkëmoshatarët apo të rriturit e tjerë, aftësi të kujdesit personal, të vetëvlerësimit etj., të cilat psikologu i shkollës ka në vëmendjen e tij, gjatë vlerësimit psiko-edukativ të fëmijës. Psikologu shkollor gjatë vlerësimit të fëmijës, fokusohet kryesisht te situata social-emocionale dhe/ose zhvillimore përkatëse për moshën e fëmijës.

Në bashkëpunim me mësuesit dhe me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, psikologu shkollor vlerëson, sa më herët, nxënësit me shqetësime emocionale dhe të sjelljes dhe në bashkëpunim me persona në ndihmë të fëmijës (punonjës socialë, mësues, prindër etj.), harton e zbaton për këta nxënës, plane ndërhyrje individuale.

Punonjësi i shërbimit psiko-social nëpërmjet metodave indirekte, si p.sh.: analiza e materialeve të shkruara nga nxënësi, vëzhgimeve, konsultimeve me mësues dhe me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, listëkontrolli, intervista me n nxënësin, si dhe administrimit të testeve të individualizuara, sipas rastit, problematikës dhe nivelit të riskut, dokumenton vlerësimin psiko-edukativ të fëmijës, në formatin e paraqitur në modelin 12.

**Modeli 12. Vlerësimi psiko edukativ i nxënësit**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**
**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _______**
**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _________**

**Datë**_____/_____/________

**VLERËSIM PSIKO - EDUKATIV**

Nxënësi/ nxënësja _____________, i/e datëlindjes _____________, i/e moshës _____________, aktualisht ndjek klasën _________________

Gjatë vëzhgimeve të fëmijës në klasë, bisedave, konsultimeve me fëmijën, me mësuesin kujdestar, me mësuesit e lëndëve dhe me prindërit, vlerësimit të bërë në aspektin zhvillimor, motorik, gjuhësor, sjellor, mendor, social, mësimor, gjendja psikologjike shfaqet si vijon:

**Paraqitja, veshja, higjiena, postura e trupit dhe kontakti me sy:**

________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

**Zhvillimi gjuhësor (të folurit dhe komunikimi):**

________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

**Humori, afekti dhe gjendja emocionale:**

________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

**Vëmendja dhe përqendrimi:**

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

**Sjellja në ambientet shkollore:**

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

**Të menduarit (njohja me mjedisin rrethues, gjykimi, niveli i vetëdijes, koherenca e mendimeve):**

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

**Funksionimi social dhe marrëdhëniet ndërpersonale:**

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

**Vetëvlerësimi:**

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

**Ecuria mësimore:**

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

**Vlerësoj se nxënësi paraqet këto problematika:________________________________**

**Rekomandoj që nxënësi ____________________:**

______________________________________________________________________

______________________________________________________________

**Psikolog/e: ______________________**

Ky dokument mbledh dhe përpunon të dhëna personale në përputhje me Ligjin Nr. 124/2024 për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale.

# Formate për veprimtaritë vlerësuese

**Harta sociale** i vjen në ndihmë punonjësit të SHPSSH-ës, për të pasur një pasqyrë të gjendjes sociale në IA. Punonjësi i SHPSSH-ës, në bashkëpunim me mësuesin kujdestar, plotëson këtë format në nivel klase. Të dhënat e mbledhura nga secila klasë, më pas, dokumentohen në nivel shkolle. Harta sociale plotësohet çdo fillim të vitit shkollor dhe përditësohet gjatë vitit shkollor, sipas ndryshimeve përkatëse. Harta sociale e shkollës realizohet deri në fund të muajit tetor dhe një kopje e saj i dorëzohet drejtorit të shkollës. Për kategori të hartës sociale, të cilët kanë përqindje të konsiderueshme dhe janë të rëndësishëm për komunitetin shkollor, punonjësi SHPS-së vlerëson nevojën për hatimin e planeve të ndërhyrjes.

**Modeli 13. Harta sociale për klasën**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ________**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR __________**

**SHKOLLA_____________________________**

**HARTA E GJENDJES SOCIALE 202____ - 202____**

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | **Nr.** | **KLASA ________** |
| **Numri i nxënësve në klasë** | | | MËSUES KUJDESTAR |
| **Numri i femrave në klasë** | | | |
| **Arsimi i prindërve** | **I lartë** | | |
| (shëno vetëm njërin prej prindërve, atë me nivelin arsimor më të lartë) | **I mesëm** | | |
| | **8-vjeçar** | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | **< 8-vjeçar** | |
| **NR** | **Problematika** | **Emri mbiemri i nxënësit** | |
| **1** | Nxënës nga familje me ndihmë ekonomike. | | |
| **2** | Nxënës pa njërin prind (që ka humbur jetën). | | |
| **3** | Nxënës pa të dy prindërit | | |
| **4** | Nxënës që kanë fituar statusin jetim | | |
| **5** | Nxënës me prindër të divorcuar. | | |
| **6** | Nxënës që nuk janë nën kujdestarinë e prindërve. | | |
| **7** | Nxënës që janë në përkujdesje institucionale. | | |
| **8** | Nxënës të kthyer nga emigracioni. | | |
| **9** | Nxënës me nënshtetësi të huaj. | | |
| **10** | Nxënës të rikthyer nga zona të konfliktit. | | |
| **11** | Nxënës të komunitetit rom. | | |
| **12** | Nxënës të komunitetit egjiptian. | | |
| **13** | Nxënës përsëritës. | | |
| **14** | Nxënës braktisës. | | |
| **15** | Nxënës me tendencë braktisje. | | |
| **16** | Nxënës me probleme të sjelljes. | | |
| **17** | Nxënës që abuzojnë me duhanin, me alkoolin etj. | | |
| **18** | Nxënës me talente në fusha të ndryshme (sport, muzikë, pikturë, letërsi). | | |
| **19** | Nxënës shumë të dobët në mësime. | | |
| **20** | Nxënës me vështirësi në të nxënë që ka nevojë për një plan ndërhyrjeje. | | |
| **21** | Nxënës me çrregullim në të nxënë (disleksi, diskalkuli etj.), me raport/vlerësim nga mjeku. | | |
| **22** | Nxënës të ardhur të rinj, nga shkolla të tjera. | | |
| **23** | Nxënës me problematika shëndetësore. | | |
| | **Aftësi e kufizuar** | | |
| | **a-** prapambetje mendore | | |
| | **b-** fizike (lëvizore) | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **c-** | problematika të shëndetit mendor + problematika fizike (lëvizore) | | |
| | **d-** | me shumë diagnoza | | |
| | **e-** | verbëri (e plotë/e pjesshme) | | |
| | **f-** | shurdhëri (e plotë/e pjesshme) | | |
| | **g-** | të folur (i plotë/i pjesshëm) | | |
| | **h-** | autizëm | | |
| | **i-** | sindroma DOËN | | |

**Vëzhgimi** si mjet për të vlerësuar nxënësit, i shërben grumbullimit të të dhënave. Punonjësi SHPS-ësi cili ka për detyrë të vëzhgojë nxënësin, regjistron të dhënat e mbledhura nga vëzhgimi dhe kryen analizën pasuese, për të kuptuar problematikën e nxënësit.

**Modeli 14. Formulari për vëzhgimin e nxënësit**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ________**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR __________**

**SHKOLLA_____________________________**

**FORMULAR VËZHGIMI**

Emri mbiemri : _______________ Data e vëzhgimit: _____/_____/________

Institucioni arsimor:___________________

Punonjësi i SHPSSH:___________________________

***Lloji i aktivitetit*** (orë mësimi, lojë e lirë, aktivitet jashtëshkollor):

_________________________________________________________________

_________________________________________________________________

_________________________________________________________________

***Mënyra e vëzhgimit:***

▫ Vëzhgim në klasë ▫ Vëzhgim në ambiente të tjera ▫ Gjatë këshillimit/konsultimit ▫ Tjetër

***Qëllimi i vëzhgimit:***

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

***Sjellja e nxënësit gjatë vëzhgimit ose bashkëbisedimit:***

 Agresiv  I/e izoluar (nuk ka kontakt me të tjerët)  Shumë aktiv, mungesë përqendrimi  I trishtuar  Nuk respekton rregullat  Ngacmon të tjerët  I turpshëm  Shumë i lidhur me të rriturit Tjetër,_________________________

***Qëndrimi i fëmijës ndaj bashkëmoshatarëve:***

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

Për të vlerësuar një ngjarje si traumatike për fëmijën, duhen vlerësuar mirë disa faktorë njëkohësisht:

- ***Gurët kilometrikë të zhvillimit***
- ***Detyrat e zhvillimit*** të çdo individi, sipas moshës dhe kulturës

Në çdo kulturë, fëmijët sipas moshës përkatëse, kanë disa detyra për të plotësuar: një fëmijë rreth 1 vjeç duhet të shkëputet nga gjiri, një fëmijë 2 vjeç duhet të jetë ngritur më këmbë dhe të ecë, një fëmijë 6 vjeç duhet të jetë gati të shkojë në shkollë, një fëmijë 8 vjeç duhet të ketë arritje akademike të kënaqshme, një fëmijë 14 vjeç duhet të dallojë të mirën nga e keqja etj.

- ***Vështirësitë e zhvillimit*** të çdo individi, sipas moshës dhe kulturës

Në çdo moshë, individi has disa vështirësi në realizimin e detyrave përkatëse. Këto vështirësi mund të jenë *të brendshme* (probleme mjekësore ose psikologjike) ose

*të jashtme* (marrëdhënie problematike me të rriturit, ambient i papërshtatshëm). Vështirësitë e zhvillimit mund të jenë të niveleve të ndryshme, pra ato mund të jenë të natyrshme dhe, si të tilla, të kapërcehen lehtësisht, ndërkohë që vështirësi të tjera mund të kenë nevojë për këshillim/konsultim mjekësor ose psikologjik, psikoterapi etj.

- ***Situata traumatike***

Ka ngjarje traumatike për të gjithë individët, pavarësisht nga mosha, por nga ana tjetër në vlerësimin e ngjarjes si traumatike, duhet të marrim parasysh edhe konceptin personal të individit që e përjeton atë. Për shembull, vdekja e prindërve është një ngjarje traumatike për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga mosha, gjinia apo kultura e tyre. Mungesa e strehimit mund të jetë një ngjarje traumatike për një familje.

Për të kuptuar sa traumatike është një ngjarje e caktuar, vlerësohen një sërë faktorësh, si: numri dhe rëndësia e ngjarjeve që i kanë ndodhur fëmijës; ekspozimi fizik i fëmijës ndaj vendngjarjes, afrimiteti i fëmijës me personin e dëmtuar, të vrarë, të kërcënuar, të dhunuar ose të humbur; efekti surprizë i ngjarjes, perceptimi i të qenit i kërcënuar në vazhdimësi; faktet reale të para nga fëmijët (jo të imagjinuara), si dhe vazhdimësia e plagëve/dhembjeve të personit të dhunuar ose të vetë fëmijës, kur ai është viktima.

***<u>Ngjarje traumatike</u>***

**Fatkeqësi natyrore** janë tërmetet, shpërthimi i një vullkani, përmbytjet, rënia e zjarrit, uraganet, ciklonet etj.

**Fatkeqësi të shkaktuara nga njeriu** janë fatkeqësitë si pasojë e teknologjisë (aksidente rrugore, aksidente në vendin e punës nga makineri të ndryshme, lufta, shpërthim eksplozivi, procedura mjekësore të dhembshme etj.) dhe fatkeqësi të tjera si pasojë e agresionit human (terrorizmi, tortura, vrasja, përdhunimi, rrëmbimi etj.).

**Fatkeqësi brenda familjes** përfshijnë abuzimet psikologjike, emocionale dhe seksuale (nga prindërit, nga motrat e vëllezërit, nga familjarë të tjerë), dhunën e

rëndë midis prindërve, ndarjen e fëmijës nga familja, sëmundjet e rënda ose kronike personale, sëmundjet e rënda të prindërve, vdekjen e prindërve.

***Grupet e fëmijëve të prekur/në risk për trauma***

Ka disa kategori ose grupe fëmijësh të cilët janë të prekura nga traumat ose janë më të riskuara të ekpozohen ndaj një ngjarjeje traumatike. Kategoritë/grupet e fëmijëve janë:

- Fëmijët e abuzuar fizikisht, emocionalisht dhe seksualisht.
- Fëmijët me prindër të divorcuar ose të vdekur.
- Fëmijët me sëmundje kronike terminale.
- Fëmijët dëshmitarë të dhunës në familje.

**Reagimet më tipike që vihen re te fëmijët e traumatizuar**

***Frika –*** Kjo mund t'u shtohet nga prania në shfaqjet e filmave me luftë, horror, nga errësira, nga lartësitë, nga të qenët vetëm etj.

***Simptoma psiko-somatike*** – Dhimbje koke, stomaku, mungesë oreksi etj

***Probleme me gjumin*** – Makthe nate (ku gjatë gjumit i ripërsëriten skenat traumatike), gjumë i çrregullt etj.

***Shenja regresive*** – Eneuresis, enkopresis etj.

***Shenja depresive*** – Dëshpërim, mosbesim, humbje interesi për aktivitetet, trishtim, izolim, etj.

***Ndryshime në sjellje*** – Nervozitet, impulsivitet, kundërshtimi i rregullave, etj.

***Probleme në shkollë*** – Sjellje agresive dhe konfliktuale, ecuri e dobët në mësime, mospërqendrim, etj.

***Probleme me marrëdhëniet familjare*** – Marrëdhënie konfliktuale.

Nëse stresi vazhdon për një kohë të gjatë, ndryshimet mund të bëhen të qëndrueshme dhe kjo gjë evidentohet me shenjat e një shëndeti jo të mirë.

***Si mund të evidentoni dhe të ndihmoni një fëmijë të traumatizuar?***

- *Vëzhgoni vizatimet* e fëmijës. Vini re me kujdes ngjyrat, format dhe linjat (hijëzimet) e vizatimeve.
- *Vëzhgoni sjelljet* e fëmijës gjatë lojës.
- *Vini re angazhimin dhe përfshirjen* e fëmijës në aktivitetet argëtuese dhe edukative të organizuara.
- *Flisni me fëmijën* në lidhje me ngjarjen ose dyshimet tuaja. Kujdes! Mos sugjeroni! Përdorni gjuhë të kuptueshme për fëmijën dhe të përshtatshme për situatën. Shpjegojini fëmijës ngjarjen. Ndihmojeni atë të dallojë realitetin nga imagjinata.
- *Flisni me familjarët ose me mësuesit* e fëmijës, për t'i informuar ata/ato dhe për t'i sqaruar gjendjen e fëmijës.
- *Ofroni siguri dhe rutinë të strukturuar të ditës*, për fëmijët e traumatizuar. Komunikojini fëmijës aktivitetet dhe oraret. Flisni me fëmijën në rast tëndryshimeve të papritura.
- *Ofroni mbështetje dhe afeksion ndaj fëmijëve*, por në mënyrën e duhur. Bëni kujdes, veçanërisht me fëmijët e abuzuar fizikisht ose seksualisht.
- *Mbroni fëmijën*. Nëse vini re se një aktivitet i caktuar e streson fëmijën ose i sjell ripërjetime të ngjarjes traumatike, largojeni fëmijën ose ndaleni aktivitetin.
- *Referojeni, i sugjeroni familjes të bëjë një konsultë me specialistin* (mjekun pediatër, psikologu klinik ose mjekun psikiatër).

Zakonisht, fëmijët nuk janë në gjendje të verbalizojnë ndjenjat dhe perceptimet e tyre mbi traumën, por aktivitetet sensoriale, si vizatimi apo aktivitete të tjera artistike, janë gjuha natyrale e shprehjes së zisë dhe traumës fëminore (Gil, 1991).

Te fëmijët të cilët njohin figurat e njerëzve, të kafshëve, të pemëve dhe të elementeve të tjera mjedisore, vizatimi është veçanërisht efektiv. Për fëmijët më të vegjël, të cilët realizojnë zhgarravina, tregimi i historisë ose domethënies së këtyre zhgarravinave nga vetë fëmija, është mjaft efektiv.

## ***Interferencat traumatike në zhvillimin psikologjik të fëmijëve***

1. *Interferenca në procesin e të mësuarit*. Kjo gjë evidentohet me rezultatet e ulëta në mësime, si rezultat i mungesës së ndihmës dhe prezencës prindërore (vdekur, burgosur) ose si pasojë e çrregullimeve emocionale, që vazhdimisht i vuajnë këta fëmijë.

2. *Interferenca në fushën konjitive(mendore).* Zhvillimi konjitiv duket i vonuar, sidomos në aspektin e konjicionit social. Ata konstatojnë tek vetja pazotësi, paaftësi, mungesë motivimi për ndërveprimet shoqërore apo në njohjen e shkaqeve frenuese midis vetes dhe të tjerëve, p.sh., kanë dëshirë të rrinë me dikë, por pa folur; kanë dëshirë të flasin vetëm kur diskutohen problemet e tyre; në rast se i propozohet të shoqërohen me persona të seksit të kundërt, këtë gjë ata e konsiderojnë të vështirë.
3. *Interferenca që ka lidhje me identitetin personal.* Kjo interferencë e fut në komplikacione identitetin e fëmijës. Ata ushqejnë idenë se çdo gjë, përfshirë këtu edhe personaliteti i tyre, ka ndryshuar tërësisht. Ata zotërohen nga mendimet negative dhe duke patur vështirësitë përjetojnë ndjenjat pozitive dhe krijojnë bindje se janë ndryshe nga të tjerët në shoqëri.

Përballimi i traumave të ndryshme kolektive, është i lidhur ngushtë me informimin dhe me trajnimet e nevojshme mbi to, të organizuara nga ekipi i shërbimit psiko-social në shkollë, i cili mund të planifikojë dhe realizojë sesione informuese për këto ngjarje me nxënësit apo edhe me stafin edukativ.

Ndërkohë, nëse trauma ka ndodhur, ekipi i shërbimit psiko-social në shkollë, merr rol aktiv në të gjithë situatën dhe kontekstin, në identifikimin e rasteve të nxënësve apo të stafit edukativ, për të realizuar vlerësimin apo referimet e nevojshme për çdo rast, që kanë nevojë për ndjekje të mëtejshme profesionale e klinike.

**Ndërhyrja në kontekstin shkollor**

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërmerr këta hapa:

**<u>Parandalon</u>**

Punonjësi i SHPSSH-ës parandalon, duke:

- Realizuar seminare informuese/ndërgjegjësuese me nxënës, me prindër, me mësues,për problematikat e shëndetit mendor, duke trajtuar edhe traumën me elemente specifike të saj, rëndësinë e kërkimit të ndihmës dhe teknikat e ndryshme të përballimit.
- Trajnuar stafin pedagogjik, me qëllim identifikimin e rasteve potenciale me elemente të traumës.

- Zhvilluar pyetesorë dhe anketime me nxënës të grupmoshave të ndryshme, për identifikimin e rasteve me problematika të shëndetit mendor dhe hulumton më shumë në varësi të rezultateve.
- Krijuar grupe mbështetëse (p.sh., me senatorët e klasave ose me nxënës me aftësi të mira sociale), me qëllim identifikimin dhe referimin e rasteve pranë SHPSSH-së dhe mësuesve.

*Problematikat e lidhura me  traumën mund të identifikohen/referohen nga:*

- Mësuesi
- Bashkëmoshatarët
- Punonjësi i SHPSSH-ës
- Oficeri i sigurisë
- Prindi
- Çdo aktor tjetër (individë të komunitetit pranë shkollës).

**Vlerëson**

Punonjësi i SHPSH-ës merr kohën e nevojshme për të vlerësuar situatën, duke:

- Vëzhguar fëmijën duke iu referuar listës së kontrollit përkatëse.
- Interviston nxënësin në bazë të moshës.
- Konsultuar/takuar prindërit, për informimin e gjendjes dhe për ecurinë e fëmijës në familje.
- Takuar mësuesin kujdestar dhe lëndor për qëndrimin dhe gjendjen e fëmijës në klasë.
- Hapur dosje personale për nxënësin.

**Ndërhyn**

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërhyn në dy mënyra:

A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë.
B. Ndërhyrje e tërthortë.

**A.Ndërhyrje e drejtpërdrejtë**

Ndërhyrje në nivel individual:

- Këshillim/konsultim dhe mbështetje për nxënësit që shfaqin simptoma të traumës.
- Referim në bazë të specifikës së rastit.
- Intervista me nxënësit në bazë të moshës ku i bëhen pyetje rreth shpeshtësisë, intensitetit, kohëzgjatjes dhe historisë së tij të ankthit, frikës dhe shmangies që lidhen me ngjarjen traumatike.
- Nxënësi inkurajohet të tregojë të gjithë historinë e ngjarjes traumatike nëse ai dëshiron, për të ndihmuar nxënësin të tregojë kujtimet dhe përjetimet që i ka shkaktuar ngjarja traumatike.
- Referimi i nxënësit për egzminimin mjekësor për ta ndihmuar të stabilizojë gjendjen emocionale.
- Psikoedukim në lidhje me ankthin që shkakton një traumë dhe simptomat e tij si mendimet intruzive, frika, ankthi dhe emocionet e tjera negative që vijnë si pasojë e traumës.
- Nxënësi mësohet të identifikojë, të emërtojë dhe të menaxhojë emocionet. Nxënësit i mësohen teknika të rregullimit emocional që përfshijnë etiketimin e emocioneve, aftësitë për të qetësuar veten dhe aftësitë përballuese.
- Nxënësit mësohet të zhvillojë aftësi ndërpersonale si komunikimi bindës, zgjidhja e problemeve dhe zgjidhja e konflikeve.
- Nxënësit i mësohen teknika relaksimi (p.sh., relaksimi progresiv i muskujve, ushtrimet e frymëmarrjes dhe imagjata vizuale e drejtuar)
- Nxënësit i mësohet roli i mendimeve negative dhe që shkaktojnë ankth. Nxënësi mban shënim mendimet negative që e shqetësojnë.
- Nxënësit i mësohet të zëvendësojë mendimet negative me pohime realiste që bazohen në prova dhe fakte.
- Nxënësi mësohet të thotë “STOP” sapo vë re mendime negative apo mendime intruzive të padëshiruara. Nxënësi udhëzohet të imagjinojë një shenjë ndaluese sapo vë re mendime negative apo që lidhen me traumën.
- Familjarët mësohen si ta mbështesin nxënësin ndërkohë që ai/ajo përballon frikërat dhe ankthin.
- Nxënësi inkurajohet të ketë një regjim të rregullt me ushtrime fizike.
- Nxënësit i ofrohen materiale dhe i kërkohet të bëjë një vizatim që relekton ndjenjat dhe emocionet që lidhen me traumën. Vizatimi mund të reflektojë ndjenjat e frikës, ankthit, mungesës së shpresës dhe zemërimin që ka provuar gjatë incidentit traumatik

- Nxënësi inkurajohet të shpërqëndrohet nga mendimet që i krijojnë ankth duke marrë pjesë në më shumë aktivitete.
- Nxënësit i mësohet të ridrejtojë vëmendjen në aktivitete të tjera kur pushtohet nga ankthi
- Nxënësi ndihmohet të bëjë një listë me aktivitete zbavitëse, sociale dhe produktive ku mund të marrë pjesë (p.sh., klube, hobi, aktivitete kulturore, punë vullnetare, aktivitete sportive, aktivitete sociale, lojëra) që rrisin kënaqësinë dhe vlerësimin për veten.

*Qëllimi kryesor i këshillimit/konsultimit është*:

- Zbutja e përjetimeve emocionale dhe psikologjike gjatë periudhës kalimtare dhe përshtatjes.
- Shkëputje e nxënësit nga faktorët stresues.
- Kultivimi i qëndrimeve pozitive tek nxënësi, në familje dhe në shoqëri.
- Orientimi drejt zgjidhjeve të problemeve.

**B.Ndërhyrje e tërthortë**

*Ndërhyrje në nivel klase*:

- Realizimi i seminareve informuese/ndërgjegjësuese me nxënës, për të kuptuarin e traumës dhe për identifikimin e personave që shfaqin elemente të traumave. Trajtimi i teknikave të menaxhimit të ankthit.
- Ushtrime relaksimi dhe ushtrime të tjera psiko-sociale që synojnë reduktimin e ankthit.
- Forcimi i kapaciteteve dhe i aftësive përballuese të nxënësve.
- Aktivitete socio-emocionale që nxisin shprehjen e emocioneve dhe përballimin e ngjarjes traumatike.

*Ndërhyrje në nivel shkolle:*

- Zbatimi i planit të veprimit përkatës në shkollë (p.sh., plani emergjencave).
- Zbatimi i programeve me qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve dhe të mësuesve në lidhje me shëndetin mendor.

**Referimi**

Për rastet kur punonjësi i shërbimit psiko-social has vështirësi dhe nuk ka rezultate në fuqizimin e fëmijëve në mjediset shkollore, i referon ato në institucione të tjera përkatëse, jashtë ambienteve të shkollës, duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

# Planifikimi i ndërhyrjes për çrregullimet specifike të të nxënit në fëmijëri dhe në adoleshencë

Çrregullimet në të nxënë janë çrregullime neurozhvillimore, që ndikojnë në aftësinë për të kuptuar ose për të përdorur gjuhën e folur ose të shkruar, për të bërë llogaritje matematikore, për të organizuar kohën dhe vëmendjen, si dhe për të koordinuar lëvizjet. Edhe pse paaftësitë në të mësuar ndodhin te fëmijët shumë të vegjël, çrregullimet zakonisht nuk njihen, derisa fëmija të arrijë moshën shkollore. Çrregullimet specifike të të nxënit, ndërhyjnë në aktivitetet e fëmijës, duke ulur arritjet dhe duke vështirësuar performancën në shkollë. Një pjesë e fëmijëve me çrregullime në të nxënë, mund të jenë shumë të talentuar në një nga fushat, si: arti, muzika, sporti, orientimi në hapësirë, kompozimi e megjithatë, vuajnë vështirësi të mëdha në veprimtari, si: leximi, shkrimi dhe matematika.

Format e çrregullimeve në të nxënë

**Çrregullimet e aftësisë së të lexuarit (disleksi)**

Disleksia është një vështirësi në të nxënë e cila përfshin aftësinë e të lexuarit saktë dhe rrjedhshëm dhe drejtshkrimin. Tiparet karakteristike të disleksisë janë vështirësitë me ndërgjegjësimin  fonologjik, kujtesën  verbale dhe shpejtësinë përpunuese verbale. Vështirësitë mund të shihen në aspektet e gjuhës, bashkërendimit motorik, përqëndrimit dhe organizimit personal. Fëmijët hasin vështirësi në lexim, gabojnë në njohjen e shkronjave, ngatërrojnë shkronja të ngjashme, ngatërrohen në rreshta dhe rifillojnë disa herë të lexuarit nga e para, fërkojnë shpesh sytë. Fëmijët gjithashtu, ankohen se nuk kuptojnë atë që lexojnë,se kanë dhimbje koke të vazhdueshme. Tiparet karakteristike të disleksisë janë vështirësitë me ndërgjegjësimin  fonologjik, kujtesën  verbale dhe shpejtësinë  përpunuese verbale. Vështirësitë mund të shihen në aspektet e

gjuhës, bashkërendimit motorik, përqëndrimit dhe organizimit personal. Gjithashtu, ankohen se nuk kuptojnë atë që lexojnë, ankohen se kanë dhimbje koke të vazhdueshme edhe pa një shkak fizik. Kur lexojnë, ata i mbajnë librat shumë afër fytyrës ose mund të largojnë apo afrojnë shpesh kokën nga libri dhe duket se kanë një lloj parehatie në shikim, intonacionin e përdorur dhe të kuptuarit e pjesës që lexojnë.

**Çrregullimet e aftësisë matematikore (diskalkuli)**

Fëmijët hasin vështirësi, për të njohur numrat, për t'i kthyer numrat mbrapsht 24-42, për të njohur shenjat, si: +, -, x, :, >, <, për të kryer veprimet bazë matematikore, për të ruajtur radhën e numrave, kur i kopjojnë nga tabela. Diskalkulia përmbledh vështirësitë në përvetësimin e koncepteve të caktuara të matematikës apo në të gjitha fushat e saj. Fëmija mund të përparojë me ritme shumë të ngadalta krahasuar me bashkëmoshatarët. Ata hasin vështirësi, për të njohur numrat, shkrimin e tyre në drejtim të saktë si dhe me numërimin nga një pikë e caktuar. Shprehin konfuzion me drejtimin e numrave ( 24 ose 42) dhe shpesh presim t'i ngatërrojnë ato. Hasin vështirësi në kuptimin e simboleve matematikore. Shpesh janë këta fëmijët të cilëve iu duhet një kohë e gjatë për të përfunduar detyrat që kanë të bëjnë me numrat.

Në përgjithësi këta fëmijë kanë të bashkërenduar vështirësitë e tyre në matematikë me probleme të vlerësimit, me planifikimin e aktiviteteve, nivele të larta të ankthit me efekte të mëdha negative në lidhje me matematikën si dhe koncept i dobët i kohës.

**Çrregullimet e aftësisë së të shkruarit (disgrafi)**

Fëmijët hasin vështirësi për të ruajtur shkrimin, për t'i përfunduar detyrat në kohë, për të ruajtur hapësirën ndërmjet rreshtave dhe midis shkronjave, si dhe kanë vështirësi të kopjojnë pa gabime. Fëmijët hasin vështirësi të theksuara në përvetësimin e shkathtësive të të shkruarit. Kjo vështirësi shfaqet/identifikohet kur fëmijët hasin probleme për të ruajtur drejtimin e shkrimit, hapësirën ndërmjet rreshtave dhe midis shkronjave, gabime të cilat edhe pas ndërhyrjeve, nuk përmirësohen. Gjithashtu vihet re vështirësi në zbërthimin e fjalës në rrokje, fjalisë në fjalë dhe tekstit në fjali. Shkrimi i tyre është i palexueshëm, shpesh shkronjat nuk janë në madhësi të njëjtë në fjalë, dhe vihet re zëvendësimi i shkronjave të

ngjashme. Këta fëmijë kanë vështirësi të kopjojnë pa gabime, tregojnë shpejt lodhje gjatë shkrimit dhe vështirësi të fokusohen në shkrim, mund të frustrohen dhe të heqin dore nga detyrat me shkrim.

**Çrregullimet e inhibimit**

Çrregullimet e inhibimit paraqiten si pamundësi për t'u përqendruar, si pamundësi e kontrollit mbi funksionet ekzekutive, si dhe shfaqen me impulsivitet dhe me hiperaktivitet të shtuar.

Karakteristikat e përgjithshme të fëmijëve me çrregullime të inhibimit përfshijnë:

- Mungesën e shprehive të organizimit dhe të planifikimit në kohë;
- Mungesën e vëmendjes;
- Pamundësinë për të qëndruar në një detyrë.

Çrregullimi i mungesës së vëmendjes (ADD) - karakterizohet kryesisht, nga mosvëmendja dhe shpërqendrimi, pa hiperaktivitet.

Çrregullimi i hiperaktivitetit (HD) - karakterizohet nga sjellje impulsive dhe hiperaktive,mungesëvëmendje dhe përqendrimi.

Çrregullimi i mungesës së vëmendjes i kombinuar me hiperaktivitet (ADHD) - lloji më i zakonshëm i ADHD-së, karakterizohet nga sjellje impulsive dhe hiperaktive, si dhe nga mosvëmendja dhe shpërqendrimi.

**Çrregullimet motore të zhvillimit (dispraksia/apraksia)**

Çrregullimet motore prekin koordinimin e aftësive motore, si te fëmijët dhe te të rriturit. Nënkupton paaftësinë për të ekzekutuar lëvizje të thjeshta e komplekse, të cilat janë të nevojshme në veprimtaritë e përditshmërisë dhe të lëvizjeve, për të funksionuar normalisht në familje, në grup, në shkollë dhe në komunitet. Çrregullimet motore të zhvillimit përfshijnë:

- Paaftësinë për të planifikuar dhe për të ekzekutuar lëvizje të koordinuara.
- Stereotipitë (paaftësinë për të evituar lëvizje të përsëritura, të paqëllimta, që pengojnë zhvillimin social, akademik dhe kryerjen e aktiviteteve të jetës së përditshme).

- Tiket (kompulsione lëvizore dhe verbale).

### Çrregullimet e komunikimit

Fëmijët me çrregullime të komunikimit, kanë të dëmtuara njëherazi, zhvillimin gjuhësor, konjitiv dhe atë social. Ata e kanë të vështirë përdorimin e gjuhës, për shkak të mungesës së të kuptuarit ose të gjuhës së folur. Këto mangësi mund të ekzistojnë në komunikimin e folur dhe të shkruar dhe madje, edhe në gjuhën e shenjave. Ndonjëherë, mund të jetë e ndërlikuar të përcaktohet çrregullimi gjuhësor, veçanërisht gjatë fëmijërisë. Është e rëndësishme të vlerësohen dy lloje të ndryshme të aftësive të të mësuarit të gjuhës: aftësitë shprehëse dhe të kuptuarit (gjuha receptive). Aftësia shprehëse ka të bëjë me prodhimin e sinjaleve vokale ose verbale, ndërsa të kuptuarit i referohet marrjes dhe të kuptuarit të mesazheve. Çrregullimet e komunikimit përfshijnë:

- Çrregullimet gjuhësore (dëmtime të gjuhës receptive dhe/apo shprehëse).
- Çrregullimet e të folurit (apraksia, disartria).
- Çrregullimet e komunikimit social (mungesa e pragmatizmit të gjuhës).
- Mungesën e rrjedhshmërisë së të folurit (disfluenca, mbajtja e gojës).

Kur fëmija has vështirësi në të paktën një nga pikat e mëposhtme për të paktën gjashtë muaj pavarësisht ndihmës së synuar paraqitet nevoja që fëmija të referohet për një vlerësim më të detajuar

- Vështirësi në lexim (është i pasaktë, i ngadalshëm edhe pas shumë përpjekjeve).
- Vështirësi për të kuptuar kuptimin e asaj që lexohet.
- Shfaq një nivel të ulët të aftësive intelektuale.
- Shfaq nivel të ulët të aftësive të ndërveprimit social.

### Ndërhyrja në kontekstin shkollor për vështirësinë në të nxënë

Punonjësi i shërbimit psiko- social vlerëson faktorët konjitivë, emocionalë dhe socialë te nxënësi të cilat ndikojnë drejtpërdretë të procesi i të nxënit. Fokusi i ndërhyrjes te kjo kategori është në ndihmën që i jepet nxënësit për të zhvilluar strategji të suksesshme të të nxënit, bashkëshoqëruar me zhvillimin e teknikave efektive te nxënësi për të përballuar stresin dhe ngarkesat në lidhje me të nxënit, si

prsh menaxhimi i kohës, mënyra e mbajtjes së shënimeve, krijimi i një mjedisi të përshtatshëm në shtëpi, krijimi i një rutinë të shëndetshme ditore etj.

Punonjësi i shërbimit psiko-social realizon vlerësimin holistik të fëmijës me vështirësi akademike, duke mbajtur në konsideratë faktorët e jashtëm të cilët ndikojnë te të mësuarit si psh problemet familjare (kalimtare ose të vazhdueshme), problemet shëndetësore si dhe sociale. Në këtë drejtim puna e punonjësit të shërbimit psiko-social do të shkojë drejt sigurimit të mundësive që fëmija të zhvillohet në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Qëllimi i ndërhyrjes te nxënësi i cili paraqet vështirësi akademike është identifikimi dhe zhvillimi i potencialit të plotë të fëmijës për t'u përfshirë në mësim me vetbesim dhe në mënyrë aktive, gjithashtu bashkëpunimi me mësuesit dhe prindërit për të kuptuar dhe fuqizuar mundësitë sociale të nxënësit me qëllim lehtësimin e procesit të të nxënit, kur vështirësia në të nxënë është pasojë e faktorëve socialë.

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërmerr këta hapa:

**Parandalon**

Punonjësi i SHPSSH-së parandalon, duke:

- Realizuar seminare, fletëpalosje informuese/ndërgjegjësuese me nxënës, me prindër, me mësues për vështirësitë në të nxënë.
- Zhvilluar sesione informuese të stafit pedagogjik, me qëllim identifikimin e rasteve me vështirësi në të nxënë, duke u mbështetur dhe në plotësimin e listave të kontrollit.
- Zhvilluar pyetësorë dhe anketime me mësues dhe me prindër, me qëllim identifikimin e hershëm të vështirësive në të nxënë.

**Problematikat lidhur me vështirësitë në të nxënë, mund të identifikohen/referohen nga:**

- Mësuesi
- Bashkëmoshatarët
- Punonjësi i SHPSSH-ës
- Prindi
- Çdo aktor tjetër (individë të komunitetit pranë shkollës).

**<u>Vlerëson</u>**

Punonjësi i SHPSH merr kohën e nevojshme për të vlerësuar situatën, duke:

- **Mbledhur të dhënat nga:**
    - Intervistat me prindërit.
    - Intervistat me mësuesin.
    - Vëzhgime 2-4 orë, gjatë një periudhe dyjavore.
    - Plotësimi i listave të kontrollit
    - Hapur dosje personale për nxënësin.

Raporti i matjeve dhe i analizës së bërë, ndahet me mësuesit dhe me prindërit duke ndarë vetëm ato informacione që janë të domosdoshme dhe që ndikojnë drejtpërdrejt në ecurinë e fëmijës dhe punën që zhvillon me nxënësin mësuesi apo prindi.

**<u>Ndërhyn</u>**

Punonjësi i shërbimit psiko-social mbledh, analizon të dhënat, vlerëson gjendjen e nxënësit për të cilin ka marrë referim nga mësuesi, prindi ose e ka identifikuar vetë dhe referon fëmijën për shërbim të specialisti kur vlerëson se kjo është e nevojshme. Për rastet kur specialisti ka vlerësuar dhe ka dhënë diagnozë të një prej çrregullimeve të të nxënit, rasti do të trajtohet si nxënës më AK. Në rast kur nxënësi nuk ka raport dhe nuk plotëson kriteret për diagnostikim dhe janë evidentuar karakteristikat e vështirësive në të nxënë, mësuesi kujdestar dhe lëndor harton plan për përmirësimin e vështirësive në të nxënë. Ky plan i hartuar për nxënsin me vështirësi në të nxënë mbështetet nga SHPS me plan ndërhyrje. Njëkohësisht, punonjësi social i shkollës bashkëpunon me institucionet përkatëse, për interes më të lartë të fëmijës dhe planifikikon aktivitete në nivel klase ose individual për të mbështetur fëmijën.

**Punonjësi SHPSSH-së ndërhyn në dy mënyra:**

A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë.

B. Ndërhyrje e tërthortë.

## A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë

Ndërhyrje në nivel individual

- Hartimi i planit të ndërhyrjes për nxënësit me vështirësi në të nxënë si më poshtë.
- Orientimi i mësuesit mbi hartimin e  planit didaktik (në rastet kur fëmija nuk ka marrë një raport nga mjeku pasi nuk plotësn kriteret e diagnostikimit dhe kur fëmija paraqet vështirësi në fushat më sipër).
- Këshillime/konsultime individuale me nxënësit.
- Nxitja për të qenë më të organizuar në aktivitetet ditore.
- Rritja e vetëvlerësimit dhe të aftësive sociale.
- Identifikimi i stilit të të nxënit - çfarë stili i të nxënit është më efektiv dhe produktiv për nxënësin (vizual, auditiv, nëpërmjet leximit dhe shkrimit, kinestetik).
- Prindërit dhe mësuesit rekomandohen që nxënësi të caktohet të punojë më një nxënës tjetër që të përmirësojë aftësitë e tij në studim.
- Mësuesit dhe prindërit nxiten të mbajnë një komunikim të rregullt me njëri - tjetrin përmes telefonatave ose shënimeve me shkrim në lidhje me ecurinë e nxënësit.
- Prindërit nxiten ta lavdërojnë shpesh dhe ti japin shpërblime kur ka arritje shkollore ose sjellje pozitive.
- Prindërit mund të identifikojnë një listë me shpërblime për të përforcuar arritjet akademike të nxënësit.
- Prindërit nxiten të mos bëjnë presion tek nxënësi për të plotësuar detyra që ai nuk i arrin dot.
- Mësuesit dhe prindërit inkurajohen të japin lavdërime të shpeshta për ta ndihmuar nxënësin të ketë interes dhe të jetë i motivuar
- Nxënësit i mësohen teknika si relaksimi progresiv i muskujve dhe imagjinata e drejtuar për ta ndihmuar të menaxhojë ankthin kur ka detyra të vështira në shkollë.
- Prindërit inkurajohen të vendosin kufij të qartë dhe të prerë nëse nxënësi nuk pranon të bëjë detyrat apo punë të tjera që i caktohen.
- Takim me familjen për të kuptuar dinamikat familjare që mund të ndikojnë në ecurinë e nxënësit në shkollë.

- Nxënësit i mësohen aftësi të mira komunikimi për të shprehur mendimet ndjenjat dhe ndjenjat në mënyrë më të qartë. Psh. Nxënësi mëson të mbajë kontakt me sy, rëndësinë e dëgjimit aktiv, “mesazhet me unë” etj.
- Nxënësi nxitet të hartojë një listë me aktivitete zbavitëse dhe sociale që e ndihmojnë të jetë më i motivuar për të përmirësuar arritjet në shkollë.
- Monitorimi periodik i ecurisë së rastit.

**<u>Ndërhyrje në nivel individual për ADHD</u>**

1. Administroni lista kontrolli për të vlerësuar ADHD-në.
2. Referojeni nxënësin tek një specialist për të vlerësuar praninë e çrregullimeve në të nxënë dhe të ADHD-së.
3. Mësojeni nxënësin dhe familjen e tij/saj rreth simptomave të ADHD-së dhe si ndikon tek organizimi, aftësitë e dobëta planifikuese, impulsiviteti, zvarritja e punëve dhe shpërqendrimi.
4. Tregoni se si trajtimi i ADHD-së ndikon në përmirësimin e aftësive planifikuese dhe të organizimit, përmirëson përqendrimin dhe eliminon zvarritjen e punëve.
5. Caktojini nxënësit dhe prindit materiale për të lexuar rreth ADHD-së dhe trajtimit të tij.
6. Mësojini nxënësit aftësi organizuese dhe planifikuese duke përdorur lista ditore detyrash dhe kalendarë.
7. Mësojini aftësi të efektshme problem-zgjidhëse (psh., identifiko problemin, mendo për zgjidhje të ndryshme, zgjidh një opsion, përcakto një mënyrë veprimi dhe vlerëso rezultatin).
8. Mësojini nxënësit teknika vetë kontrolli si psh “Ndalo, shiko, dëgjo dhe mendo” për të vonuar nevojën për plotësimin e menjëhershëm të dëshirave dhe për të arritur qëllime më të afatgjata dhe domethënëse.
9. Përdorni udhëzimet, modelimin dhe luajtjen e roleve për të ndërtuar aftësitë sociale dhe komunikuese.
10. Bashkëpunoni me mësuesit për të përmirësuar arritjet në shkollë. Nxënësi ulet afër mësuesit ose në një vend ku nuk ka shumë shpërqendrime që të arrijë të plotësojë detyrat. Programi i nxënësit modifikohet që të ketë më shumë pushime mes detyrave ose detyrave të vështira në mënyrë që nxënësi të qëndrojë i përqëndruar.

11. Mësuesit inkurajohen të komunikojnë shpesh me të në mënyrë që të qëndrojë i përqendruar, të ketë interes dhe të jetë i motivuar.
12. Mësojini nxënësit teknika relaksimi (p.sh., relaksimi progresiv i muskujve, ushtrimet e frymëmarrjes dhe imagjata vizuale e drejtuar) dhe caktojini t'i bëjë ushtrimet çdo ditë.
13. Hartoni një sistem shpërblimesh që mund të përforcojë plotësimin e detyrave të shtëpisë ose detyrave të tjera
14. Caktojini nxënësit një regjim ushtrimesh fizike të cilat ai/ajo duhet t'i praktikojë rregullisht.
15. Mësojini aftësi komunikimi dhe bindëse në mënyrë që të shprehë ndjenjat dhe mendimet në mënyrë të kontrolluar.
16. Mësojini nxënësit të përdorë "Mesazhet me unë" dhe pohimet pozitive për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e veta.
17. Jepini nxënësit detyra/ushtrime ku ai/ajo realizon tre veprime altruiste për të rritur ndjeshmërinë dhe empatinë ndaj nevojave, ndjenjave dhe mendimeve të të tjerëve.
18. Nxënësi plotëson një listë me pasojat negative që kanë tek ai dhe të tjerët veprimet e tij impulsive dhe vendimet e gabuara.
19. Nxënësi ndihmohet të identifikojë mënyra të tjera për të zgjidhur konfliktet dhe plotësuar nevojat e veta në vend se të tregohet impulsiv.
20. Nxënësi inkurajohet të marrë pjesë në aktivitete ekstra kurrikulare dhe aktivitete në grup për të përmirësuar aftëstë sociale, përmirësuar vetë-vlerësimin dhe shprehur ndjenjat në mënyrë të shëndetshme.

**B. Ndërhyrje e tërthortë (nivel klase)**

*Metodat e mësimdhënies (nga mësuesi) të përshtaten duke zbatuar hapat e mëposhtëm, për t'i ardhur në ndihmë fëmijës:*

1. Marrëdhënia mësues-nxënës - ndërtimi, përmirësimi i marrëdhënieve pozitive dhe të afërta mësues-nxënës.
2. Peer-tutoring (bashkëshoqërimi)-ulja në bankë me nxënës që janë ndihmues dhe mbështetës.
3. Fokus grupe me synim identifikimin e vështirësive dhe të aftësive.

4. Paraqitja vizuale - krijimi dhe paraqitja vizuale e proceseve të të nxënit (projektor, vizatime, paraqitja në kartona, vendosja e materialeve vizuale në ambientet e klasës).
5. Metoda bashkëkohore të mësimdhënies- duke përfshirë aktivitete argëtimi gjatë procesit të të nxënit, si: ngjyrosje, vizatim, shoqërimi i mësimit me lëvizje ose me muzikë.
6. Ndarja e detyrave në pjesë të vogla.
7. Identifikimi i fushës/ave së/të interesit dhe angazhimi i fëmijës më tepër në këtë aspekt (me ndihmën e punonjësit të shërbimit psikosocial).
8. Përforcimi i arritjeve dhe i shpërblimeve verbale të shpeshta, për të rritur motivimin e fëmijës.
9. Organizimi i orëve mësimore, duke i paraqitur vizualisht ose sipas nevojës së nxënësit.

C. **<u>Ndërhyrje e tërthortë (nivel shkolle)</u>**

- Aktivitete psiko-edukuese me mësues e prindër për rritjen e njohurive dhe të informacionit, në lidhje me vështirësitë/çrregullimet në të nxënë.

# Referimi

Punonjësi i shërbimit psiko-social referon tek mjeku i familjes për një vlerësim dhe trajtim më të specializuar të rastit.

**Modeli 24. Plani i ndërhyrjes për nxënësit me vështirësi në të nxënë**

| **Emër mbiemër i nxënësit** | |
|---|---|
| **Datëlindja, mosha** | |
| **Klasa** | |
| **Viti shkollor** | |
| **Vlerësimi** | |

**Nevojat që paraqet nxënësi:**

Emocionale -psikologjike

_______________________________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________________________

Sociale (marrëdhëniet ndërpersonale, mësuesit dhe prindërit, dinamikat familjare, faktorë të tjerë social)

_______________________________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________________________

Akademike

_______________________________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________________________

Angazhimi i nxënësit në jetën shkollore

_______________________________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________________________

Ndërhyrja bazuar në nevojat e identifikuara

Monitorimi

Periudha 1

Periudha 2

Periudha

# Çrregullimet e sjelljes dhe të kontrollit të impulsit

Fëmijët dhe adoleshentët mund të shfaqin shqetësime apo probleme emocionale që ndikojnë në menaxhimin e sjelljeve. Ato mund të shfaqin vështirësi në kontollimin apo menaxhimin e sjelljeve impulsive, agresive si dhe hasin vështirësi dhe në marrëdhëniet sociale.

Ka shumë lloje të problematikave sjellore, por më të zakonshmet që prekin fëmijët dhe adoleshentët, sot, janë llojet e mëposhtme.

**Çrregullimi i sjelljes** është një model i vazhdueshëm dhe i përsëritur sjelljeje, në të cilin, as të drejtat bazë të të tjerëve apo normat sociale dhe rregullat, nuk respektohen, por përkundrazi, dhunohen. Çrregullimi i sjelljes është një çrregullim që shfaqet me sjellje që cenojnë të drejtat dhe rregullat shoqërore. Egocentrizmi vlerësohet dhe dallohet, si tipari më i theksuar i këtij çrregullimi dhe kryesisht shfaqet me:

- paaftësi për t'u shqetësuar për ndjenjat e të tjerëve,
- manipulim të të tjerëve, për të përfituar pa asnjë përpjekje për të bashkëpunuar apo për të bërë konsensus,
- mungesë të ndjenjave të përshtatshme, të tilla si ndjenjat e fajit apo të pendesës.

**Çrregullimi sfidues kundërshtues** është një çrregullim i shëndetit mendor, i karakterizuar nga një model i vazhdueshëm sjelljeje të pabindur, armiqësore dhe sfiduese ndaj figurave të autoritetit, që tejkalon kufijtë e sjelljes normale të fëmijërisë.

Kur një fëmijë nuk duket se mund të kontrollojë zemërimin ose zhgënjimin e tij, madje as atë që duket e parëndësishme ose e thjeshtë për të tjerët, nxënësi shpesh do të reagojë me dhunë ose me mënyra negative.

Është e natyrshme që herë pas here, fëmijët të kundërshtojnë dhe të shfaqin zemërim. Kur kjo sjellje ndeshet shpesh dhe është e vazhdueshme, atëherë është një shenjë identifikuese për çrregullim sfidues kundërshtues.

Çrregullimi sfidues kundërshtues fillon në fëmijëri, me sjellje si sfidë e shpeshtë e autoritetit, me grindjet e tepruara, me refuzimin për t'u pajtuar dhe me përfshirje të qëllimshme, në sjellje që shqetësojnë të tjerët.

Nëse nuk diagnostikohet dhe trajtohet në kohë, ky çrregullim mund të paraqitet në jetën e mëvonshme, si ndjenjë e zemërimit me botën, ndjenjë keqkuptimi, mospëlqim të figurave të autoritetit, veçanërisht në punë, duke u bërë mbrojtëse, kur paraqitet, me kundërshtime ose me reagime, dhe duke fajësuar të tjerët për veprimet.

Kur një fëmijë fillon shkollën, ndonjëherë, ai shfaq model sjellor pasiv-agresiv, që provokon fëmijët e tjerë dhe stafin. Nxënësi reagon me zemërim, me kriticizëm dhe ka reagime ndëshkuese. Nxënësi fajëson ose argumenton duke kundërshtuar dhe nervozohet lehtë.

Këta fëmijë nuk pranojnë bindjen e arsyeshme dhe këmbëngulin në faktin, se vështirësitë e tyre lidhen me kërkesat e paarsyeshme të të tjerëve. Këta fëmijë nuk perceptojnë ndonjë problem në sjelljen e tyre dhe as stresohen prej saj.

Këtyre fëmijëve zakonisht u prishet humori shumë lehtë dhe krijojnë qejfmbetje.

Disa nga sjelljet që shfaq fëmija janë:

- Mund të konfliktohet shpesh apo të përfshihet në konflikte me të rriturit;
- Refuzon kërkesat e të rriturve;
- Bën me qëllim sjellje të caktuara, ndërkohë që e di se këto veprime do të bezdisin të tjerët;
- Fajëson të tjerët për gabimet e veta;
- Bezdiset shumë lehtë nga të tjerët;
- Zemërohet shpejt dhe nuk ndien keqardhje;
- Është inatçi dhe hakmarrës;
- Përdor gjuhë të pahijshme dhe banale;

Moskomplianca është tipari kryesor i këtij çrregullimi dhe mund të manifestohet, përmes veprimeve të drejtpërdrejta të mosbindjes, të negativizmit dhe të kundërshtimit.

Nxënësi thyen rregullat e vendosura nga të rriturit, tregon kokëfortësi dhe sjellje provokuese e kundërshtuese.

Nëse nxënësi frustrohet, ai mund të shpërthejë edhe në kriza emocionale. Nëse disa nga këto sjellje vihen re te fëmija për një periudhë të vazhduar, edhe pas ndërhyrjeve të realizuara në shkollë, punonjësi i shërbimit psiko-social e referon rastin për shërbime të specializuara.

### Ndërhyrja në kontekstin shkollor

Punonjësi i SHPSSH-së ndërmerr këto hapa, në informimin dhe në ndërgjegjësimin e stafit pedagogjik, të prindërve, të komunitetit, rreth identifikimit dhe menaxhimit të nxënësve të cilët shfaqin shenja dalluese të problematikave në sjellje:

**Parandalon**

Punonjësi i SHPSSH-ës parandalon,duke:

- Realizuar seminare dhe duke informuar nëpërmjet fletëpalosjeve informuese/ndërgjegjësuese me nxënësit, prindërit, mësuesit, për teknika të menaxhimit efektiv të sjelljes.
- Krijuar grupe mbështetëse (p.sh., me senatorët e klasave ose me nxënës me aftësi të mira sociale), me qëllim identifikimin, menaxhimin dhe referimin e rasteve pranë SHPSSH-së.
- Realizuar aktivitete socio-emocionale.

**Problematikat lidhur me çrregullimet e sjelljes, mund të identifikohen/referohen nga:**

- Prindi/Stafi drejtues
- Mësuesi
- Bashkëmoshatarët
- Punonjësi i shërbimit psiko-social shkollor
- Oficeri i sigurisë
- Çdo aktor tjetër (individë të komunitetit pranë shkollës).

**Vlerëson**

Punonjësi i SHPSSH-së merr kohën e nevojshme për të vlerësuar situatën. Fokusi i vlerësimit të situatës është:

- Niveli i riskut të fëmijës, për përfshirje në sjellje të rrezikshme.
- Ndikimi i problematikës së shfaqur në mirëfunksionimin e fëmijës, në jetën e përditshme.

- Sistemi mbështetës i fëmijës në familje dhe në shkollë.
- Niveli i informacionit të prindit/kujdestarit ligjor mbi problematikat e sjelljes.
- Nevoja për referim për shërbime të shëndetit mendor.

**Punonjësi i shërbimit psiko-social:**

- Zhvillon konsulta me mësues/nxënës/prindër;
- Vëzhgon në klasë dhe në ambientet e shkollës;
- Realizon intervista fillestare me nxënës;
- Plotëson listat e kontrollit për problematikat sjellore.

**Ndërhyrja në nivel individual**

1. Administroni lista kontrolli për të vlerësuar sjelljen e nxënësit.
2. Referojeni nxënësin tek një specialist për të vlerësuar praninë e çrregullimeve sjellore.
3. Mësojini aftësi të efektshme problem-zgjidhëse (psh., identifiko problemin, mendo për zgjidhje të ndryshme, zgjidh një opsion, përcakto një mënyrë veprimi dhe vlerëso rezultatin).
4. Mësojini nxënësit teknika vetë kontrolli si psh "Ndalo, shiko, dëgjo dhe mendo" për të vonuar nevojën për plotësimin e menjëhershëm të dëshirave dhe për të arritur qëllime më afatgjata dhe domethënëse.
5. Përdorni udhëzimet, modelimin dhe luajtjen e roleve për të ndërtuar aftësitë sociale dhe komunikuese.
6. Bashkëpunoni me mësuesit për të përmirësuar arritjet në shkollë. Nxënësi ulet afër mësuesit ose në një vend ku nuk ka shumë shpërqëndrime që të arrijë të plotësojë detyrat. Programi i nxënësit modifikohet që të ketë më shumë pushime mes detyrave ose detyrave të vështira në mënyrë që nxënësi të qëndrojë i përqëndruar.
7. Mësuesit inkurajohen të komunikojnë shpesh me nxënësin, në mënyrë që të qëndrojë i përqëndruar, të ketë interes dhe të jetë i motivuar.
8. Hartoni një sistem shpërblimesh që mund të përforcojë plotësimin e detyrave të shtëpisë ose detyrave të tjera.
9. Caktojini nxënësit një regjim ushtrimesh fizike të cilat ai/ajo duhet t'i praktikojë rregullisht.

10. Mësojini aftësi komunikimi dhe bindëse në mënyrë që të shprehë ndjenjat dhe mendimet në mënyrë të kontrolluar.
11. Mësojini nxënësit të përdorë “Mesazhet me unë” dhe pohimet pozivitive për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e veta.
12. Jepini nxënësit detyra/ushtrime ku ai/ajo realizon tre veprime altruiste për të rritur ndjeshmërinë dhe empatinë ndaj nevojave, ndjenjave dhe mendimeve të të tjerëve.
13. Nxënësi plotëson një listë me pasojat negative që kanë tek ai dhe të tjerët veprimet e tij impulsive dhe vendimet e gabuara.
14. Nxënësi ndihmohet të identifikojë mënyra të tjera për të zgjidhur konfliktet dhe plotësuar nevojat e veta në vend se të tregohet impulsiv.
15. Nxënësi inkurajohet të marrë pjesë në aktivitete ekstra kurrikulare dhe aktivitete në grup për të përmirësuar aftësitë sociale dhe shprehur ndjenjat në mënyrë të shëndetshme.

**Punonjësi i SHPSSH-së realizon kontakt me prindin, si më poshtë:**

- Në formën e bashkëpunimit dhe të mbështetjes, punonjësi i shërbimit psiko-social shkollor lehtëson situatën, duke paraqitur te prindi vlerësimin e tij fillestar për gjendjen e nxënësit, shoqëruar me rekomandimet përkatëse.
- Orienton prindin/kujdestarin ligjor për shërbimet që vijnë në ndihmë të përmirësimit të situatës së fëmijës, brenda dhe jashtë shkollës. Gjithashtu, vë në dijeni personin që ushtron përgjegjësinë prindërore, për rëndësinë e bashkëpunimit shkollë-familje, në përmirësimin e situatës së fëmijës.

### Dokumentimi dhe menaxhimi i rastit

Punonjësi i SHPS-së hap dosje të veçantë për fëmijën. Në dosje dokumentohet e gjithë ecuria e rastit, nëse ka progres në minimizimin e simptomave dhe rikuperim. Nëse kemi sukses gjatë përfundimit të hapave të ndërmarrë, vijohet përsëri vëzhgimi dhe kujdesi ndaj rastit, pasi mund të ndodhë që mund të përsëritet situata e përjetimit të problematikave sjellore. Kështu vijohet me mbylljen e rastit.

### Referimi

Referimi te mjeku i familjes është opsion, në bazë të shkallës së shfaqjes së çrregullimit. Pas gjithë fazës së vlerësimit, punonjësi i shërbimit psiko-social referon

rastin për shërbime më të specializuara nëse e gjykon të nevojshme. Njëkohësisht ndërmerr hapa për planifikimin e ndërhyrjes në kontekstin shkollor.

Nëse çrregullimi apo simptomat ndodhin paralelisht apo të ndikuara nga ngjarje, nga situata apo nga problematika të tjera, si dhuna në familje, neglizhenca, abuzim i formave të ndryshme, ngjarje traumatike etj, rasti referohet në PMF/NJMF. Në varësi të situatës dhe të planit të ndërhyrjes së përcaktuar nga GTN-ja, punonjësi i SHPSSH ndjek ecurinë e fëmijës në institucionin arsimor dhe raporton pranë PMF/NJMF.

# Planifikimi i ndërhyrjes për rastet e braktisjes së shkollës

**Nxënës potencial braktisës** - nxënësi i arsimit bazë konsiderohet potencialisht braktisës, nëse është i regjistruar në shkollë, në fillim të vitit shkollor dhe, në fillim të javës së tretë të muajit tetor, raportohet nga shkolla si i paparaqitur.

**Nxënës braktisës** - nxënës i arsimit bazë konsiderohet braktisës:

a. nëse është regjistruar në shkollë, në fillim të vitit shkollor dhe, në përfundim të vitit shkollor, rezulton i paklasifikuar (mbetës për shkak të mungesave).
b. kur nuk ka mungesa me arsye dhe nuk përmbush asnjë prej kushteve përjashtuese: fatkeqësi familjare, sëmundje që zgjat shumë ose që shkakton mungesa të rregullta (dokumentuar me raport mjeko-ligjor), trasferim në një shkollë tjetër brenda vendit (i dokumentuar), emigrim jashtë vendit (i dokumentuar), vdekja.

Ekzistojnë dy lloje braktisjesh:

***Braktisje fizike*** - ku nxënësi nuk frekuenton shkollën fizikisht, shkëputet fizikisht prej saj.

***Braktisje e fshehtë*** - nxënësi frekuenton shkollën fizikisht dhe rregullisht, por nuk është aktiv, nuk ka interes, qëndron i shkëputur mendërisht nga shkolla.

**Profili i fëmijës me tendencë braktisje**

- Fëmijë që punojnë ose që janë të përfshirë në dukuri negative (prindër të alkoolizuar apo të droguar, trafikim, shfrytëzim ekonomik etj.).
- Fëmijë të kthyer nga emigracioni.
- Fëmijë që e kanë vendndodhjen e shtëpisë larg shkollës.
- Fëmijë nga familje me nivel të ulët ekonomik.
- Fëmijët që janë viktima të dhunës dhe të trafikimit, të mbijetuarit e abuzimit seksual, fëmijët e braktisur.
- Fëmijë me problematika të ndryshme individuale (sëmundjet e ndryshme, të përkohshme apo kronike, si aftësitë e kufizuara fizike, mendore etj.).
- Martesat e hershme.
- Nxënës që kanë një numër të lartë mungesash.
- Nxënës që punojnë për arsye ekonomike.
- Nxënës që vijnë nga familje me probleme të theksuara ose që janë të përfshirë në dukuri negative (prindër të alkoolizuar apo te droguar, trafikim, shfrytëzim ekonomik etj.).
- Nxënës që e kanë vendndodhjen e shtëpisë larg shkollës.
- Nxënës që janë viktima të dhunës dhe të trafikimit, të mbijetuarit e abuzimit seksual, fëmijët e braktisur.
- Nxënës me problematika të ndryshme individuale (sëmundjet e ndryshme, të përkohshme apo kronike, si aftësitë e kufizuara fizike, mendore etj.).
- Nxënës me arritje shumë të dobëta në mësime.
- Nxënës të përfshirë në sjellje konfliktuale ose të dhunshme.
- Nxënës që janë përdorues droge ose duhani.
- Nxënës që vijnë nga komuniteti rom dhe egjiptian.
- Nxënës që nuk janë nën kujdestarinë e prindërve.
- Nxënës në përkujdesje institucionale.

Nxënës që jetojnë larg famijePunonjësi i SHPSH-ës, mbështetur në planin vjetor, dhe në planet e veprimit në luftën kundër braktisjes shkollore, ndjek këta hapa:

**Parandalon**

Punonjësi i SHPSSH-ës parandalon, duke:

- Zhvilluar takime ndërgjegjësuese për detyrimet e prindit, për frekuentimin e shkollës nga nxënësi.

- Bashkëpunuar me mësuesit kujdestarë në identifikimin e nxënësve në rrezik braktisje të shkollës.
- Identifikuar nevojat e nxënësve dhe duke planifikuar ndërhyrje specifike për t'i trajtuar këto nevoja.
- U konsultuar në mënyrë të vazhdueshme me prindër, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, për dobitë dhe përfitimet që ka fëmija, nga frekuentimi i rregullt i shkollës, në kontekstin akademik dhe shoqëror.

**Vlerëson**

Punonjësi i SHPSSH-ës vlerëson nevojat parësore të familjes dhe të fëmijës dhe në bazë të nevojave të identifikuara, ndërhyn specifikisht. Identifikimin e nxënësve me risk braktisje dhe përcaktimin e faktorëve dhe nivelit të riskut e vlerëson mësuesi kujdestar. Pas përcaktimit të nivelit të riskut, punonjësi i shërbimit SHPS orienton mësuesin kujdestar për hartimin dhe zbatimin e planit të ndërhyrjes.

**Ndërhyn**

**Punonjësi i SHPSSH-ës ndërhyn në dy mënyra:**

A. Te nxënësit me risk braktisjeje.
B. Te nxënësit në rast braktisjeje.

***Ndërhyrja te nxënësit me risk braktisjeje***

- Këshillon prindërit për efektet negative të braktisjes së shkollës dhe për detyrimin ligjor, që prindërit kanë për arsimimin e fëmijëve (arsimi 9-vjeçar).
- Merr informacion të nevojshëm për gjendjen psiko-sociale të familjes (nevojat ekonomike, ndryshime në strukturën familjare, histori të sëmundjeve etj.).
- Në bashkëpunim me mësuesit kujdestarë dhe të lëndëve të ndryshme, punonjësi i SHPSSH-së ndërhyn, me qëllim rritjen e motivimit në frekuentimin e shkollës së nxënësve dhe të mundësisë së tyre për të përfunduar shkollën.
- Krijon sisteme mbështetëse brenda klasës me grupe të vogla.

- Referon/adreson nevojat e familjes dhe të fëmijës pranë strukturave përkatëse (NJMF/PMF).
- Prindërit dhe mësuesit rekomandohen që nxënësi të caktohet të punojë me një nxënës tjetër që të përmirësojë aftësitë e tij në studim.
- Nxënësit i jepen detyra që lidhen me interesat e tij/saj dhe në përputhje me aftësitë e tij/saj.
- Nxënësit i mësohen teknika si relaksimi progresiv i muskujve dhe imagjinata e drejtuar për ta ndihmuar të menaxhojë ankthin që lidhet me shkollën.
- Nxënësit i mësohen aftësi të mira komunikimi për të shprehur mendimet ndjenjat dhe ndjenjat në mënyrë më të qartë. Psh. nxënësi mëson rëndësinë e dëgjimit aktiv, komunikimin bindës, "mesazhet me unë" etj.
- Prindëri inkurajohen të caktojnë një sistem shpërblimi sistematik për të përforcuar arritjet dhe ecurinë e mirë në shkollë.
- Eksplorohen problemet familjare, traumat, burimet e stresit që mund të ndikojnë tek frekuentimi i shkollës.
- Nxënësi inkurajohet të marrë pjesë në aktivitete ekstra kurrikulare me moshatarët.
- Nxënësi harton një listë me aktivitete në grup që ndihmojnë të ketë shoqëri në shkollë dhe të ndihet i motivuar për të përmirësuar frekuentimin.

***Ndërhyrja te nxënësit braktisës***

- Në rastet kur nxënësi nuk vjen në shkollë për një kohë të gjatë dhe prindërit apo familjarë të tjerë me të cilët jeton nxënësi, shfaqen indiferentë ndaj thirrjes nga mësuesi kujdestar dhe nga punonjësi i SHPSSH-së, rasti referohet pranë PMF/NJMF-së.
- Referimin pranë PMF/NJMF-së, për nxënësin në arsimin e detyruar bëhet kur nxënësi ka risk për të braktisur shkollën ose e ka braktisur atë. Për nxënësit në arsimin e mesëm të lartë, referimi bëhet për të përjashtuar sjelljet e rrezikshme si faktorë për ndërprerjen e shkollës.
- Në rast se nuk gjendet kontakti i prindërve apo familjarë të tjerë me të cilët jeton nxënësi, rasti referohet pranë PMF/NJMF-së.

Pas ndërhyrjes, në rast rikthimi në shkollë, SHPS-ja:

- Mban kontakte të vazhdueshme me NJMF-në.
- Monitoron në mënyrë të vazhdueshme frekuentimin e nxënësit, në bashkëpunim me mësuesin kujdestar.
- Krijon sisteme mbështetëse brenda klasës me grupe të vogla.

Për çdo rast braktisjeje apo risk braktisje, vihet në dijeni drejtori i shkollës.

**Referimi**

Kur rasti nuk zgjidhet nga hapat e ndërmarrë, nga punonjësit e shërbimit psiko-social, lind detyrimi për ta referuar rastin pranë PMF/NJMF-së. Punonjësve të shërbimit psiko-social në punën e tyre, në lidhje me braktisjen e shkollës, u kërkohet bashkëpunimi me PMF-në dhe me aktorë të tjerë, në interesin më të lartë të fëmijës.

# Planifikimi i ndërhyrjes për rastet e varësisë në fëmijëri dhe në adoleshencë

Varësia i referohet një game të gjerë sjelljesh kompulsive. Tradicionalisht, varësia i referohet përdorimit të tepërt të substancave (alkool, lëndë narkotike, duhan) si dhe sjellje varësie. Në ditët e sotme, varësia ka një kuptim më të gjerë për fëmijët dhe për adoleshentët, pasi përfshin gjithashtu, një lidhje jashtë kontrollit me internetin dhe me videolojërat. Sjellja kalon nga sjellje normale, në varësi, kur bëhet zakon i pakontrollueshëm. Shpesh në moshën e adoleshencës, kur individët janë të ekspozuar  ndaj ndryshimeve të mëdha fizike dhe emocionale mund të kërkojnë mënyra për të përballuar e menaxhuar stresin, ankthin dhe emocionet e vështira, ndaj shpesh adoleshentët janë me të predispozuar të shfaqin sjellje varësie. Pasi bëhet varësi, ky zakon mund të çojë në pasoja negative dhe të dëmshme. Njerëzit e pothuajse çdo moshe, mund të bëhen të varur nga çdo aktivitet ose stimulim i këndshëm.

### Shenjat me të cilat mund të shfaqen varësitë te fëmijët dhe tek adoleshentët

Simptomat e varësisë te fëmijët ndryshojnë, çdo gjë varet nga substanca ose nga sjellja e përfshirë. Ajo që të gjitha varësitë ndajnë, janë pasojat negative që ato shkaktojnë. Ndryshimet mund të jenë fizike ose mund të ketë ndryshime delikate/dramatike, në sjelljen dhe në temperamentin e një fëmije. Ajo që i ndërlikon gjërat, për identifikimin e hershëm të varësive, është se fëmijët dhe adoleshentët kalojnë gjithashtu, ndryshime, si pjesë e natyrshme e rritjes, dhe këto ndryshime nuk janë gjithmonë të këndshme.

Disa nga shenjat paralajmëruese të varësisë te një fëmijët ose tek adoleshentët janë:

- Era e alkoolit, e duhanit, ose aroma të tjera të çuditshme në frymëmarrje ose në lëkurë;
- Një ndryshim në sjellje, duke u bërë më argumentues ose duke u izoluar;
- Kalon më shumë se 20 orë në javë në internet ose duke luajtur videolojëra;
- Sytë e skuqur dhe ankesat kronike shëndetësore (dhimbje të ngjashme me gripin, shqetësime në stomak);
- Ndryshimet në mënyrën e të ngrënit ose të gjumit;
- Humbja e interesit për shkollën;
- Miq të rinj (më pak interes për familjen ose për aktivitetet shkollore);
- Copa  ose letra të njoma, me kimikate;
- Ndjenjat e vetmisë, depresion;
- Sjellje të dëmshme ose të rrezikshme (të tilla si: thyerja e gjërave, vandalizmi, vjedhja);
- Lëndimi i vetes (prerja e trupave të tyre);
- Çrregullimet e të ngrënit.

***<u>Pse fëmijët ose adoleshentët përfshihen në sjellje varësie?</u>***

Ekzistojnë shumë teori për shkakun e varësisë tek të rinjtë, por disa arsye pse adoleshentët mund të krijojnë sjellje varësie ndaj përdorimit të substancave ose internetit, janë sepse:

- Duan të përshtaten me miqtë ose me grupe të caktuara;
- U pëlqen mënyra se si i bën të ndihen;

- Besojnë se kjo i bën ata më të rritur;
- Priren të provojnë gjëra të reja dhe të rrezikojnë;
- Shmangia nga situatat e vështira familjare/shoqërore;
- Mënyrë përballimi për emocionet e vështira.

Prirjet e varësisë mund të gjenden edhe në arsimin 9-vjeçar. Këto tendenca mund ta bëjnë një fëmijë më të prekshëm ndaj varësive.

**Marrësit e rrezikut-** Fëmijët që janë guximtarë, mund të kenë dëshirë të vazhdueshme dhe të nxiten të marrin adrenalinë, duke u përfshirë në aktivitete, që nxisin marrjen e kënaqësisë.

**Eksperimentuesit** - Kur fëmijët e vegjël (në mes moshës 9 dhe 12 vjeç) eksperimentojnë me drogë ose me alkool, ata kanë rrezik shumë më të madh, që më vonë të bëhen të varur. Efektet kimike dëmtojnë trurin e ri dhe ndikojnë në rritjen dhe në zhvillimin e përgjithshëm.

**Impulsiviteti** - Disa fëmijë nuk mësojnë se si të kontrollojnë impulset e tyre. Ata duan kënaqësi të menjëhershme. Ata janë të padurueshëm dhe intolerant ndaj zhgënjimit. Këta fëmijë mund të kenë vështirësi, të trajtojnë ndjenjat e tyre dhe të kontrollojnë impulset ndaj substancave ose aktivitetet që shkaktojnë varësi.

**Gjenetika -** Shumë studime kanë vërtetuar, se fëmijët e prindërve që janë në varësi, janë në një rrezik shumë më të madh për t'u bërë dhe vetë të varur.

**Trauma e fëmijërisë -** Kur fëmijët kanë vuajtur nga trauma fizike, mendore ose seksuale, ata mund t'i drejtohen sjelljeve ose substancave të varura, për t'i ndihmuar në përballimin e dhimbjes dhe të stresit. Kjo është veçanërisht e vërtetë, nëse atyre nuk u janë mësuar kurrë strategji të shëndetshme përballimi.

**Tjetërsimi ose izolimi social** - Fëmijët që ndihen të izoluar ose të tjetërsuar nga shoqëria, mund të jenë në rrezik për varësi. Atyre mund t'u mungojë vetëbesimi, duke mos ditur se si t'u drejtohen të tjerëve për nevojat e tyre emocionale. Ata kanë më shumë gjasa, t'i drejtohen sjelljeve të varësisë ose substancave si mënyrë përballimi.

**Ndërhyrja në kontekstin shkollor**

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërmerr këta hapa, mbështetur dhe në planin vjetor, përkatësisht në realizimin e temave të ndryshme sociale, aktiviteteve kreative dhe ndërgjegjësuese:

**<u>Parandalon</u>**

Punonjësi i SHPSSH-ës parandalon, duke:

- Realizuar sesione informuese/ndërgjegjësuese me nxënës, me prindër, me mësues për shenjat identifikuese dhe ndikimin negativ që kanë varësitë te shëndeti i fëmijëve dhe adoleshentëve.
- Seminare parandaluese mbi përdorimin e drogës dhe duhanit dhe pasojave të tyre tek të rinjtë.
- Zhvilluar pyetesorë dhe anketime me nxënës të grupmoshave të ndryshme, për identifikimin e rasteve që shfaqin problem me sjelljen e varësisë.
- Krijuar grupe mbështetëse (p.sh., me senatorët e klasave ose me nxënës me aftësi të mira sociale), me qëllim identifikimin, menaxhimin dhe referimin e rasteve pranë SHPSSH-ës dhe mësuesve.

**Problematikat e varësisë mund të identifikohen/referohen nga:**

- Mësuesi/stafi drejtues
- Bashkëmoshatarët
- Punonjësi i SHPSSH-ës
- Prindi
- Oficeri sigurisë
- Çdo aktor tjetër (individë të komunitetit pranë shkollës).

**<u>Vlerëson</u>**

Punonjësi i SHPSH-ës merr kohën e nevojshme për të vlerësuar situatën, nëpërmjet:

- Vëzhgimit (lista e kontrollit) në klasë dhe në ambientet e shkollës, për sjelljet e papërshtatshme;

- Intervistës me nxënësin;
- Takimit me prindërit, për të marrë informacion rreth mënyrave ose angazhimeve të nxënësin jashtë mjedisit të shkollës;
- Intervistës me mësuesin kujdestar dhe lëndor, mbi qëndrimin dhe sjelljen e nxënësit në klasë;
- Analizimit të të dhënave të mbledhura nga intervistat, nga vëzhgimet, dhe pyetësorët.

**<u>Ndërhyn</u>**

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërhyn në dy mënyra:

A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë.
B. Ndërhyrje e tërthortë.

**A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë**

<u>Ndërhyrje në nivel individual</u>

Plani ndërhyrjes mund të hartohet sa më herët me qëllim adresimin e faktorëve të rrezikut, për abuzimin me duhanin, me drogën, me internetin, me ushqimin (pijet energjike), sjelljen agresive, me aftësitë e dobëta sociale dhe me vështirësitë akademike. Në planin e ndërhyrjes së hershme, duhet të synohet përmirësimi i të mësuarit socio-emocional, për të trajtuar faktorët e rrezikut. Ndërhyrjet mund të jenë më efektive, kur kombinohen, si p.sh., ndërhyrja e fokusuar në familje së bashku me ndërhyrjen në shkollë.

**Hapat që mund të ndiqen:**

- Këshillim/konsultim individual i fëmijës;
- Hartimi i planit të ndërhyrjes në bashkëpunim me prindin dhe me mësuesin kujdestar të nxënësit;
- Administroni instrumente psikologjike dhe lista kontrolli pët të vlerësuar në mënyrë objektive varësinë nga nikotina dhe substancat narkotike.
- Kërkojini nxënësit të lexojë literaturë mbi varësinë nga substancat narkotike, origjinën e tyre dhe pasojat negative sociale, emocionale dhe mjekësore.

- Kërkojini nxënësit të bëjë një listë të mënyrave në të cilat varësia ka ndikuar për keq tek jeta e tij dhe tek familja, miqtë, marrëdhëniet me të tjerët. Nxiteni të bëjë plane për të kompensuar për këto pasoja.
- Analizoni problemet fizike, psikologjike apo burimet e stresit që ndikojnë të varësia.
- Caktojini nxënësit të bëjë një listë me 10 arsye për të hequr dorë nga nikotina apo substancat narkotike.
- Ndihmojeni nxënësin të dallojë pandershmërinë që lidhet me varësinë. Caktojini nxënësit të bëjë një listë me 10 gënjeshtra që kanë thënë për shkak të varësisë.
- Ndihmojeni nxënësin të planifikojë aktivitete zbavitëse që nuk lidhen me përdorimin e duhanit apo lëndëve narkotike dha aktivitete productive që e ndihmojnë të përmirësojë vet-vlerësimin.
- Nxënësit i mësohen aftësi të mira komunikimi. Psh. Nxënësi mëson të përgjigjet me empati, rëndësia e dëgjimit aktiv, "mesazhet me unë", komunikimi i respektueshëm, komunikimi bindës pa u treguar agresivë, dhe rëndësia e kompromisit etj.
- Nxënësit i mësohen teknika përballimi si relaksimi progresiv i muskujve dhe imagjinata e drejtuar, ndalimi i mendimeve negative, përsëritja e pohimeve pozitive për veten, shpërqendrimi kur hasin tundim etj.
- Duke përdorur modelimin, luajtjen e roleve dhe udhëzimin, mësojini nxënësit si të refuzojë kur i ofrohet duhan, alkool apo substance narkotike. Mësojini nxënësit situatat që përbëjnë rrezik si presioni social dhe konfliktet ndërpersonale dhe të planifikojë si to veprojë në situate që përbëjnë rrezik të lartë.
- Ndihmojeni nxënësin të kuptojë arsyet e përdorimit të substancave dhe të identifikojë mënyra të shëndetshme për të arritur rezultate të mira.
- Identifikoni burimet e stresit për nxënësin dhe ndihmojeni që të zgjidhë dhe menaxhojë këto shqetësime pa përdorimin e substancave.
- Ndihmoni të fuqizojë aftësitë organizuese/planifikuese dhe krijimi i rutinave të shëndetshme;
- Mësojini aftësitë socio-emocionale dhe rritjen e ndërveprimit me bashkëmoshatarët;

- Inkurajojeni nxënësin të planifikojë një regjim të rregullt me ushtrime fizike për të përmirësuar vet-vlerësimin, reduktuar ndjenjat negative dhe për të përmirësuar shëndetin fizik.
- Fuqizojini me teknika për të rritur vetë-kontrollin, vetëbesimin.
- Rritja e ndërgjegjësimit emocional (identifikimi dhe emërtimi i emocioneve).
- Rritja e komunikimit dhe verbalizimi i emocioneve dhe i mendimeve.
- Reduktimi i sjelljeve kundërshtuese dhe implusive.
- Përforcimi i sjelljeve të dëshiruara nga mësuesit/prindërit/bashkëmoshatarët.
- Psiko-edukimi me prindërit e fëmijës/personat përgjegjës, me qëllim ndërgjegjësimin dhe identifikimin e hershëm ndaj sjelljeve të varësisë.

**B.Ndërhyrje e tërthortë në grup/klasë**

Gjatë ndërhyrjes në grup, fokusi do të jetë në:

- Informimin e mësuesve për praktikat e mira të menaxhimit të klasës, si p.sh., shpërblimi i sjelljes së duhur të nxënësve;
- Teknikat përforcuese, pasi ndihmojnë për të nxitur sjelljen pozitive të nxënësve, në arritjet mësimore, në motivimin akademik dhe në lidhjen me shkollën;
- Aktivitetet edukuese, me qëllim fuqizimin dhe angazhimin në sjellje pozitive, edukuese dhe përfituese për veten dhe të tjerët;
- Rritjen e bashkëpunimit dhe të ndërveprimit në grup.

**B. Ndërhyrja në nivel shkolle**

Gjatë ndërhyrjes në nivel shkolle, fokusi do të jetë në:

- Bashkëpunimin me institucionet dhe me organizatat e ndryshme, me fokus temën e varësisë.
- Aktivitetet me bazë shkolle, me prindër, mësues, me qëllim reduktimin e fenomenit të varësisë.

- Bashkëpunimin me drejtorinë e shkollës, për të vënë në zbatim planin e veprimit specifik.

**Referimi**

Në bazë të nevojave të vlerësuara të nxënësit, bëhet referimi për shërbime më të specializuara, duke respektuar kështu, edhe kompetencat e rolit të shërbimit psiko-social në shkollë.

# Planifikimi i ndërhyrjes për raste me çrregullime humori në fëmijëri dhe në adoleshencë

Çrregullimet e humorit në fëmijëri dhe në adoleshencë, janë në fokus të punës së punonjësit të shërbimit psiko-social, Ato përfshijnë probleme të larta emocionale dhe lidhen me depresionin dhe emocionet negative. Tek fëmijët dhe adoleshentët këto probleme mund të shfaqen si ndjenja të vazhdueshme të trishtimit, humbja e interesit për aktivitetet që dikur kanë qenë të preferuara si dhe vështirësi për menaxhimin dhe përballimin e situatave stresuese. Simptomat dalluese në këtë grup çrregullimesh, janë ndryshimi i humorit shpesh i shoqëruar me ndryshim në rutinat e përditshme të nxënësit,

Nxënësi nuk merr kënaqësi nga aktivitetet sociale, shkollore etj. Interesi dhe përqendrimi pëson rënie, duke ndikuar drejtpërdrejt në jetën sociale dhe në rezultate shkollore dhe nxënësi ndien lodhje të theksuar edhe pas sforcimeve minimale. Rutinat e gjumit zakonisht prishen dhe oreksi ulet. Vetëvlerësimi dhe vetëbesimi ulen gjithnjë, edhe në format e lehta, ka gjithnjë një ndjenjë faji dhe ndjesi se është i pavlerë. Humori i ulur ndryshon pak, nga dita në ditë, dhe mund të shoqërohet me humbjen e ndjesive pozitive, me zgjimin në mëngjes disa orë më herët se koha e zakonshme, me ngadalësim të veprimeve të përditshme, irritim, humbje oreksi, humbje në peshë, ndihet i pashpresë.

### Format me të cilat mund të shfaqen çrregullimet e humorit në fëmijëri dhe në adoleshencë

**Çrregullimi depresiv (DEPRESIONI)** tek nxënësit shihet veçanërisht me simptoma si trishtimi i thellë, lodhje, humbje e vetëvlerësimit, humbje interesi si edhe me ndjesinë e të qenit i pavlerë ose fajtor. Mendimet vetëvrasëse janë të shpeshta dhe një numër simptomash somatike janë zakonisht të pranishme. **Format më të lehta të këtij depresioni, në asnjë rast, nuk duhen neglizhuar.** I rrituri pranë fëmijës, identifikon ndryshimet në sjellje, shpeshtësinë, intensitetin dhe kohëzgjatjen që nxënësi shfaq, në raport me aktivitetet në jetën e tij, dëshirën për t'u përfshirë në detyra të përshtatshme për moshën, vetëvlerësimin etj. Kur Simptomat e shfaqura janë të pranishme për të pakten dy javë si dhe kanë një ndikim të ndjeshëm në funksionimin e nxënësit në aktivitetet e përditshme atëherë punonjësi i shërbimit psiko-social referon për një vlerësim tek specialisti i shëndetit mendor në mënyrë që fëmija të marrë një shërbim më të specializuar.

**Çrregullimi distimik** (DISTIMIA) është një formë tjetër çrregullimi, ku nxënësit janë vazhdimisht në një gjendje të depresuar ose të irrituar në pjesën më të madhe të ditës, për shumë kohë ose për një periudhë, për të paktën një vit. Ajo që presim të shohim te kjo kategori fëmijësh, janë: vetëvlerësim i ulët, irritueshmëri ose zemërim i tepruar, tërheqje sociale, lodhje e vazhdueshme, ndjenja faji nga e kaluara, kujtesë dhe vëmendje e ulët.

**Çrregullimi bipolar karakterizohet nga periudha të alternuara të depresionit dhe manisë (ndjenja e tepërt e energjisë, emocioneve të forta dhe impulsivitetit).** Kur shfaqet tek nxënësi, ai mund të kalojë shumë shpejt nga një gjendje humori e rënë (ndjesia e të qenit i dobët dhe letargjik) në ekstremin tjetër (ndjesia e të qenit super aktiv), vetëvlerësim të lartë, ndjenjë madhështie, nevojë e paktë për gjumë, shpërqendrim, përfshirje të tepërt në aktivitete që japin kënaqësi, të cilat mund të çojnë edhe në pasoja lënduese.

### Ndërhyrja në kontekstin shkollor

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërmerr këta hapa, mbështetur në planin vjetor, përkatësisht në informimin dhe në ndërgjegjësimin e stafit pedagogjik, të prindërve, të komunitetit, rreth identifikimit të nxënësve të cilët shfaqin shenja

dalluese të problematikave të humorit, gjithashtu rrit ndërgjegjësimin mbi kërkimin e ndihmës nga vetënxënësi, sipas nevojës së shfaqur:

**<u>Parandalon</u>**

Punonjësi i SHPSSH-ës parandalon,duke:

- Realizuar seminare, përmes fletëpalosjeve informuese/ndërgjegjësuese me nxënës, me prindër, me mësues, për kujdesin ndaj shëndetit mendor dhe menaxhimin e stresit.
- Realizuar sesione informuese me stafin mësimdhënës, me qëllim identifikimin e rasteve me problematika të humorit, duke u fuqizuar mbi shenjat e hershme dalluese që nxënësi shfaq në situata të tilla.
- Zhvilluar pyetësorë dhe anketime me nxënës/prindër, për gjendjen psiko-emocionale të fëmijëve.
- Krijuar grupe mbështetëse (p.sh. me senatorët e klasave ose me nxënës me aftësi të mira sociale), me qëllim identifikimin, menaxhimin dhe referimin e rasteve pranë SHPSSH-ës.

**Problematikat lidhur me çrregullimet e humorit, mund të identifikohen/referohen, nga:**

- Prindi
- Mësuesi
- Bashkëmoshatarët
- Punonjësi i shërbimit psiko-social shkollor
- Çdo aktor tjetër (individë të komunitetit pranë shkollës).

**<u>Vlerëson</u>**

Punonjësi i SHPSSH-ës merr kohën e nevojshme për të vlerësuar situatën. Fokusi i vlerësimit të situatës është:

- Niveli i riskut të nxënësit për përfshirje në sjellje vetëdëmtuese.
- Ndikimi i problematikës së shfaqur, në funksionimin në jetën sociale dhe shkollore.
- Sistemi mbështetës i nxënësit në familje dhe në shkollë.

- Niveli i informacionit të prindit/kujdestarit ligjor, mbi problematikat e humorit dhe çrregullimet e shëndetit mendor.
- Nevoja për referim, për shërbime të shëndetit mendor.

**Punonjësi i shërbimit psiko-social:**

- Zhvillon konsulta me mësues/nxënës/prindër;
- Vëzhgon nxënësin në klasë dhe në mjedisin e shkollës;
- Realizon intervista fillestare me fëmijën;
- Përdor listat e kontrollit të riskut për vetëvrasje (shtojca 9),shkallën e depresionit të Beck-ut (shtojca 10), si dhe shkallën e vetëvlerësimit (shtojcat12, 13) etj.

***Punonjësi i SHPSSH-ës realizon kontakt me prindin, si më poshtë:***

- Në formën e bashkëpunimit dhe të mbështetjes, punonjësi i shërbimit psiko-social shkollor lehtëson situatën, duke paraqitur te prindi vlerësimin fillestar për gjendjen e fëmijës, shoqëruar me rekomandimet përkatëse.
- Orientojnë personat që ushtojnë përgjegjësinë prindërore për shërbimet që vijnë në ndihmë të përmirësimit të situatës së fëmijës, brenda dhe jashtë shkollës. Gjithashtu, i bënë me dije prindit, rëndësinë e bashkëpunimit shkollë-famije, në përmirësimin e situatës së fëmijës.

**<u>Ndërhyn</u>**

Punonjësi i SHPSSH-së ndërhyn në nivel individual (plani i ndërhyrjes), për ndjekjen e rastit hap pas hapi, nëpërmjet:

- Përdorimit të teknikave menaxhuese, me qëllim qetësimin e gjendjes emocionale, rritjen e vetëvlerësimit, rritjen e aftësisë së fëmijës për t'u vetëdijësuar për çka ndodh me të.
- Teknikave të meditimit që mund të realizohen në kushte shtëpie, të ndjekura dhe nga prindërit.
- Psiko-edukimit me prindërit, me qëllim, plotësimin e nevojave (ushqimi, higjiena, respektimi i orareve në kryerjen e aktiviteteve, koha cilësore).

- Vlerësoni frekuencën, intensitetin, kohëzgjatjen dhe historinë e simptomave të depresionit dhe të rrezikut të vet-vrasjes duke administruar teste ose lista-kontrolli.
- Referojeni nxënësin tek një mjek për një ekzaminim të plotë fizik për të përjashtuar shkaqet mjekësore për depresionin dhe një vlerësim në lidhje me nevojën për mjekime.
- Bëni një referim të menjëhershëm për nxënësit që paraqesin risk për vet-vrasje ose vet-dëmtim.
- Caktojini nxënësit si detyrë të shkruajë çdo ditë në mendimet negative që lidhen me depresionin në një ditar.
- Ndihmojeni nxënësin të përvetësojë strategji përballimi (p.sh. të bëjë më shumë ushtrime fizike, të përfshihet më shumë në aktivitete sociale, të shprehë më shumë ndjenjat, të jetë më bindës etj).
- Nxënësi mësohet të ridrejtojë vëmendjen në aktivitete të tjera duke planifikuar veprimtari që e ndihmojë të jetë më produktiv dhe që i japin më shumë kënaqësi.
- Nxënësi nxitet të hartojë një listë me aktivitete zbavitëse dhe sociale që e ndihmojnë të pasurojë cilësinë e jetës dhe të krijojë miqësi domethënëse.
- Nxënësit i mësohen aftësi problem-zgjidhëse dhe aftësi për zgjidhjen e konflikteve. Psh. Nxënësi mëson të përgjigjet me empati, rëndësia e dëgjimit aktiv, "mesazhet me unë", komunikimi i respektueshëm, komunikimi bindës pa u treguar agresivë, dhe rëndësia e kompromisit.
- Nxënësit i mësohen teknika të relaksimit progresiv të muskujve dhe imagjinata e drejtuar.
- Përdoren udhëzimet, modelimi dhe teknikat e luajtjes së roleve për ta ndihmuar të ndërtojë aftësitë sociale dhe komunikimin.
- Mësojini nxënësit aftësitë problem –zgjidhëse që përfshijnë identifikimin e një problemi që e shqetëson më shumë, analizimi i avantazheve dhe disavanazheve të secilës zgjedhje dhe marrja e një vendimi duke ndjekur keta hapa. Nxënësi inkurajohet të mos marrë vendime të mëdha derisa të përmirësohet gjendja e tij/saj emocionale.
- Ndihmojeni nxënësin të hartojë një listë me 20 pohime pozitive për veten duke përfshirë cilësitë dhe arritjet e tij dhe ta lexojë cdo mëngjes.

- Ndihmojeni nxënësin të bëjë plane për të ardhmen dhe të vendosë synime akademike për të përmirësuar vet-vlerësimin dhe përmirësuar gjendjen e humorit.
- Nxiteni familjen t'i japë nxënësit mundësi të shprehë emocionet, ndjenjat dhe konfliktet që ka. Gjithashtu mësojini të reagojnë me empati dhe të tregohen mbështetës kur nxënësi shpreh ndjenjat. Prania e ideve vetë-dëmtuese ose suicidale

**Në rast se vlerësohet prania vetë-dëmtimit ose ideve suicidale:**

- Vlerëso rrezikshmërinë e ideve suicidale duke bërë pyetje mbi mendimet, planet dhe sjelljet që lidhen me veprimet vetë-dëmtuese.

***Vlerëso qellimet suicidale:***

- Rreziku nuk egziston;
- Rreziku është i bute – ide por jo një plan suicidal;
- Rreziku është i moderuar – Ide dhe plan i përgjithshëm , por ka motive për të jetuar;
- Rreziku i rëndë – idetë suicidale janë të shpeshta, plani është specifik dhe vdekjeprures, mjetet janë të pranishme dhe mbështetja shoqërore e pakët.
- Rrezik ekstrem – qëllim i qartë për të vrarë vetë sapo të paraqitet mundësia.

- Nxënësi nxitet të nënshkruajë një kontratë për të mos dëmtuar veten në të cilën pohon se nuk do ta dëmtojë veten dhe që do komunikojë me një profesionist nëse ka mendime suicidale.
- Komuniko me prindërit dhe referoje nxënësin tek një mjek për një ekzaminim të plotë fizik dhe një vlerësim në lidhje me nevojën për mjekime.
- Ndihmoje nxënësin të bëjë një listë me arsye pse ia vlen të jetosh (psh. njerëzit që e duan, vendet, gjërat që janë pjesë e jetës së tij/saj).
- Ndihmojeni nxënësin të përvetësojë strategji përballimi (p.sh. të bëjë më shumë ushtrime fizike, të përfshihet më shumë në aktivitete sociale, të shprehë më shumë ndjenjat etj.)

- Vlerëso planet suicidale : Specifikat e planit, vdekshmërinë, aksesin në mundësitë apo mjetet e realizimit të aktit, mundësinë e mbështetjes shoqërore.
- Identifiko alternativat kundrejt vetvrasjes. Ndihmoje nxënësin të identifikojë mënyra të tjera për të dalë nga situata apo për ta zgjidhur problemin, përvec vetëdëmtimit.
- Mos e minimizoni problemin e tij/saj dhe ndjenjat shqetësuese. Mbi të gjitha duhet të përqendrohemi te dëshira dhe motivet për të jetuar ( bëni një listë të arsyeve për të jetuar dhe të njerëzve apo aktiviteteve që i japin kuptim jetës së tij/saj).
- Përpiquni të arsyetoni pse veprimet impulsive janë të gabuara dhe të paarsyeshme.
- Vet - dëmtimi është një akt komunikimi. Nxiteni nxënësin të shprehë problemet dhe burimet e stresit që e shqetësojnë dhe mësojini nxënësit aftësitë problem –zgjidhëse që përfshijnë identifikimin e një problemi që e shqetëson më shumë, analizimi i avantazheve dhe dizavanazheve të secilës zgjedhje dhe marrja e një vendimi duke ndjekur këta hapa.
- Dokumentimi i kujdesshëm dhe i detajuar i menaxhimit të rastit.

**Kujtesë:** Në çdo rast, prindi përfshihet në planin e ndërhyrjes, ku caktohen detyra të veçanta për secilin aktor (përveç rasteve kur prindi është abuzues, dhunues).

## Dokumentimi dhe menaxhimi i rastit

Punonjësi i SHPSSH-ës hap dosje të veçantë për nxënësin, ku vlerësohet e gjithë ecuria e rastit, nëse ka progres në minimizimin e simptomave dhe rikuperim. Nëse kemi sukses, gjatë përfundimit të hapave të ndërmarrë, vijohet përsëri vëzhgimi dhe kujdesi ndaj rastit, pasi mund të ndodh që të përsëritet situata e përjetimit të simptomave të çrregullimit. Kështu, vijohet me mbylljen e rastit.

## Referimi

**Referimi te mjeku i familjes** është një opsion, bazuar në shkallën e shfaqjes së çrregullimit. Në bazë të nevojave të nxënësit sugjerohet referimi në shërbime më të specializuara, duke respektuar kështu, edhe kompetencat e punonjësit të shërbimit psiko-social në shkollë. Me bashkëpunimin e prindërve, SHPS merr informacionin e nevojshëm mbi vlerësimin dhe shërbimet që fëmija po merr në

vijimësi jashtë shkollës, me qëllim rritjen e efikasitetit të ndërhyrjeve brenda shkollës. Gjithashtu, përmes prindit, jep informacion mbi gjendjen dhe ecurinë e fëmijës në shkollë.

Nëse çrregullimi apo simptomat ndodhin paralelisht apo janë të ndikuara nga ngjarje, nga situata apo nga problematika të tjera, si dhuna në familje, neglizhenca, abuzim i formave të ndryshme, ngjarje traumatike etj., rasti referohet në PMF/NJMF. Në varësi të situatës dhe të planit të ndërhyrjes së përcaktuar nga GTN-ja, punonjësi i SHPSSH-ës ndjek ecurinë e fëmijës në IA dhe raporton pranë PMF/NJMF-ës.

# Çrregullimet e të ngrënit

Këto çrregullime janë të shpeshta gjatë adoleshencës veçanërisht për shkak të shqetësimeve që lidhen me pamjen e trupit dhe pritshmëritë sociale. Këto çrregullime kanë një ndikim të madh në shëndetin mendor tek nxënësit.

**Format me të cilat mund të shfaqen:**

**Anoreksia nervore** kur nxënësit kanë një frikë të madhe nga shtimi në peshë dhe e shohin veten më të shëndoshë sec janë në të vërtetë. Ata kanë një imazh të paqartë për trupin e tyre. Disa simptoma të anoreksisë nervore janë:

- Kufizimi i ushqimit deri në nivele të rrezikshme;
- Dëshira e tepruar për të kontrolluar vazhdimisht peshën trupore;
- Ndjenja e të qënurit mbipeshë edhe kur pesha është shumë e ulët;
- Përdorimi i metodave ekstreme për uljen e peshës si laxative, dieta ekstreme dhe ushtrime të tepërta fizike;
- Mungesa e menstruacioneve tek vajzat (amenorrea).

**Bulimia nervore** përfshin episode të përsëritura të ngrënies së tepërt të ushqimit e më pas përdorimit të metodave të dëmshme të provokimit të ushqimit për ta nxjerrë/vjellë duke përdorur diuretikë. Shenjat dhe simptomat e bulimisë janë:

- Episode të tepruara të ngrënies së ushqimit, ku nxënësi konsumon sasi të mëdha të ushqimit dhe nuk ndalon dot;

- Përdorimi i metodave ekstreme për të shmangur fitimin e peshës si të vjellat e ushqimit, përdorimi i ilaçeve ose ushtrime të tepërta;
- Ndjenja turpi dhe faji për ngrënien e tepërt;

**Çrregullimi i ngrënies së tepruar (binge eating)** është i ngjashëm me buliminë por dallimi qëndron se këtu nxënësit nuk përdorin metoda të dëmshme për të hequr dorë nga ushqimi. Konsumimi i ushqimit në këtë rast quhet ndryshe të ngrënit emocional, ku për shkak të intesititetit emocional që nxënësit është duke kaluar ai përpiqet ta përballojë me anë të ushqimit duke ngrënë në mënyrë të çrregullt dhe të tepruar. Disa shenja dhe simptoma:

- Episode të shpeshta të ngrënit të ushqimit në sasi të mëdha edhe kur nuk është i uritur;
- Përdorimi i ushqimit si mënyrë për të përballuar stresin dhe emocionet negative;
- Ndjenja e turpit dhe fajit pas episodeve të ngrënies së tepruar.

**Shkaqet e çrregullimeve të të ngrënit**

1. Faktorët biologjikë -kanë histori familjarë të çrregullimeve të të ngrënit

2. Vetëvlerësimi i ulët -nxënësit mendojnë se duke ndryshuar pamjen e tyre të jashtme do të ndihen më të vlerësuar ose më të pranuar

3. Stresi dhe ankthi –ushqimi përdoret nga shumica e adoleshentëve si mënyrë për të përballuar emocionet e vështira.

4. Presioni social dhe ndikimi i medias – presioni për të pasur një trup perfekt është një nga shkaqet kryesore që ndikon në zhvillimin e çrregullimeve të të ngrënit. Media shpesh promovon standarte të pamundura që mund të ndikojnë ndjeshëm në shëndetin mendor të nxënësve.

**Ndërhyrja në kontekstin shkollor**

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërmerr këta hapa, mbështetur dhe në planin vjetor, përkatësisht në realizimin e temave të ndryshme sociale, aktiviteteve kreative dhe ndërgjegjësuese:

**Parandalon**

Punonjësi i SHPSSH-ës parandalon, duke:

- Realizuar seminare informuese/ndërgjegjësuese me nxënës, prindër, mësues, për zakonet e shëndetshme të të jetuarit, për shëndetin mendor dhe shëndetin fizik, për menaxhimin e stresit dhe shmangien e sjelljeve që dëmtojnë shëndetin.
- Trajnuar stafin pedagogjik, me qëllim identifikimin e rasteve që kanë nevojë për ndihmë profesionale.
- Krijuar grupe mbështetëse (p.sh., me senatorët e klasave ose me nxënës me aftësi të mira sociale), me qëllim identifikimin, menaxhimin dhe referimin e rasteve pranë SHPSSH-së dhe mësuesve.

**Rastet e çrregullimeve në të ngrënë mund të identifikohen/referohen nga:**

- Mësuesi/Stafi drejtues
- Punonjësi i SHPSSH-ës
- Prindi
- Bashkëmoshatarët
- Çdo aktor tjetër brenda shkollës apo individë të komunitetit pranë shkollës
- Oficeri i sigurisë .

**Vlerëson**

Punonjësi i SHPSH-ës merr kohën e nevojshme, për të vlerësuar situatën, duke:

- Intervistuar nxënësin dhe administruar lista kontrolli dhe instrumente të tjera,
- Konsultuar/takuar prindërit për informimin e gjendjes dhe ecurinë e fëmijës në familje.
- Takuar mësuesit kujdestarë dhe lëndorë për qëndrimin dhe për gjendjen e fëmijës në klasë.

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërhyn në dy mënyra:

A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë.

B. Ndërhyrje e tërthortë.

## A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë

*Ndërhyrje në nivel individual:*

- Vlerësohen zakonet e të ngrënit, mendimet, qëndrimet dhe mendimet mbi ushqimin. Merret një historik i plotë i sjelljeve që lidhen me të ngrënin.
- Nxënësi referohet për një ekzaminimin të plotë mjekësor.
- Nxënësi referohet tek mjeku i familjes ose mjeku nutricionist për të vlerësuar efektet që kanë tek shëndeti i tij/saj zakonet e të ngrënit.
- Nxënësi nxitet të marrë pjesë në aktivitete fizike dhe sporte të ndryshme.
- Rishikohen mendimet negative që ka nxënësi dhe që ndikojnë tek zakonet e të ngrënit.
- Nxënësi ndihmohet të zëvendësojë këto mendime me mendime realiste, të bazuara në fakte. Nxënësi mësohet të krijojë pohime positive për veten dhe t'ia përsërisë vetes.
- Mësojini nxënësit teknika relaksimi (p.sh., relaksimi progresiv i muskujve, ushtrimet e frymëmarrjes dhe imagjata vizuale e drejtuar).
- Nxënësit i kërkohet të plotësojë një listë me probleme apo situata që i shkaktojnë frikë ose shqetësim dhe që mund të ndikojnë tek problemet e të ngrënit.
- Përdorni teknika për zgjidhjen e problemeve për ta ndihmuar nxënësin të zgjidhë problemet dhe konfliketet që e shqetësojnë.
- Mësojini nxënësit strategjitë e zgjidhjes së problemeve që përfshijnë përcaktimin specifik të një problemi, gjenerimin e opsioneve për adresimin e tij, vlerësimin e opsioneve, zbatimin e një plani, dhe rivlerësimin dhe përmirësimin e planit.
- Nxënësi mëson teknika të komunikimit dhe zgjidhjes së konfliktit, kultivimin e empatisë, “mesazhet me unë”, dëgjimi aktiv dhe komunikimin e respektueshëm duke përdorur modelimin dhe luajtjen e roleve.
- Familja mësohet të mbështesë nxënësin dhe si të menaxhojnë stresin në mënyrë që të ndihmojnë nxënësin me ecurinë e tij shëndetësore.

## B. Ndërhyrje e tërthortë në grup/klasë

Gjatë ndërhyrjes në grup, fokusi do të jetë në:

- Teknikat përforcuese, pasi ndihmojnë për të nxitur sjelljen pozitive të nxënësve, në arritjet mësimore, në motivimin akademik dhe në lidhjen me shkollën;
- Aktivitetet edukuese, me qëllim fuqizimin dhe angazhimin në sjellje pozitive, edukuese dhe përfituese për veten dhe të tjerët;
- Rritjen e bashkëpunimit dhe të ndërveprimit në grup.

### C. Ndërhyrja në nivel shkolle

Gjatë ndërhyrjes në nivel shkolle, fokusi do të jetë në:

- Bashkëpunimin me institucionet dhe me organizatat e ndryshme, me fokus temën e çrregullimeve të të nxënit

## Referimi

Në bazë të nevojave të vlerësuara të nxënësit, bëhet referimi për shërbime më të specializuara, duke respektuar kështu, edhe kompetencat e rolit të shërbimit psiko-social në shkollë.

# PLANIFIKIMI I NDËRHYRJES PËR RASTET E DHUNËS

**Përkufizimi i dhunës**

Sipas OBSH-së: "**Dhunë** quhet përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike ose i fuqisë, të kërcënimit ose të përdorimit të saj real, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti, forcë e cila çon ose ka mundësi të çojë në plagosje, vdekje, dëmtim psikologjik ose në privim." (OBSH, 1999 dhe 2002). **Dhuna ndaj fëmijëve,** sipas nenit 19-të, të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, përfshin çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, neglizhimi apo trajtimi neglizhues, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

**Abuzimi dhe keqtrajtimi i fëmijëve**. Të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimi seksual, neglizhimi ose trajtimi neglizhues a shfrytëzimi ekonomik ose çdo shfrytëzim tjetër, që çojnë në dëmtim real ose të mundshëm të shëndetit të fëmijës, të mbijetesës, të zhvillimit ose të dinjitetit, në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose pushteti.

**Ndëshkimi trupor.** Çdo ndëshkim në të cilin përdoret forca fizike, me synimin për të shkaktuar një shkallë të caktuar dhimbjeje apo mungesë rehatie, sado të lehtë.

**Format e dhunës**

**DHUNA FIZIKE**. Çdo formë dëmtimi joaksidental, nga mungesa e qëllimshme e kujdesit, të cilat ndikojnë në zhvillimin dhe në shëndetin e fëmijës.

Shembuj të dhunës fizike:

**Mavijosja dhe fshikullima**

- të pashpjeguara, të pazakonta, dyshuese, joaksidentale;
- të lokalizuara në fytyrë, në buzë, në gojë, në trung, në kofshë, në vithe;
- në stade të ndryshme shërimi (ngjyra të ndryshme);
- të grumbulluara, duke formuar shenja të dukshme;
- i mbytur në shenja;

- shenjë e dorës njerëzore;
- të shfaqura rregullisht pas fundjavave ose pushimeve;
- gërvishtje.

**Dëmtime dhe gjuajtje me ose pa objekte**

- dëmtime të kokës, hematoma;
- dëmtime të brendshme;
- vjellje konstante.

**Djegie**

- e formësuar si cigare, kryesisht në pulpë, në pëllëmbë, mbrapa ose në vithe;
- djegie të brendshme (vithe, zonat gjenitale);
- djegie në formë sobe elektrike ose hekuri;
- djegie në vende ku nuk mund të digjesh vetë, si në krahë, në këmbë, në qafë ose në trung.

**Fraktura**

- fraktura të kohëve të ndryshme;
- fraktura të pashpjegueshme.

**DHUNA PSIKOLOGJIKE/EMOCIONALE**. Abuzimi verbal dhe joverbal ose kërkesa të ekzagjeruara, që dëmtojnë rritjen e fëmijëve, duke çuar në imazh negativ për veten apo shqetësime në sjellje.

**Shembuj të dhunës psikologjike/emocionale:**

- injorimi i nevojave fizike - emocionale të fëmijës;
- refuzimi i dashurisë;
- terrorizimi apo kërcënimi;
- degradimi, turpërimi apo komentet ngacmuese;
- izolimi i fëmijës për periudha të gjata kohore;
- korruptimi i fëmijës duke inkurajuar sjellje antisociale.

**DHUNA SEKSUALE.** Veprime seksuale me ose pa kontakt. Shfrytëzimi i fëmijës për qëllime kënaqësie seksuale ose përfitimi ekonomik nga një i rritur, nga një fëmijë

më i madh ose nga një adoleshent, duke përdorur forcën fizike, detyrimin ose bindjen, me ose pa pëlqimin e fëmijës.

**Shembuj të dhunës seksuale:**

- prekja e qëllimshme ose ngacmimi i trupit të fëmijës;
- ekspozimi i organit ose aktit seksual, që kryhet qëllimisht në prani të fëmijës;
- prostituimi i fëmijës ose shfrytëzimi seksual, si ekspozime, modelime, për qëllime të kënaqësisë seksuale;
- incesti;
- masturbimi në prani të fëmijës ose përfshirja në një akt masturbimi;
- ekspozimi i filmave pornografikë ose i fotove;
- shfrytëzimi seksual i fëmijës;
- ekspozimi i trupit.

**NEGLIZHENCA OSE TRAJTIMI NEGLIZHENT.** Veprime, lënie pas dore e fëmijës, nga prindërit ose nga kujdestarët, të cilat ndikojnë në nevojat bazë të fëmijës, duke përfshirë ushqimin, higjienën, veshjen, kujdesin shëndetësor dhe një ambient të ngrohtë jetese.

**Shembuj të neglizhimit:**

- uri e vazhdueshme ose kequshqyerje (nxënësi është nën peshë, i lodhur, i këputur etj.);
- higjienë e varfër të fëmijës (thonj të gjatë, të pistë, erë e keqe e trupit, flokë të palarë e të pakrehur, parazitë në kokë e në trup);
- mungesë kujdesi mjekësor (nuk është trajtuar nga mjeku me medikamente ose probleme mjekësore te patrajtuara);
- veshje e papërshtatshme me stinën ose me motin (kjo mund të ketë shkaktuar kollë, pneumoni, djegie nga dielli etj.);
- braktisje (vonesa ose mosfrekuentim të shkollës);
- lënie në përkujdesje të një personi jo të përshtatshëm.

### Roli dhe përgjegjësitë e institucioneve arsimore

1. Punonjësit e institucioneve arsimore, çdo mësues dhe çdo ofrues i shërbimit psiko-social në shkolla, bëjnë identifikimin e fëmijëve në nevojë për

mbrojtjen dhe për referimin në kohë në NJMF, në nivel bashkie apo pranë PMF-ës, në nivel njësie administrative dhe, në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë.

2. Personi përfaqësues i institucionit arsimor, i caktuar:

   a) është përgjegjës për lehtësimin, për mbështetjen dhe për zbatimin e PIM-it, që parashikon ndjekjen e shkollës nga fëmijët në nevojë për mbrojtje;

   b) merr pjesë në takimet e GTN-ës dhe mbështet zhvillimin dhe zbatimin e PIM-it për fëmijën;

   c) merr masa që fëmijës në nevojë për mbrojtje, t'i sigurohen tekste dhe mjete shkollore falas.

**Dokumentimi dhe menaxhimi i rastit**

1. **Hapja e dosjes për nxënësin**

Dosja përfshin formularin e referimit, materiale vlerësimi (vlerësime psikologjike dhe/ose sociale të së kaluarës, vëzhgimet në klasë dhe intervistat me prindërit, listat e kontrollit të plotësuara etj.), informacionin mjekësor, përmbledhjet e takimeve të mbajtura nga grupi, planin e ndërhyrjes ku përfshihet dhe monitorimi i progresit në lidhje me fëmijën. Dosja e plotë aksesohet vetëm nga shërbimi psiko-social. Drejtori i shkollës dhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera përgjegjëse mund të kenë akses në dosje, vetëm për raste të veçanta, pasi të kenë nënshkruar një formular, që i detyron ata për konfidencialitet.

2. **Menaxhimi i rastit nga shërbimi psiko-social**

Punonjësi social është menaxheri i rastit dhe në bashkëpunim me stafin, mbledh informacionin për rastin, bashkëpunon ngushtësisht më psikologun shkollor nëse shkolla ka një të tillë.

| Punonjësi social | Psikologu |
|---|---|
| Punonjësi social, menaxheri i rastit, mbledh informacion së bashku me stafin, në lidhje me fëmijën që ka nevojë për mbrojtje. | Psikologu realizon vlerësimin dhe aplikimin e testeve psikologjike (sipas nevojes dhe kur të jenë të |

| | |
|---|---|
| | disponueshme), si dhe ndërhyrje sipas rastit. |
| Punonjësi social do të kryejë: takimet me mësuesin, me prindin, bashkëpunimin shkollë-familje-institucione komunitare, për mbledhjen e informacioneve të nevojshme. | Nëse shkolla nuk ka punonjës social, rolin e menaxherit të rastit e kryen psikologu. |
| Menaxheri i rastit kujdeset për dokumentacionin, për takimet (prindër, mësues) dhe për shërbimet. | |
| Menaxheri i rastit është përgjegjës për kontaktin e drejtpërdrejtë me fëmijën. | |
| Menaxheri i rastit monitoron përparimin e fëmijës dhe regjistron rezultatet në dosje. | |

### 3. Hapat e rëndësishëm për menaxhimin e rastit

Ndiqen hapat e mëposhtëm për menaxhimin e rastit:

1) Identifikimi
2) Raportimi
3) Vlerësimi fillestar
4) Vlerësimi i plotë
5) Hartimi i planit individual të mbrojtjes nga PMF-ja
6) Zbatimi, ndjekja dhe monitorimi i PIM-it
7) Mbyllja e rastit.

**Identifikimi** i një fëmijë në nevojë për mbrojtje, bëhet nga çdo person fizik ose juridik, çdo punonjës i institucioneve publike dhe private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, me mësuesit, me ofruesit e shërbimit psiko-social shkollor, nga strukturat e Policisë së Shtetit, nga Drejtoria për Azilin dhe Antitrafikimin, nga Qendra Kombëtare e Pritjes për Azilkërkuesit, nga punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesjes së fëmijës, publike apo private, si dhe nga vetë fëmijët.

**Raportimi.** Pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, çdo person fizik ose juridik, si dhe çdo punonjës i institucioneve publike e private, i cili vihet në kontakt me fëmijën, për shkak të profesionit, duhet të bëjë raportimin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës ose pranë organeve të Policisë së Shtetit.

Çdo mësues, ofrues i shërbimit psiko-social shkollor, publike apo private, pas identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, duhet të bëjë raportimin pranë ZVAP-së, drejtorit të institucionit arsimor, organeve të Policisë së Shtetit, strukturave për mbrojtjen e fëmijës.

Raportimi i fëmijës në nevojë për mbrojtje bëhet me çdo mjet komunikimi, me telefon, me e- mail, me postë, në formë shkresore, duke kontaktuar punonjësin e strukturave të Policisë së Shtetit apo të strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës.

**Vlerësimi fillestar** është një vlerësim i shpejtë i nivelit të rrezikut, bazuar në informacionin e disponueshëm nga identifikimi ose nga raportimi, si dhe informacionin që mund të merret nga institucionet, nga organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën.

Vlerësimi fillestar realizohet sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht brenda 24 orëve dhe, maksimalisht, brenda 48 orëve pas raportimit.

**Vlerësimi i plotë** bëhet nga PMF-ja për çdo rast të fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe ka si qëllim, të përcaktojë në mënyrë të plotë nivelin e rrezikut, në të cilin ndodhet nxënësi, si dhe të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e planit individual të mbrojtjes (PIM-it).

**Hartimi i planit individual të mbrojtjes (PIM).** Pas plotësimit të formularit të vlerësimit dhe të analizës së rrezikut, PMF-ja harton projekt planin individual të mbrojtjes, sipas formularit të PIM-it, dhe punonjësi i shërbimit psiko-social në shkollë është aktor në zbatimin e detyrave që i takojnë institucionit arsimor.

**Zbatimi, monitorimi dhe rishqyrtimi i PIM-it.** Çdo institucion, autoritet apo ofrues shërbimi, i përcaktuar në PIM, është përgjegjës për realizimin e aktiviteteve, të veprimeve, të ndërhyrjeve apo të ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në PIM, për fëmijën, për prindërit apo për anëtarët e familjes së tij.

Për detyrat e përcaktuara nga grupi teknik ndërsektorial, në PIM, punonjësit e shërbimi psiko-social shkollor kanë detyrim të monitorojnë ecurinë e fëmijës duke komunikuar rregullisht me mësuesit në shkollë, të ofrojnë mbështetje emocionale dhe të raportojë për ecurinë tek menaxheri i rastit (PMF) kur i kërkohet.

**Mbyllja e rastit.** Pas realizimit të të gjitha pikave të sipërpërmenduara, rasti konsiderohet i mbyllur.

### Ndërhyrjet në kontekstin shkollor

Në rast të situatave emergjente, që përfshijnë konflikte apo sjellje të dhunshme në shkollë, grupi i menaxhimit të emergjencave në shkollë (GME) ka rolin parësor, në menaxhimin e situatës.

**Dhuna mund të identifikohet/referohet nga:**

- Mësuesi
- Bashkëmoshatarët
- Punonjësi i SHPSSH-ës
- Prindi
- Oficeri i sigurisë
- Çdo aktor tjetër (individë të komunitetit pranë shkollës).

Punonjësi i SHPSSH-së ndjek këta hapa:

1- Identifikimi, vlerësimi dhe/ose referimi i rastit.
2- Vlerësimi i nivelit të rrezikut duke:

- Mbledhur informacionin nga:
  - Intervistat dhe takimet me mësues dhe me nxënës;
  - Intervistat me anëtarët e familjes;
  - Intervistat me fëmijën.
- Analizimi i informacionit (zbardhja e konfliktit dhe rolit të secilës palë të përfshirë në konflikt).

3- Përcaktimi i ndërhyrjes.

Punonjësi i SHPSSH-së ndërhyn kryesisht në dy mënyra, në varësi të detyrave të përcaktuara nga grupi teknik ndërsektorial (GTN):

A. ndërhyrje e drejtpërdrejtë.
B. ndërhyrje e tërthortë.

### A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë

*Ndërhyrje në nivel individual*

- Këshillim/konsultim individual i "viktimës**",** me qëllim fuqizimin e tij/saj.
- Takimi me prindër dhe përfshirja e tyre në ndërhyrje nëse nuk janë të përfshirë në sjelljen e dhunshme.
- Nxënësi mbështetet që të shprehë dhe të sqarojë faktet që lidhen me sjelljen e dhunshme.
- Administrohen instrumente dhe lista kontrolli për të vlerësuar natyrë dhe kohëzgjatjen e sjelljes së dhunshme.
- Nxënësit i jepet mbështetje për të shprehur zemërimin, dhimbjen, frikën dhe ndërsa tregon historinë e abuzimit, nëse ai/ajo dëshiron të shprehet.
- Nxënësi bën një listë të arsyeve  pse abuzuesi është i vetmi person përgjegjës për sjelljen e dhunshme. Nxënësi kujtohet se sjellja abusive është plotësisht përgjegjësia e abuzuesit dhe ai vetë nuk ishte as përgjegjës as fajtor për atë sjellje.
- Rishikoni me nxënësin talentet e tij/saj, aftësitë, arritjet dhe rëndësinë që ka për të tjerët për ta ndihmuar të përmirësojë vlerësimin për veten. Nxënësit i kërkohet të përpilojë një listë me pikat e tij të forta, cilësitë pozitive, arritjet dhe aftësitë.
- Nxënësi inkurajohet të marrë pjesë aktivisht në aktivitete ekstra kurrikulare, aktivitete në grup, aktivitete sociale, sportive dhe kulturore.

### B. Ndërhyrje e tërthortë

Ndërhyrje në nivel klase:

- Përfshirja e nxënësve të tjerë në njohjen dhe në zbatimin e procesit të ndërmjetësimit dhe të negocimit.
- Përforcimi i aftësive të komunikimit, të zgjidhjes së konflikteve etj.
- Seminare të ndryshme sensibilizuese dhe parandaluese në lidhje më dhunën.
- Stimulimi i sjelljeve pozitive dhe prosociale.
- Aktivitete socio-emocionale që lehtësojnë shprehjen e emocioneve dhe përballimin e emocioneve negative.

- Zbatimi i veprimtarive që nxisin aftësitë social-emocionale, në mënyrë që nxënësit të jenë më të aftë, për të shmangur konfliktet dhe t'i zgjidhin ato në mënyrë paqësore kur ndodhin.

Ndërhyrje në nivel shkolle:

- Zbatimi i planit të veprimit për parandalimin/trajtimin e dhunës në shkollë.
- Zbatimi i programeve të parandalimit/ndërgjegjësimit dhe të ndërhyrjeve, që përfshijnë bashkëpunimin mes prindërve, mësuesve, nxënësve dhe komunitetit, për të reduktuar sjelljet agresive të nxënësve.
- Trajnime me mësues mbi identifikimin e nxënësve të dhunuar dhe raportimin.
- Anketime me qëllim vlerësimin e sjelljeve të dhunshme në shkollë, mbledhjen e informacionit për vlerësimin e nevojave të sigurisë, të dhunës dhe të krizave në nivel shkolle, planifikimin e ndërhyrjeve dhe monitorimin në vijimësi.

**Referimi**

Në rastet kur shërbimi psiko-social identifikon dhe vlerëson se ekziston një nivel rreziku, kryen referimin pranë NJSHPS-së, NJMF-së, sipas formatit tip për referim pranë PMF-ës.

Për të gjitha rastet e dhunës të identifikuara dhe trajtuara nga shërbimi psiko-social shkollor, punonjësi plotëson instrumentin për raportimin individual të dhunës dhe instrumentin për raportimin vjetor të dhunës për të përmbledhur të gjitha rastet e dhunës në fund të vitit shkollor.

**Modeli 25. Instrumenti për raportimin individual të dhunës nga institucionet e arsimit parauniversitar**

# Instrumenti për raportimin individual të dhunës nga institucionet e arsimit parauniversitar

| DRAP: | | ZVAP: | |
|---|---|---|---|

| Shkolla: | | Lloji i shkollës: | ☐ Publik<br>☐ Privat |
|---|---|---|---|

| Data e dhunës | ____/_____/_______ |
|---|---|

**Zona e shkollës:** ☐ Rurale ☐ Urbane

**Lloji i shkollës:** ☐ Arsim fillor ☐ Arsim Bazë ☐ Arsim i Mesëm i Ulët ☐ Arsim i Mesëm i Lartë[1]

| Personi i cili raportoi/konstatoi dhunën: | X |
|---|---|
| Vet nxënësi | |
| Punonjësi i shërbimit psiko-social | |
| Oficeri i sigurisë | |
| Punonjësit arsimor (mësuesit) | |
| Stafi drejtues | |
| Nxënës (dëshmitar) | |
| Prindër/familjar | |
| Roja/sanitarja | |
| Tjetër | |

| Lloji i dhunës: | X |
|---|---|
| Kërcënim/shantazh/përndjekje | |
| Ekstremizëm i dhunshëm | |
| Dhunë fizike | |

[1] Gjimnazet, shkollë e mesme e bashkuar, shkollat me drejtim të orientuar, shkollat profesionale.

| | |
|---|---|
| Dhunë psikologjike/verbale | |
| Dhunë seksuale | |
| Bulling (ngacmim/fyerje/tallje) | |
| Diskriminim/racizëm | |
| Vetëvrasje/Tentativë vetëvrasje | |
| Krimet e internetit | |
| Neglizhim | |
| Tjetër | |

| **Personi që shkaktoi dhunën:** | **X** |
|---|---|
| Nxënës | |
| Punonjësi i shërbimit psiko-social | |
| Oficeri i sigurisë | |
| Punonjësit arsimor (mësuesit) | |
| Stafi drejtues | |
| Prindër/familjarë | |
| Roja/sanitarja | |
| Të huaj/komuniteti | |
| Tjetër | |

| **Gjinia e personit që shkaktoi dhunën:** | **X** |
|---|---|
| Femër | |
| Mashkull | |

| **Personi ndaj të cilit u shkaktua dhuna:** | **X** |
|---|---|
| Nxënës | |
| Punonjësi i shërbimit psiko-social | |
| Oficeri i sigurisë | |
| Punonjësit arsimor (mësuesit) | |
| Stafi drejtues | |
| Prindër/familjarë | |
| Roja/sanitarja | |
| Të huaj/komuniteti | |

| | |
|---|---|
| Tjetër | |

| **Gjinia e ndaj të cilit u shkaktua dhuna:** | **X** |
|---|---|
| Femër | |
| Mashkull | |

| **Mjedisi ku ndodhi dhuna:** | **X** |
|---|---|
| Ambientet sportive | |
| Korridor | |
| Në klasë me mësuesin/punonjësin arsimor | |
| Në klasë pa mësuesin/punonjësin arsimor | |
| Tualet | |
| Duke ardhur në shkollë | |
| Mensë | |
| Jashtë ambienteve të shkollës | |
| Oborrin e shkollës | |
| Autobusin e shkollës | |
| Familje | |
| Tjetër | |

| **Njoftimi i personave/strukturave përgjegjëse:** | **X** |
|---|---|
| Njoftimi i prindërve | |
| Njoftimi i policisë | |
| Njoftimi i ambulancës/urgjencës | |
| Njoftimi i zjarrfikëses | |

| **Referimi i rastit:** | **X** |
|---|---|
| Shërbimi psiko-social shkollor | |
| Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës | |

| | |
|---|---|
| Struktura të tjera | |

| **Hapat e ndërmarra:** | **X** |
|---|---|
| Plan ndërhyrje individual nga shërbimi psik-social shkollor | |
| Hartimi i planit të ndërhyrjes në nivel klase | |
| Hartimi i planit të ndërhyrjes në nivel shkolle | |
| Ngritja e grupit teknik ndërsektorial në nivel lokal | |
| Trajtim në struktura të tjera të specializuara | |

**Modeli 26. Instrumenti për raportimin vjetor të dhunës nga institucionet e arsimit parauniversitar**

# Instrumenti për raportimin vjetor të dhunës nga institucionet e arsimit parauniversitar

| **DRAP:** | | **ZVAP:** | |
|---|---|---|---|

| **Shkolla:** | | **Lloji i shkollës:** | ☐ Publik<br>☐ Privat |
|---|---|---|---|

| **Raste dhune total për vitin shkollor 20..-20..:** | |
|---|---|

**Zona e shkollës:** ☐ Rurale ☐ Urbane

**Lloji i shkollës:** ☐ Arsim fillor ☐ Arsim Bazë ☐ Arsim i Mesëm i Ulët ☐ Arsim i Mesëm i Lartë[2]

| **Personi i cili raportoi/konstatoi dhunën:** *(Shkruani numrin e rasteve të dhunës të raportuara/konstatuara nga secili nga personat e mëposhtëm)* | **Nr. i rasteve** |
|---|---|
| Vet nxënësi | |
| Punonjësi i shërbimit psiko-social | |
| Oficeri i sigurisë | |
| Punonjësit arsimor (mësuesit) | |
| Stafi drejtues | |
| Nxënës (dëshmitar) | |
| Prindër/familjar | |
| Roja/sanitarja | |
| Tjetër | |

[2] Gjimnazet, shkollë e mesme e bashkuar, shkollat me drejtim të orientuar, shkollat profesionale.

**Llojet e dhunës:**

| *(Shkruani numrin e rasteve të dhunës sipas llojit të tyre)* | **Nr. i rasteve** |
|---|---|
| Kërcënim/shantazh/përndjekje | |
| Ekstremizëm i dhunshëm | |
| Dhunë fizike | |
| Dhunë psikologjike/verbale | |
| Dhunë seksuale | |
| Bulling (ngacmim/fyerje/tallje) | |
| Diskriminim/racizëm | |
| Vetëvrasje/Tentativë vetëvrasje | |
| Krimet e internetit | |
| Neglizhim | |
| Tjetër | |

**Personi që shkaktoi dhunën:**

| *(Shkruani numrin e rasteve të dhunës të shkaktuara nga secili nga personat e mëposhtëm)* | **Nr. i rasteve** |
|---|---|
| Nxënës | |
| Punonjësi i shërbimit psiko-social | |
| Oficeri i sigurisë | |
| Punonjësit arsimor (mësuesit) | |
| Stafi drejtues | |
| Prindër/familjarë | |
| Roja/sanitarja | |
| Të huaj/komuniteti | |
| Tjetër | |

**Gjinia e personit që shkaktoi dhunën:**

| *(Shkruani numrin e rasteve të dhunës të shkaktuara nga secili nga personat e mëposhtëm)* | **Nr. i rasteve** |
|---|---|
| Femër | |
| Mashkull | |

**Personi ndaj të cilit u shkaktua dhuna:**

| *(Shkruani numrin e rasteve të dhunës të shkaktuara për secilin nga personat e mëposhtëm)* | **Nr. i rasteve** |
|---|---|
| Nxënës | |
| Punonjësi i shërbimit psiko-social | |
| Oficeri i sigurisë | |
| Punonjësit arsimor (mësuesit) | |
| Stafi drejtues | |
| Prindër/familjarë | |
| Roja/sanitarja | |
| Të huaj/komuniteti | |
| Tjetër | |

**Gjinia e personit ndaj të cilit u shkaktua dhuna:**

| *(Shkruani numrin e rasteve të dhunës të shkaktuara nga secili nga personat e mëposhtëm)* | **Nr. i rasteve** |
|---|---|
| Femër | |
| Mashkull | |

**Mjedisi ku ndodhi dhuna:**

| *(Shkruani numrin e rasteve të dhunës të shkaktuara për secilin nga mjediset e mëposhtme)* | **Nr. i rasteve** |
|---|---|
| Ambientet sportive | |

| | |
|---|---|
| Korridor | |
| Në klasë me mësuesin/punonjësin arsimor | |
| Në klasë pa mësuesin/punonjësin arsimor | |
| Tualet | |
| Duke ardhur në shkollë | |
| Mensë | |
| Jashtë ambienteve të shkollës | |
| Oborrin e shkollës | |
| Autobusin e shkollës | |
| Familje | |
| Tjetër | |

**Njoftimi i personave/strukturave përgjegjëse:**

| *(Shkruani numrin e rasteve të dhunës që janë njoftuar secila nga personat/strukturat përgjegjëse të mëposhtme)* | **Nr. i rasteve** |
|---|---|
| Njoftimi i prindërve | |
| Njoftimi i policisë | |
| Njoftimi i ambulancës/urgjencës | |
| Njoftimi i zjarrfikëses | |

**Referimi i rastit:**

| *(Shkruani numrin e rasteve të dhunës që janë referuar për secilën nga strukturat e mëposhtme)* | **Nr. i rasteve** |
|---|---|
| Shërbimi psiko-social shkollor | |
| Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës | |
| Struktura të tjera | |

**Hapat e ndërmarra:**

| *(Shkruani numrin e rasteve të dhunës që janë ndërmarrë hapat e mëposhtme)* | **Nr. i rasteve** |
|---|---|
| Plan ndërhyrje individual nga shërbimi psik-social shkollor | |

| | |
|---|---|
| Hartimi i planit të ndërhyrjes në nivel klase | |
| Hartimi i planit të ndërhyrjes në nivel shkolle | |
| Ngritja e grupit teknik ndërsektorial në nivel lokal | |
| Trajtim në struktura të tjera të specializuara | |

# Planifikimi i ndërhyrjes për rastet e bullizmit në shkollë

Bullizmi është një keqpërdorim i vazhdueshëm dhe i qëllimshëm i pushtetit **ndërmjet të barabartëve**, përmes sjelljeve të përsëritura verbale, fizike dhe/ose sociale, që synojnë të shkaktojnë dëm fizik, social dhe/ose psikologjik. Mund të përfshijë një individ ose një grup që keqpërdor pushtetin e tij ose pushtetin e perceptuar, mbi një ose më shumë persona, që ndihen të paaftë për ta ndaluar atë që ndodhë.

Ngacmimi mund të ndodhë personalisht ose në internet, nëpërmjet platformave dhe pajisjeve të ndryshme digjitale dhe mund të jetë i dukshëm (i hapur) ose i fshehur. Sjellja ngacmuese përsëritet ose ka potencialin të përsëritet, me kalimin e kohës (për shembull, përmes ndarjes së të dhënave digjitale).

Ngacmimi i çdo forme ose për çfarëdo arsye, mund të ketë efekte të menjëhershme, afatmesme dhe afatgjata te personat e përfshirë, përfshirë vëzhguesit.

**Incidentet e vetme dhe konfliktet apo zënkat ndërmjet të barabartëve, qoftë personalisht apo online, nuk përkufizohen si raste bullizmi.**

Çfarë nuk është bullizëm?

- Episode të rralla të refuzimit ose të mospëlqimit social;
- Një episod i sjelljeve ngacmuese;
- Akte të rastësishme agresioni ose frikësimi;
- Debate reciproke, mosmarrëveshje ose grindje.

Veprimet e mësipërme mund të shkaktojnë shqetësime të mëdha, sidoqoftë nuk i përshtaten përkufizimit të bullizmit dhe nuk janë shembuj të tij, përveçse dikush i bën ato qëllimisht dhe në mënyrë të përsëritur.

Format e bullizmit

**Bullizmi fizik** merr formën e abuzimit fizik (grushta, shkelma, goditje të formave të ndryshme, shtyrje, vjedhje, shkatërrim i sendeve etj.).

**Bullizmi verbal** ka si qëllim degradimin i viktimës, duke përdorur teknika të përjashtimit social, ofendime, sharje, kërcënime, për të treguar epërsinë dhe pushtetin e tyre.

**Bullizmi kibernetik** (ose bullizmi në rrjete sociale) është një formë e padukshme për mësuesit, pasi ndodh në sferën e mbyllur të teknologjisë moderne: rrjetet sociale, postat elektronike dhe mesazhet me tekst. Kjo formë përfshin vërejtje ofenduese, kërcënime, publikimin e fotove apo videove të padëshiruara, mesazhe të pakëndshme, hyrjen në mënyrë të paligjshme në llogari, vjedhjen e identiteteve, nxjerrjen e sekreteve, publikimin e materialeve private, bullizëm, provokimin e sjelljeve të caktuara që më tej dokumentohen dhe shpërndahen. Bullizmi kibernetik ka të bëjë pikërisht, me të përfolurit rreth dikujt, duke përdorur këtu shpifjet apo përhapjen e thashethemeve të pavërteta, nëpërmjet mesazheve, e-maileve apo postimeve, publikimi i fotove personale pa autorizim në faqet e internetit.

**Karakteristikat e bullizuesit**

- Ngacmon verbalisht ose fizikisht të tjerët, duke i bërë ata të raportojnë incidente tek të rriturit;
- Angazhohet në aktivitete ngacmimi të vazhdueshme, frikësimi apo kërcënimi.
- Shfaq zemërim të fortë;
- Dhunë fizike;
- Humbet shpesh durimin;
- Nervozizëm ekstrem;
- Impulsivitet ekstrem;
- Frustrohet lehtësisht;
- Lëndon ose ndërvepron me forcë me të tjerët gjatë lojës, pushimit ose kohës së lirë;
- Nxit dhe përfshihet në konflikte, në debate dhe në grindje të shpeshta;
- Nuk ka ndjenja faji, empati, pendim ose nuk shqetësohet për sigurinë dhe për mirëqenien e të tjerëve;

- Shfaq agresivitet, duke nxitur thashetheme dhe duke i nxitur bashkëmoshatarët kundër njëri-tjetrit, duke fajësuar të tjerët, duke i kthyer grupet e bashkëmoshatarëve kundër një individi etj.
- Shfaq gjuhë kërcënuese të trupit;
- Nuk shfaq pendesë ndaj thyerjes së rregullave, të disiplinës ose ndaj autoritetit;
- Përfshihet në zënka dhe në konflikte të shpeshta në lagje;
- Duket se i pëlqen dhe dëshiron të përfshihet në grindje dhe në konflikte.

**Viktima mund të manifestojë**

- Dhimbje koke;
- Dhimbje barku;
- Të përziera;
- Mund të jetë në ankth;
- Mund të mos ketë dëshirë apo heziton të shkojë në shkollë;
- Rënie nga mësimet;
- Mund të shfaqë mungesë besimi te vetja dhe tek të tjerët;
- Ndjenja frike dhe pasigurie;
- Shenja dhune fizike;
- Gënjen;
- Vjedh sende, si p.sh., para në shtëpi;
- Mund të humbasë lidhje/kontakte me shokët dhe të ndihet i shkëputur dhe i izoluar.

Rasti i bullizmit kibernetik, për shkak të specifikës që ky bullizëm paraqet, është trajtuar si rast më vete, duke ndjekur këta hapa:

- Vihet në dijeni drejtori i shkollës, mësuesit kujdestarë;
- Vlerësohet niveli i rrezikut;
- Këshillon fëmijën e përfshirë në bullizëm;
- Konsultohet me të gjithë aktorët që mund të kenë informacion rreth situatës;
- Zhvillon takim individual me prindërit e fëmijëve përkatës;
- Referon dhe bashkëpunon me shërbime jashtë shkolle (policia);
- Vihet në dijeni njësia e shërbimit psiko-social pranë ZVAP-së.

Duhet bashkëpunim i ngushtë me aktorët e shkollës (drejtori, mësues, prindër, komunitet, organizata, me fokus interesin më të lartë të fëmijëve), pasi nuk mund të veprojmë të vetëm ndaj këtij fenomeni. Në varësi të situatës kërkohet ndihma e strukturave të policisë.

# Ndërhyrja në kontekstin shkollor

**Bullizmi mund të identifikohet/referohet nga:**

- Mësuesi/ drejtuesi
- Bashkëmoshatarët
- Punonjësi i SHPSSH-ës
- Oficeri i sigurisë
- Prindi
- Çdo aktor tjetër (individë të komunitetit pranë shkollës).

Punonjësi i SHPSSH-së, mbështetur në planin vjetor, dhe në planin strategjik në luftën kundër bullizmit në shkollë, ndjek këta hapa:

**<u>Parandalon</u>**

Punonjësi i SHPSSH-ës parandalon, duke:

- Realizuar seminare informuese/ndërgjegjësuese me nxënës, me prindër, me mësues;
- Realizuar veprimtari me natyrë social-emocionale për promovimin e sjelljeve prosociale me nxënës;
- Realizuar sesione informuese me stafin pedagogjik, me qëllim identifikimin e rasteve me bullizëm;
- Zhvilluar pyetesorë dhe anketime me nxënës të grupmoshave të ndryshme, për identifikimin e rasteve me bullizëm;
- Krijuar grupe mbështetëse (p.sh., me senatorët e klasave ose me nxënës me aftësi të zhvilluara sociale), me qëllim identifikimin, menaxhimin dhe referimin e rasteve pranë SHPSSH-së dhe mësuesve;
- Realizuar këshillim në grup me nxënës të përfshirë në konflikte, të trajtuar nga organet kolegjiale me masa displinore me qëllim nxitjen e

zgjidhjeve paqësore të konflikteve, përmirësimin e aftësive të komunikimit, etj;
- Zhvilluar aktivitete në nivel shkolle, me qëllim informimin/ndërgjegjësimin e gjithë komunitetit, për rëndësinëe luftës kundër bullizmit.

**<u>Vlerëson</u>**

Punonjësi i SHPSH-ës merr kohën e nevojshme, për të vlerësuar situatën. Realizon fokus grupe, pyetësorë, intervistime dhe vëzhgime në ambientet e klasës dhe të shkollës.

***Vlerësohen këto elemente:***

- Siguria e fëmijës së bullizuar;
- Përcaktimi i shpeshtësisë dhe i formës/formave së/të bullizmit;
- Nevojat parësorë të fëmijës viktimë (emocionale, fizike, sociale);
- Nevojat parësorë të fëmijës agresor (emocionale, fizike, sociale);
- Klima e grupit/klasës.

**<u>Ndërhyn</u>**

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërhyn në dy mënyra:

A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë.
B. Ndërhyrje e tërthortë.

**A.Ndërhyrje e drejtpërdrejtë**

<u>Ndërhyrje në nivel individual</u>

Këshillim/konsultim individual i viktimës, me qëllim fuqizimin e tij/saj, duke:

- Rritur vetëvlerësimin dhe vetëbesimin e fëmijës.
- Përmirësuar pavarësinë e fëmijës.
- I mësuar fëmijës teknika të reja për zgjidhjen e problemeve.
- Modeluar sjelljen mbrojtëse.
- Ndihmuar fëmijën të jetë më i sigurt.
- I mësuar vetëmenaxhimin: aftësia për të rregulluar emocionet dhe veprimet.

- Ndihmuar në reduktimin e mendimeve negative.
- Ndihmuar në rritjen e motivimit, për të kërkuar ndihmë në rast nevoje.
- Përfshirë prindërit në ndërhyrje.
- Nxënësi mbështetet që të shprehë dhe të sqarojë faktet që lidhen me sjelljen e dhunshme.
- Administrohen instrumente dhe lista kontrolli për të vlerësuar natyrë dhe kohëzgjatjen e sjelljes së dhunshme.
- Nxënësit i jepet mbështetje për të shprehur zemërimin, dhimbjen dhe frikën, ndërsa tregon historinë e ngacmimit, nëse nxënësi dëshiron të shprehet.
- Nxënësit i kërkohet të japë një listë me arsye pse pësoi bullizëm nga një moshatar. Sa herë që nxënësi nxjerr justifikime për sjelljen e ngacmuesit, i kujtohet që nuk e meritonte një sjellje të tillë.
- Nxënësi bën një listë të arsyeve pse ngacmuesi është i vetmi person përgjegjës për sjelljen e dhunshme. Nxënësi kujtohet se sjellja ngacmuese është plotësisht përgjegjësia e ngacmuesit dhe ai vetë nuk ishte as përgjegjës as fajtor për atë sjellje.
- Rishikoni me nxënësin talentet e tij/saj, aftësitë, arritjet dhe rëndësinë që ka për të tjerët, për ta ndihmuar të përmirësojë vlerësimin për veten. Nxënësit i kërkohet të përpilojë një listë me pikat e tij të forta, cilësitë positive, arritjet dhe aftësitë.
- Nxënësi inkurajohet të marrë pjesë aktivisht në aktivitete ekstra kurrikulare, aktivitete në grup, aktivitete sociale, sportive dhe kulturore.

Këshillim/konsultim individual i ngacmuesit, me qëllim ndërgjegjësimine tij/saj:

- Administroni instrumente psikologjike për të vlerësuar sjelljet ngacmuese.
- Caktojini nxënësit si detyrë të mbajnë një ditar ku të shënojnë cdo situatë që i krijon zemërim dhe mendimet që i krijon ajo situatë.
- Vlerësoni situatat, njerëzit dhe mendimet që nxisin mendimet dhe ndjenjat e zemërimit dhe veprimet me të cilat përgjigjet kur është i zemëruar.
- Eksploroni problemet familjare apo personale që po kalon nxënësi dhe burimet e tjera të stresit që mund të kenë ndikuar tek sjellja bullizuese.
- Nxënësi liston mënyra se si sjellja e dhunshme ka ndikuar për keq tek marrëdhëniet me moshatarët, me të rriturit dhe në marrëdhënie të tjera.

- Nxënësit i mësohen teknika relaksimi si frymëmarrja e thellë, relaksimi progresiv i muskujve dhe imagjinata e drejtuar.
- Nxënësit i mësohen sjellje prosociale.
- Mësojeni nxënësin të ketë empati për viktimat e sjelljeve të tij ngacmuese. Nxënësi përfshihet në luajtje roli në të cilin vetë nxënësi luan rolin e viktimës dhe vihet të në vendin e tij.

### C. Ndërhyrje e tërthortë

Ndërhyrje/ aktivitete në nivel klase:

- Vlerësimi i ndjenjave dhe i mendimeve që kanë nxënësit e tjerë ndaj viktimës.
- Vlerësimi i ndjenjave dhe i mendimeve që kanë nxënësit e tjerë ndaj ngacmuesit.
- Vlerësimi sesi nxënësit e tjerë reagojnë ndaj situatave bullizuese.
- Përfshirja e nxënësve të tjerë në teknika menaxhuese.
- Përmirësimi aftësive sociale: komunikimi, këmbëngulja, zgjidhja e konflikteve dhe zgjidhja e problemeve.
- Vendimmarrja e përgjegjshme: aftësia për të bërë zgjedhje konstruktive dhe të respektueshme, në lidhje me sjelljen personale dhe me ndërveprimet sociale.
- Aktivitete parandaluese mbi temat e bullizmit, zhvillimin e aftësive komunikuese dhe mënyrat se si nxënësit mund të mbrohen nëse janë viktimë e bullizmit.

Ndërhyrje në nivel shkolle:

- Përfshirja e nxënësit të bullizuar/agresorit në aktivitete të përshtatshme për ta.
- Përfshirja e agresorit në aktivitete me natyrë edukative (pastrimi i mjediseve të përbashkëta, mbjedhja e pemëve apo luleve, përgatitja dhe prezantimi i temave të ndryshme sociale etj.).
- Aktivitete masive në bazë shkolle mbi temat e parandalimit të bullizmit, të drejtat e fëmijëve dhe parandalimi i sjelljeve të dhunshme.

# Planifikimi i ndërhyrjes dhe menaxhimi i konflikteve në shkollë

Konfliktet në shkollë përkufizohen si mosmarrëveshje ndërmjet individëve ose grupeve, në lidhje me idetë, interesat, parimet dhe me vlerat brenda komunitetit të shkollës.

Konflikti mund të përkufizohet, si një situatë faktike në të cilën elemente që duken të papajtueshme, ushtrojnë forcë në drejtime të kundërta ose divergjente.

Zgjedhja midis strategjive të ndryshme të menaxhimit të konfliktit, varet nga niveli i konfliktit dhe nga situatat e ndryshme që duhet të menaxhohen në mënyrë efektive. Për të menaxhuar konfliktin në mënyrë funksionale, është e rëndësishme të pranohet, se një strategji mund të jetë shumë më e përshtatshme se një tjetër, në varësi të situatës dhe të natyrës së konfliktit.

***Në kontekstin shkollor, ndeshemi kryesisht me 2 lloje konfliktesh:***

- Të fshehura;
- Të dukshme.

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërmerr këta hapa:

**<u>Parandalon</u>**

Punonjësi i SHPSSH-së parandalon, duke:

- Realizuar takime informuese/ndërgjegjësuese me nxënës, prindër, mësues, për teknikat efektive të parandalimit dhe të menaxhimit të konflikteve në klasë/shkollë;
- Realizuar aktivitete me natyrë social-emocionale për të rritur aftësitë saociale, zhvilluar empatinë, menaxhuar zemërimin, marrjen e përgjegjësive, etj
- Krijuar dhe aftësuar grupe në nivel klasë, me qëllim parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve;
- Trajnuar stafin pedagogjik, me qëllim identifikimin e situatave, që mund të çojnë në konflikte më të rënda;

- Zhvilluar pyetësorë dhe anketime me nxënës të grupmoshave të ndryshme, për identifikimin e konflikteve të fshehura në klasë/shkollë;
- Krijuar grupe mbështetëse (p.sh., me senatorët e klasave ose me nxënës me aftësi të mira sociale), me qëllim identifikimin, menaxhimin dhe referimin e rasteve pranë SHPSSH-së dhe mësuesve;
- Vëzhguar klimën në klasë. Nxënësit duhet të mësohen të respektojnë dhe të vlerësojnë ndryshimet ndërmjet njerëzve, të kuptojnë paragjykimin, shkaqet dhe mënyrat e shfaqjes. Një klasë jotolerante, ku sundojnë ngacmimet e vazhdueshme, formimi i grupeve, intoleranca ndaj dallimeve raciale, kulturore etj., mospërkrahja e shokëve të klasës që të çon në vetmi dhe në izolim, zemërimi për arritjet e të tjerëve, krijojnë terren për armiqësi, për mosbesim dhe për konflikte.

**Konfliktet mund të identifikohen/referohen/menaxhohen nga:**

- Mësuesi/Stafi drejtues
- Punonjësi i SHPSSH-së
- Prindi
- Bashkëmoshatarët
- Çdo aktor tjetër brenda shkollës apo individë të komunitetit pranë shkollës
- Specialisti i policisë së zonës (SPZ)
- Oficeri i sigurisë

**<u>Vlerëson</u>**

Punonjësi i SHPSH-së merr kohën e nevojshme, për të vlerësuar situatën, duke:

- Intervistuar palët në konflikt;
- Konsultuar/takuar prindërit për informimin e gjendjes dhe ecurinë e fëmijës në familje;
- Takuar mësuesit kujdestarëdhe lëndorë për qëndrimin dhe për gjendjen e fëmijës në klasë;
- Plotësuar listat e kontrollit për reagimin ndaj konfliktit (shtojca 6);
- Dokumentuar konfliktin dhe hapat për menaxhim (mban procesverbal ose një relacion mbi menaxhimin e konfliktit si më poshtë).

**Modeli 27. Relacion mbi menaxhimin e konfliktit**

Datë___/_____/_______

Personi që identifikon konfliktin ____________________________

Personat e përfshirë në konflikt ( inicialet e personave të përfshirë, klasa, pozicioni):

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

Përshkrimi i situatës në të cilën është krijuar konflikti ( burimi, shkaqet, vendi, ora, persona të tjerë të pranishëm)

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

Përshkrimi i gjendjes së personave të përfshirë në konflikt: ( qëndrimi, shprehitë joverbale, verbalizimi i emocioneve etj)

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

Veprimet e menjëhershme të ndërmarra për menaxhimin e konfliktit:

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

Forma e raportimit të konfliktit tek persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, drejtori ose institucione jashtë IA-së (fizikisht, në mënyrë elektronike):

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

Rezultati i ndërhyrjes:

_______________________________________________________________________

_______________________________________________________________________

_______________________________________________________________________

_______________________________________________________________________

_______________________________________________________________________

Veprimet në vazhdimësi si një formë parandalimi në të ardhmen (*strategji parandalimi në të ardhmen*):

_______________________________________________________________________

_______________________________________________________________________

_______________________________________________________________________

_______________________________________________________________________

Persona të pranishëm në menaxhimin e konfliktit: ( emër mbiemër, nënshkrimi)

**Ndërhyn**

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërhyn në dy mënyra:

C. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë.
D. Ndërhyrje e tërthortë.

**C. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë**

*Ndërhyrje në nivel individual:*

- Këshillimi/konsultimi individual i fëmijës.
- Hartimi i planit të ndërhyrjes, në bashkëpunim me prindin dhe me mësuesin kujdestar të nxënësit, nëse është e nevojshme.
- Përdorimi i teknikave menaxhuese, me qëllim nxitjen e shprehjeve pozitive të emocioneve. Nxënësit duhet të mësojnë të kontrollojnë veten, kur shprehin ndjenjat, të mos jenë agresivë dhe shkatërrues, veçanërisht, në rastet kur shprehin zemërimin dhe shqetësimin e tyre. Çdo konflikt ka komponentin e vetë emocional. Kur nxënësit nuk i respektohen ndjenjat, ata nuk dinë rrugë të tjera për të shprehur zemërimin, përveç atyre agresive, i

shtypen emocionet, nuk i edukohet vetëkontrolli etj., atëherë kemi shtuar mundësitë për rritjen e konflikteve në klasë.

- Psiko-edukimi me prindërit e fëmijës/personat përgjegjës.
- Nxënësit i mësohen aftësi bindëse komunikimi përmes udhëzimit, modelimit dhe luajtjes së roleve.
- Nxënësi mëson teknika të komunikimit dhe zgjidhjes së konfliktit, kultivimin e empatisë, "mesazhet me unë", komunikimin e respektueshëm, aftësitë bindëse pa u treguar agresiv dhe bërjen e kompromisit.
- Mësojini prindërit të përcaktojnë rregulla të përshtatshme për moshën për sjelljen e përshtatshme dhe të papërshtatshme, të nxisin sjelljen pozitive dhe të përdorin lavdërimin për të inkurajuar sjelljet pozitive, të japin udhëzime të qarta me qetësi, të japin ndëshkime të përshtatshme dhe heqjen e disa privilegjeve në rastet kur nxënësi përfshihet në konflikte.
- Nxënësi nxitet të përfshihet në disa aktivitete altruiste gjatë javës për të përmirësuar empatinë dhe ndjeshmërinë ndaj ndjenjave dhe nevojave të të tjerëve.
- Kërkojini nxënësit të bëjë një listë të mënyrave në të cilat sjellja e tij konfliktuale ka ndikuar për keq tek jeta e tij dhe tek familja, miqtë, marrëdhëniet me të tjerët. Nxiteni të bëjë plane për të kompensuar për këto pasoja.
- Analizoni problemet fizike, familjare, shkollore, psikologjike apo burimet e stresit që ndikojnë të sjellja konfliktuale.
- Caktojini nxënësit të bëjë një listë me 10 arsye për të hequr dorë nga sjelljet konfliktuale dhe zemërimi dhe të identifikojë mënyra si mund të gëzojnë respektin e të tjerëve duke u treguar të sjellshëm, paqësorë dhe të besueshëm.
- Mësojini ndërgjegjësimin social, aftësinë për të kuptuar këndvështrime të ndryshme, të ketë ndjeshmëri dhe të kuptojë normat shoqërore.
- Ndërgjegjësojeni nxënësin për ndjenjat, për mendimet, për pikat e forta dhe për kufizimet e dikujt.
- Vlerëso shprehjet e zemërimit në familje. Ndihmojeni nxënësin të dallojë si këto mënyra sjelljeje kanë ndikuar tek ai/ajo.

**Ndërhyrje në nivel klase**

- Synohet nxitja e klimës prosociale në klasë, duke realizuar aktivitete të ndryshme edukuese. Nëse gjatë menaxhimit të rastit, identifikohen edhe

problematika të tjera, si: sjellje kundërshtuese, problematika të shëndetit mendor që bashkëshoqërojnë sjelljen, PSHPSSH-ja referon për shërbime të shëndetit mendor, për një vlerësim më të specializuar.

- Nëse ndërhyrja është emergjente, për shkak të intensitetit të konfliktit dhe të sigurisë së ulët të fëmijëve dhe të rriturve në mjedisin e shkollës, PSHPSSH-ja referon në drejtorinë e shkollës, nevojën për ndërhyrje nga organet vendore të Policisë së Shtetit.
- Gjithëpërfshirja e palëve në aktivitete që nxisin altruizmin, bashkëpunimin, komunikimin e suksesshëm, empatinë etj.
- Angazhimi i palëve në sesione informuese, aktivitete apo veprimtari të SHPS-ës, me qëllim stabilizimin dhe përmirësimin e marrëdhënies ndërmjet tyre, duke shërbyer si shembull për nxënësit e tjerë.

# Planifikimi i ndërhyrjes për situatat e emergjencës

Punonjësit e SHPSSH-ës duhet të jenë të përgatitur për të ofruar ndihmën e parë psikologjike, për personat të cilët kanë përjetuar një situatë emergjence. Qëllimi i këtyre ndërhyrjeve është ofrimi i mbështetjes në një mënyrë që respekton dinjitetin, kulturën dhe aftësitë e tyre, për t'u përballur me situata të tilla. Pavarësisht pozicionit që ka punonjësi, ndihma e parë psikologjike është e predispozuar t'i përfshijë të dyja, mbështetjen sociale dhe atë psikologjike.

**Fëmijët dhe siguria nga rreziqe të fatkeqësive natyrore dhe të emergjencave**

Fëmijët shpenzojnë shumë kohë në shkollë. Është shumë i rëndësishëm angazhimi i nxënësve të të gjitha grupmoshave, për të mësuar dhe për të marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme, në veprimtaritë e shkollës, me qëllim reduktimin e rreziqeve të fatkeqësive natyrore dhe civile, në bashkëpunim me mësuesit dhe me anëtarë të tjerë të komunitetit.

**Çfarë ndodh nëse një emergjencë natyrore ose civile përjetohet, ndërkohë që nxënësit dhe mësuesit janë në klasë?**

Ka shumë mundësi që nxënësit t'i drejtohen mësuesit, duke e vështruar atë, si "i rrituri" që di gjithçka. Ata mund të presin që mësuesi t'u tregojë: "Çfarë po ndodh", "Çfarë të bëjnë", t'i ndihmojë ata të jenë të sigurtë dhe kështu me radhë. Në rast se mësuesi është shumë i qartë, për mënyrën si ai duhet të veprojë në një situatë emergjence, është shumë sfiduese përgjegjësia që ai ka për një klasë të tërë, në një kohë që gjithçka ndodh kaq shpejt, duke qenë se vendimet dhe veprimet duhet të ndërmerren brenda pak sekondave.

Në mënyrë që shkolla të edukojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të aftësojë nxënësit dhe stafin e saj, për menaxhimin e emergjencave natyrore dhe civile, një ndër përvojat e para që të gjithë aktorëve të saj u nevojiten, është të kuptuarit e përbashkët të koncepteve themelore dhe të terminologjisë për emergjencat natyrore dhe civile, për menaxhimin e tyre dhe për sigurinë në shkollë.

**Fatkeqësia** është ngjarje, pasojat e së cilës janë shkaktuar nga forca natyrore të pakontrolluara ose nga arsye të tjera,tëcilat kërcënojnë ose dëmtojnë jetën dhe

shëndetin e popullatës, gjënë e gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë të tillë, që kërkojnë marrjen e masave të veçanta dhe përdorimin e burimeve të veçanta njerëzore, materiale-teknike.

**Fatkeqësitë natyrore** përfshijnë tërmetet, përmbytjet, thatësira të tejzgjatura, rrëshqitje tëdherave, ortekët, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjedise të banuara, pandemitë ose epidemitë, pasojat e të cilave prekin popullatën, gjënë e gjallë, pronën,mjedisin, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore.

**Rreziku** është gjendje serioze, reale dhe e menjëhershme, që kanos jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën publike, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, që mund të shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësi të tjera.

**Emergjencë civile** është një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, nga veprime terroriste, nga veprime ushtarake (në gjendje lufte), tëcilat sjellin dëme të menjëhershme dhe të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë,përpasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.

Familjet dhe komunitetet presin që shkollat t'i mbajnë fëmijët e tyre të sigurt, nga një sërë ngjarjesh emergjente, si krimi, fatkeqësitë natyrore dhe aksidentet. Emergjencat mund të ndodhin në çdo kohë dhe planifikimi për emergjenca të ndryshme, mund të jetë sfidues për shkollat. Një komponent kyç, i planifikimit të emergjencës, është krijimi i një plani veprimi të emergjencave, ose të një plani veprimi për sigurinë në shkolla. Nuk ka rëndësi emërtimi, mjafton të jetë një dokument që përshkruan se si një shkollë do të përgatitet, do të përgjigjet dhe do të rimëkëmbet nga një emergjencë.

Çdo shkollë duhet të zhvillojë dhe të zbatojë planin gjithëpërfshirës të saj, që përshkruan veprimet që nxënësit, mësuesit dhe stafi i shkollës, duhet të ndërmarrin përpara, gjatë dhe pas ngjarjeve emergjente. Të gjithë duhet të dinë se çfarë pritet prej tyre. Çdo minutë ndërmjet fillimit dhe fundit të një incidenti, mund të shpëtojë jetë.

Si pjesë e rëndësishme e planifikimit të reagimit ndaj emergjencës, trajnimi mëson stafin për procedurat, rolet dhe përgjegjësitë e secilit në shkollën e tyre. Gjithashtu, u jep atyre informacionin që u nevojitet, për të trajnuar nxënësit për procedurat e

emergjencës. Shkollat mund të shkruajnë planet, politikat dhe procedurat e tyre, në një skenar emergjence. Ushtrimet në praktikë u ofrojnë të gjithëve mundësinë, për të praktikuar veprimet që do të ndërmarrin para, gjatë dhe pas një emergjence. Trajnimet dhe ushtrimet janë komponentë thelbësorë të planeve të sigurisë së shkollës.

**Grupi për menaxhimin e emergjencave (GME)**

Qëllimi kryesor i grupit është përgatitja e gjithë komunitetit shkollor, për ndonjë ngjarje të mundshme dhe implementimi i **planit të veprimeve në rast emergjencash**. Punonjësit e shërbimit psiko-social janë pjesë e këtij grupi.

Detyrat e PSHPSSH-ës, si pjesë e grupit për menaxhimin e emergjencave, fokusohen kryesisht në:

- Bashkëpunimin me aktorët e tjerë, brenda shkollës, për zhvillimin i një sistemi të menaxhimit të rrezikut të emergjencave në shkollë;
- Identifikimin e fatkeqësive natyrore të mundshme dhe të rasteve të fatkeqësive, të shkaktuara nga njeriu, në shkollë dhe në zonën përreth saj;
- Bashkëpunimin për vlerësimin e vulnerabilitetit dhe të kapaciteteve të shkollës;
- Bashkëpunimin për zhvillimin e veprimtarive përgatitore, për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive dhe të emergjencave;
- Bashkëpunimin për zhvillimin e një kulture të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë, ndërmjet nxënësve, mësuesve, drejtuesve dhe aktorëve të tjerë në shkollë, përmes zhvillimit të njohurive dhe edukimit;
- Ofrimin e mbështetjes dhe të kujdesit;
- Vlerësimin e nevojave dhe të shqetësimeve;
- Dhënien ndihmë që individët të kenë akses ndaj shërbimeve, mbështetjes dhe informacionit.

# Udhëzime të dobishme për të folur me fëmijët rreth sigurisë në shkollë

Për disa fëmijë, edhe pjesëmarrja në një stërvitje mund të shkaktojë disa shqetësime emocionale. Kjo është veçanërisht e vërtetë, nëse u kujton atyre, një ngjarje apo krizë të mëparshme ose nëse ndihen të pambrojtur ose të shqetësuar.

Çdo bisedë me fëmijët, duhet të jetë në përputhje me moshën dhe me fazën e tyre të zhvillimit.

**Nxënësit e vegjël të arsimit fillor** kanë nevojë për informacion të shkurtër, të thjeshtë, që duhet të balancohet duke u dhënë siguri. Kjo përfshin informimin e fëmijëve, se shkolla dhe shtëpia e tyre janë përgjithësisht të sigurta dhe se të rriturit janë gjithmonë gati për t'i mbrojtur ata. Fëmijët e vegjël shpesh, vlerësojnë se sa kërcënuese ose serioze është një ngjarje, pikërisht nga reagimet e të rriturve. Fëmijët e vegjël reagojnë mirë ndaj shembujve të thjeshtë të sigurisë së shkollës, si për shembull, t'u kujtoni se dyert e jashtme janë të kyçura, ashtu siç mbyllni dyert në shtëpi gjatë natës.

N**xënësit e arsimit të mesëm të ulët** mund të jenë më aktivë me pyetjet, nëse janë vërtet të sigurtë, se çfarë po bëhet në shkollën e tyre. Ata mund të kenë nevojë për ndihmë, për të ndarë realitetin nga fantazia.

**Nxënësit e arsimit të mesëm të lartë** mund të kenë mendime të ndryshme për shkaqet e dhunës në shkollë dhe në shoqëri. Mësuesit duhet të theksojnë rolin që kanë nxënësit në mbajtjen e shkollave të sigurta, duke ndjekur udhëzimet e sigurisë së shkollës.

Pavarësisht moshës së nxënësve, është më mirë të mos jepni siguri të rreme ose të minimizoni shqetësimin e tyre. Për shembull, pas lajmeve në medie të dhunës në një shkollë ose në një komunitet tjetër, ose pas dëmtimit nga një fatkeqësi natyrore, fëmijët mund të shqetësohen më shumë për sigurinë e tyre. Ndihmojini fëmijët të mësojnë t'i përballojnë ndjenjat shqetësuese, në vend që të pretendojnë se nuk ekzistojnë ose që nuk duhet të ekzistojnë.

Është e rëndësishme të flisni me nxënësit dhe të ofroni mbështetje emocionale, pas një situate krize. Disa fëmijë mund të mos i shprehin verbalisht shqetësimet e tyre. Fëmijët mund të shfaqin shenja, si: gjendje ankthi, ndryshime në sjellje, probleme me gjumin, shmangie të aktiviteteve të përditshme, probleme në shkollë ose me arritjet mësimore. Shumë fëmijë mund t'i fshehin shqetësimet e tyre, ndonjëherë për të mbrojtur prindërit dhe mësuesit.

# Ndërhyrja në kontekstin shkollor

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërmerr këta hapa, mbështetur në planin vjetor, përkatësisht në realizimin e temave të ndryshme, me qëllim edukimin, informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit, në lidhje me aftësitë përballuese dhe menaxhuese në rast situatash emergjente:

**<u>Parandalon</u>**

Punonjësi i SHPSSH-ës parandalon, duke:

- Realizuar seminare informuese/ndërgjegjësuese me nxënës, me prindër, me mësues për situatat emergjente dhe menaxhimin e tyre sipas rastit.
- Krijuar grupe mbështetëse (p.sh., me senatorët e klasave ose me nxënës me aftësi të mira sociale), me qëllim ofrimin e mbështetjes së tyre në situata emergjente.
- Forcuar kapacitetin e një grupi mësuesish, të cilët janë pjesë e grupit për menaxhimin e emergjencave.

**<u>Vlerëson</u>**

Punonjësi i SHPSH-ës merr kohën e nevojshme, për të vlerësuar situatën, nëpërmjet:

- Vlerësimit të nevojave pas ngjarjes emergjente.
- Përcaktimit të prioriteteve të punës në emergjencë dhe pas saj.
- Përcaktimit të target grupit, ku do të ndërhyjnë.
- Propozimit të llojit të ndërhyrjes dhe të personave përgjegjës.
- Zbatimit dhe monitorimit të planit dhe të ndërhyrjeve për të cilat është rënë dakord.
- Rivlerësimit sipas nevojave.

**<u>Ndërhyn</u>**

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërhyn në dy mënyra:

A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë.
B. Ndërhyrje e tërthortë.

*Në rast të situatave emergjente, grupi i menaxhimit të emergjencaveka rolin parësor në menaxhimin e situatës.*

**A.NDËRHYRJE E DREJTPËRDREJTË**

**Ndërhyrje në nivel individual**:

- Këshillim/konsultim.
- Mbështetje për personat e dëmtuar nga situata emergjente.
- Nevojitet që psikologët, punonjësit socialë shkollorë, mësuesit dhe oficerët e sigurisë (aty ku ka) të identifikojnë shenjat paralajmëruese dhe të referojnë rastet e këtyre nxënësve, për t'i menaxhuar ato në mënyrën më të mirë të mundshme.
- Ofrimi i ndihmës së parë psikologjike.
- Psikoedukim në lidhje me ankthin që shkakton një situatë emergjente dhe simptomat e tij si mendimet intruzive, frika, ankthi dhe emocionet e tjera negative që vijnë si pasojë e traumës.
- Nxënësi mësohet të identifikojë, të emërtojë dhe të menaxhojë emocionet. Nxënësit i mësohen teknika të rregullimit emocional që përfshijnë etiketimin e emocioneve, aftësitë për të qetësuar veten dhe aftësitë përballuese.
- Mësojini nxënësit teknika relaksimi (p.sh., relaksimi progresiv i muskujve, ushtrimet e frymëmarrjes dhe imagjata vizuale e drejtuar)
- Nxënësit i mësohet roli i mendimeve negative dhe që shkaktojnë ankth. Nxënësi mban shënim mendimet negative që e shqetësojnë.
- Nxënësi mëson t'i zëvendësojë mendimet negative me pohime realiste që bazohen në prova dhe fakte.
- Nxënësi mëson të thotë "STOP" sapo vë re mendime negative apo mendime intruzive të padëshiruara. Nxënësi udhëzohet të imagjinojë një shenjë ndaluese sapo vë re mendime negative apo që lidhen me traumën.
- Familjarët mësohen si ta mbështesin nxënësin ndërkohë që ai/ajo përballon frikërat dhe ankthin.
- Ndihmojeni nxënësin të bëjë një listë me aktivitete zbavitëse, sociale dhe produktive ku mund të marrë pjesë (p.sh., klube, hobi, aktivitete

kulturore, punë vullnetare, aktivitete sportive, aktivitete sociale, lojëra) që rritin kënaqësinë dhe vlerësimin për veten.

**B. NDËRHYRJE E TËRTHORTË**

**Ndërhyrje në nivel klase:**

- Punonjësi psiko-social realizon seminare informuese/ndërgjegjësuese me nxënës, për situatat emergjente dhe menaxhimin e tyre sipas rastit.
- Realizimi i aktiviteteve me natyrë rekreative, sportive.
- Realizimi i aktiviteteve me natyrë social-emocionale. Forcon kapacitetet dhe aftësitë përballuese të nxënësve.
- Realizon diskutime në grup me mësues dhe me nxënës, për të ndarë emocionet e përjetuara nga situatat emergjente.
- Rrit aftësitë përballuese, nëpërmjet teknikave të relaksimit.
- Thekson rolin dhe përgjegjësinë e mësuesve dhe të nxënësve, në krijimin e një mjedisi normal dhe të një atmosfere pozitive në klasë/shkollë.

**Ndërhyrje në nivel shkolle:**

- Bashkëpunon në zbatimin e planit të veprimit për menaxhimin e emergjencave në shkollë.
- Zbatimi i programeve me qëllim menaxhimin dhe realizimin e ndërhyrjeve në rast emergjence.

**Modeli 28. Formular për vlerësimin psiko-social në situatë emergjence**

## FORMULAR PËR VLERËSIMIN PSIKO-SOCIAL NË SITUATË EMERGJENCE

Data: _____/_____/________

Ky vleresim po kryhet për:

A. Individ (emri, mbiemri, klasa, gjinia)____________________________

B. grup individesh (klasa, mosha) ___________________________________

GJENDJA PSIKO-SOCIALE

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

NEVOJAT FIZIKE: ___________________________________________________________

NEVOJAT MATERIALE: ________________________________________________________

NEVOJAT PSIKO-EMOCIONALE: _________________________________________________

NEVOJAT SOCIALE: __________________________________________________________

RREZIKU I
MENJËHERSHËM:_____________________________________________________________

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

VEPRIMET E MENJËHERSHME :

- 
- 
- 

PUNONJËSI I SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL:

___________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

# Ndihma e parë psikologjikë në mjediset e shkollës (NPP)

Shkollat janë zakonisht institucionet e para të shërbimit që fillojnë rimëkëmbjen pas një fatkeqësie/emergjence dhe mund të bëhen burimi kryesor i mbështetjes së komunitetit gjatë dhe pas incidentit. Çdo aktor në shkollë është një kontakt i afërt dhe i drejtpërdrejtë me gjendjen e fëmijës në përballjen e situatës së krizës.

Fëmijët dhe adoleshentët të cilët kanë përjetuar një ngjarje traumatike e kanë të vështirë të verbalizojnë vuajtjen dhe shqetësimin e tyre, por ata shfaqin ndryshime të shumta në sjellje.

Ndihma e parë psikologjike (NPP) përshkruhet si një përgjigje humane, mbështetëse ndaj një personi që vuan dhe që mund të ketë nevojë për mbështetje. Ndihma e parë psikologjike përfshin: dhënien e suportit dhe kujdesit, vlerësimin e nevojave dhe shqetësimeve, plotësimi i nevojave bazë; ofrimi i mbështetjes dhe sigurisë; parandalimin e njerëzve nga dëmtimet e mëtejshme; ndihma dhe orientimi për akses ndaj informacionit, mbështetjes dhe shërbimeve.

Në korniza më të gjëra, ndihma e parë psikologjike konsiston në ofrimin e:

1. Sigurisë, qetësisë dhe shpresës;
2. Aksesit ndaj shërbimeve psiko-emocionale;
3. Fuqizimin e individëve dhe komunitetit.

Ndihma e parë psikologjike mund të jepet gjatë situatave emergjente ose menjëherë pas ngjarjes së ndodhur. NPP mund të ofrohet në një mjedis që perceptohet i sigurtë nga personi që merr ndihmën.

# Kur mund të jetë e nevojshme ndihma e parë psikologjike?

Ka disa situata të ndryshme ku ndihma e parë psikologjike është e nevojshme dhe ndihmuese. Ndër këto situata mund të përfshihen ***krizat individuale*** si, aksidentet me makinë, dikush i afërt humb jetën etj. Reagimet e përbashkëta që mund të ndodhin janë gjëndja e shokut, konfuzioni, frika, dëshpërimi, inati. Ndihma psikologjike i ndihmon personat të qetësohen, të kenë mbështetje si dhe të

identifikojnë hapat që ata duhet të ndërmarrin për të përballuar situatën e vështirë ku ndodhen.

***Sfidat sociale -*** Përjashtimi social dhe vetmia mund të çojnë në humbjen e ndjenjës së përkatësisë dhe humbjen e vetë-efikasitetit të cilat ndikojë në humbjen e shpresës dhe dëshirën për të jetuar. Në sfidat sociale perfshihen grupet e marxhinalizuara si p.sh gratë dhe fëmijët që përjetojnë dhunë bashkëshortore, ose fëmijët që jetojnë në institucione. Ekspozimi i vazhdueshëm i individit ose fëmijës ndaj situatave ***të dhunës***, çon në mbylljen dhe rritjen e stresit tek individi. Për të përballuar sa me lehtë sfidat sociale ndihma e parë psikologjike është shumë e rëndësishme po ashtu dhe angazhimi në shërbime të tjera.

***Sfidat shëndetësore*** si pandemia apo sëmundjet infektive që kanë një ndikim në gjendjen emocionalee të individitNdihma e parë psikologjike vjen në ndihmë për të mbështetur personat që janë në nivele të larta të stresit dhe pasigurisë në situata të tilla.

***Fatkeqësitë natyrore*** si tërmeti, zjarri shoqërohen me emocionet e frikës dhe panikut. Njërëzit që janë të prekur nga fatkeqësitë natyrore përjetojnë ndjenja të larta të stresit pasi janë përballur me lëndime fizike, luftën për jetën, mbrojtjen e familjarëve, zhvendosjen e përkohshme ose të përhershme nga vendbanimi i tyre. Të gjitha këto përvoja janë të vështira për tu trajtuar si në momentin e ndodhisë ashtu edhe pas saj. Ndihma e parë psikologjike ka treguar të jetë efektive në ndihmën për të parandaluar pasojat negative afatgjata të përvojave traumatike.

***Fatkeqësitë e shkaktuara nga vetë njeriu*** si p.sh zjarrvënia, shpërthimet, aksidentet. Njësoj si fatkeqësitë natyrore, dhe fatkeqësitë e shkaktuara nga individi çojnë në emocionet e frikës, panikut dhe kaosit. Fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu mund të jenë edhe më shkaktërruese e me pasoja negative si humbja e besimit tek tjetri.

Shqetësimet e lidhura me traumën mund të kenë një ndikim afatgjatë nëse nuk trajtohen. Nevojat e patrajtuara të shëndetit mendor, përfshirë ato nga ekspozimi ndaj dhunës dhe ngjarjeve të tjera potencialisht traumatike, rrisin shkallën e braktisjes, ulin arritjet shkollore, prishin marrëdhëniet midis bashkëmoshatarët dhe ndikojnë në mirëqenien e përgjithshme. Gjatë ofrimit të ndihmës së parë psikologjike është e rëndësishme që personi/at që ofrojnë NPP të qëndrojnë të qetë dhe të përpiqen të ndihmojnë pa u përfshirë emocionalisht si dhe të ruajnë

konfidencialitetin në rastet kur kjo nuk vendos në rrezik jetën e personit/ave të tjerë. Gjithashtu personi/at duhet të mbajnë në konsideratë besimin apo kulturën e personit që po i ofrohet ndihma e parë psikologjike.

Ndërhyrjet e shkurtra dhe të menjëhershme mund të prodhojnë rezultate pozitive që zgjasin.

Loja është cilësuar si një ndërhyrje psikologjike mjaft e rëndësishme dhe edukuese në krijimin e besimit dhe rritjen e mirëqënies emocionale tek fëmijët dhe adoleshentët. Fëmijët e kanë më të lehtë të shprehin veten dhe emocionet e tyre gjatë një aktivitetit ose loje argëtuese.

# Parimet kryesore për ofrimin e NPP

Puna me fëmijët gjatë ofrimit të ndihmës së parë psikologjike mbështetet në tre parime kryesore.

Parimi i veprimit **"SHIKO"** i referohet vlerësimit të informacionit mbi atë që ka ndodhur dhe po ndodh. Hapi i parë për t'iu përgjigjur një situate krize, pavarësisht nëse prek një ose më shumë persona, është të përpiqemi të *marrim sa më shumë informacion të jetë e mundur* mbi atë që ka ndodhur dhe informacion rreth gjëndjes aktuale të personit. Ka situata kur shumë njerëz preken nga e njëjta krizë si: tërmeti, shpërthim, një aksident të madh industrial, ose një situatë paniku në një festival. Përcaktimi se kujt i duhet dhënë ndihmë së pari nuk është gjithmonë e lehtë nëse ka shumë njerëz në ankth dhe vetëm. Aftësitë psikologjike të ndihmës së parë përfshijnë të mësuarit *si të vlerësojmë se kush mund të ketë nevojë për ndihmë*. Kjo përfshin njohjen e reagimeve ndaj stresit, gjithashtu menaxhimin e grupeve të margjinalizuar (fëmijë, gra, të moshuar, njerëz me probleme shëndetësore, fizike ose mendore) në situata krize të mëdha.

Shumë nga ngjarjet më shqetësuese që përjetohen përfshijnë rrezik dhe dhunë. *Kontrolli i rreziqeve dhe sigurisë* është hapi i parë në ndihmën e parë psikologjike, dhe gjithashtu mund të përsëritet disa herë. Pasi ofruesi i ndihmës të jetë i sigurt për të vazhduar, pasojnë veprime të tjera psikologjike të ndihmës së parë, përfshirë sigurimin e konfidencialitetit të personit të prekur. **Nëse siguria në një vend krize nuk mund të garantohet, atëherë nuk është e përshtatshme të vazhdohet me ofrimin e ndihmës së parë psikologjike**. Një pjesë e rëndësishme e ndihmës së

parë psikologjike është të ndihmosh individët të kenë *akses në nevojat themelore,* si dhe identifikimi nëse personi/fëmija i prekur ka ndonjë *dëmtim fizik.*

**"DËGJO"** do të thotë të jesh prezent, t'i kushtosh vëmendje dhe të përpiqesh të kuptosh se çfarë i ka ndodhur personit në ankth, çfarë po ndjen dhe çfarë ka nevojë. Krijoni kontakt me dikë në ankth me kujdes, me qetësi dhe në një mënyrë të përshtatshme. Si sjellja ashtu edhe qëndrimi i ndihmësit ndikojnë në mënyrën sesi një person në ankth reagon ndaj ndihmës. Nëse personi në ankth ndjen panik dhe takon një ndihmës NPP i cili është gjithashtu në panik, kjo do t'i bëjë ndjenjat e tij të ankthit edhe më të mëdha. *Dëgjimi aktiv* (mënyra se si profesionisti prezanton veten, pranon ndjenjat e të tjerëve, pyet për nevojat dhe shqetësimet, ndihmon person-in/at në ankth të gjejë zgjidhje për nevojat dhe problemet e tij të menjëhershme) është më shumë sesa thjesht të dëgjosh atë që thotë dikush. Aftësitë psikologjike të ndihmës së parë kërkojnë një qëndrim të hapur dhe jo gjykues.

Parimi i fundit **"LIDH"** (akses ndaj informacionit, mbështetje sociale) fokusohet më tepër në plotësimin e nevojave themelore dhe aksesin në shërbime që u nevojiten individëve për të përballuar gjendjen e tyre. Roli i ofruesit NPP është të ndihmojë personin të rimarrë kontrollin e situatës ku ndodhet.

# Këshilla për punonjësit e shërbimit psiko-social: Çfarë duhet të kemi parasysh gjatë ofrimit të ndihmës së parë psikologjike?

**Përpiquni të punoni brenda kornizave të profesionit dhe të aftësive tuaja.** Shpesh, gjatë situatave emergjente ose të rënda, marrim padashur edhe role të tjera, jashtë aftësive dhe kompetencave tona.

**Qëndroni të qetë, ndihmues dhe përpiquni të jeni të organizuar**. Fëmijët zakonisht, kanë një reagim mjaft të irrituar, në situata emergjence, dhe personat e specializuar që ofrojnë ndihmë, mund të jenë të prekur ose të përfshirë në situata të tilla, por e mira është që të qëndrojmë të qetë dhe të përpiqemi të ndihmojmë, pa i marrë ngjarjet shumë personale.

**Jini të pranishëm**. Mundohuni të jeni të pranishëm me personat e prekur nga situata e emergjencës, ose përballë, ose nëpërmjet telefonit. Fëmijët që janë të prekur, duhet të informohen, se si mund t'ju kontaktojnë ose ku mund t'ju gjejnë.

**Ruani konfidencialitetin**. Ky është një nga parimet kyçe në punën me të tjerët. Fëmijët dhe prindërit duhet të krijojnë ndjenjën e besimit, në mënyrë që t'ju besojnë dhe t'ju lënë që t'i ndihmoni. Në raste kur vendoset jeta në rrezik, atëherë mund të thyeni konfidencialitetin.

**Qëndroni brenda rolit**. Nëse ju mendoni se mund të zgjidhni gjërat përtej kompetencave tuaja, e mira është të qëndroni brenda rolit tuaj, pa krijuar konfuzion për veten dhe për të tjerët.

**Ndërhyrja në kontekstin shkollor**

Piramida ndërhyrjeve në rastet e ofrimit të ndihmës së parë psikologjike NPP nga punonjësit e shërbimit psiko-social fokusohet në katër shkallë kryesore:

***Shërbime bazë dhe siguria***- përfshihen të gjitha materialet bazë si: ushqime, strehim, higjenë, shërbimet mjekësore. Pjesa më madhe e fëmijëve do të rimëkëmben më shpejt nëse kanë akses të menjëhershëm ndaj nevojave bazë.

***Mbështetja e familjes dhe e komunitetit*** – për personat që kanë përjetuar humbje të familjareve kërkohet një mbështetje nga personat përreth, nëpërmjet mbledhjeve në grup, ndërsa fëmijët mund të mbështeten nëpërmjet edukimit formal dhe joformal.

***Mbështetja e fokusuar*** – ofrohet nga persona si psikolog, punonjës social, mësuesi dhe stafi i qendrave shëndetësore. Trajtimi i fëmijëve zgjat për disa muaj dhe përfshin kryesisht këshillim dhe fokus-grupe.

***Shërbimet e specializuara*** – ofrohet për një përqindje të vogël të individëve, që në të shumtën e rasteve janë individët e neglizhuar gjatë ngjarjeve katastrofike. Ky lloj shërbimi ofrohet nga persona të specializuar. Shërbimet e specializuara janë të zgjatura në kohë. Ky lloj shërbimi ofrohet nga specialistët e shëndetit mendor, psikoterapistët dhe nga persona që janë të specializuar për të punuar me traumat.

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërmerr këta hapa:

**<u>Informon/sensibilizon</u>**

Punonjësi i SHPSSH-ës informon/ sensibilizon duke:

- Realizuar seminare informuese/ndërgjegjësueseme nxënës, me prindër, me mësues me qëllim rritjen esensibilizimit  për ofrimin e NPP/së në situata emergjente që mund të ndodhin në shkollë;
- Referuar hapat e nevojshme për parandalimin e shqetësimeve emocionale të personave të përfshirë në situata krize;
- Përcjell teknika të përshtatshme për menaxhimin e emocioneve personale tek aktorët e tjerë në institucion arsimor;
- Siguruar një komunikim të ngrohtë me fëmijët,
- Referuar rëndësinë e ofrimit të mbështetjes emocionale dhe të qëndruarit në vazhdimësi që të ndihmojë fëmijët në kapërcimin e kësaj krize.

*Problematikat e lidhura me  NPP mund të identifikohen/referohen nga:*

- Mësuesi
- Bashkëmoshatarët
- Punonjësi i SHPSSH-ës
- Prindi
- Çdo aktor tjetër (individë të komunitetit pranë shkollës).

**Vlerëson:**

- Nevojat më urgjente që fëmija ka;
- Identifi kimi dhe sqarimi i ngjarjes apo ngjarjeve që ka përjetuar apo dëshmuar nxënësi dhe çfarë ka ndodhur saktësisht
- Reagimin fillestar të fëmijës;
- Ashpërsinë e simptomave që shfaqen tek fëmijët/adoleshentët**;**
- Kohëzgjatjen e fëmijës/adoleshentit ndaj situatës traumatikë;
- Nivelin e shqetësimit/ stresit të përjetuar.

Fëmijët/adoleshentët të cilët shfaqin reagime të rënda , të tilla si duke pasur shpërthime apo duke i zënë paniku, janë në rrezik të madh dhe kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme të specializuar.

# Ndërhyn

Punonjësi i SHPSSH-ës ndërhyn duke ofruar mbështetjen në disa nivele:

- Ekspozimi i nivelit 1: Ofrimi i mbështetjes për personat e ekspozuar drejtpërdrejt ndaj ngjarjes.
- Ofrimi i këshillimeve individuale për nxënësit.
- Ekspozimi i nivelit 2: Ofrimi i mbështetjes për familjen e personave që u ekspozuan drejtpërdrejt.
- Ekspozimi i nivelit 3: Ofrimi i mbështetjes për përgjegjësit e parë të përfshirë në reagimin ndaj krizës
- Ekspozimi i nivelit 4: Ofrimi i mbështetjes për personat që janë të përfshirë sepse kanë mësuar për ngjarjen.
- Reduktimi i simptomave që janë të pranishme.
- Njerëzve u jepet mbështetja e nevojshme për të rivendosur kontrollin mbi jetën e tyre ose situatën në të cilën ndodhen, pa u përpjekur të kthehen menjëherë në funksionimin e tyre të mëparshëm.
- Identifikimi i faktorëve që çuan në krizë (për t'i parandaluar ato).
- Zhvillimi i strategjive pozitive adaptive për promovimin e shëndetit me theks në shëndetin mendor.

**Pas ndërhyrjes (vazhdimësia)**

- Të sigurohet mbështetja në interval kohore si p.sh. 3 muaj, 6 muaj dhe një vit.
- Të vlerësohet infromacioni i marrë rreth emergjencave.
- Të thirren për ndihmë ekspertët jashtë IA-së nëse vlerësohet e nevojshme.

# REFERIMI

Për rastet kur punonjësi i shërbimit psiko-social has vështirësi dhe nuk ka rezultate nëfuqizimin e fëmijëve në mjediset shkollore, i referon ato në institucione të tjera përkatëse, jashtë ambienteve të shkollës, duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

# PLANIFIKIMI DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE PËR AFTËSINË E KUFIZUAR

Punonjësi i shërbimit psiko-social në shkollë lehtëson ofrimin e shërbimeve arsimore dhe shërbimeve mbështetëse, për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, që ndjekin arsimin e zakonshëm ose arsimin special. Fëmijë më aftësi të kufizuar, në institucionet arsimore të zakonshme ose ato speciale, konsiderohet nxënësi i cili është i pajisur me raport nga komisioni mjeko-ligjor (KML) ose raport nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP). Aftësia e kufizuar në shkolla, haset në disa forma, të tilla si: aftësi e kufizuar në të nxënë ose/edhe vështirësi në të nxënë, vështirësi në të folur dhe në komunikim, çrregullime ose vështirësi të vëmendjes dhe të hiperaktivitetit, aftësi e kufizuar intelektuale, çrregullime të spektrit të autizmit, sindroma të lindura, si dhe aftësitë e kufizuara fizike.

**Aftësia e kufizuar në të nxënë** ose "paaftësia e të nxënit", i referohet "mosfunksionimit minimal të trurit" dhe është një gjendje e ngjashme me "problemet e të nxënit".

**Vështirësi në nxënie**, i referohet një shumëllojshmërie të madhe të problematikave, që lidhen me të mësuarin.

**Aftësi e kufizuar specifike e të nxënit**, çrregullim që përfshin një ose më shumë nga proceset themelore psikologjike.

**Aftësi e kufizuar intelektuale**, i referohet pengesave të ndjeshme në funksionimin intelektual dhe në përshtatshmërinë e të sjellit, të shprehura në aftësitë konceptuale, sociale dhe ato të përshtatjes.

**Aftësi e kufizuar fizike**, i referohet një sërë gjendjesh dhe dëmtimesh të lindura dhe të fituara dhe përdoret për të përshkruar një numër diagnozash dhe kufizimesh fizike.

**Ngritja e komisionit të ak-së në shkollë**

Komisioni ngrihet, funksionon dhe zbaton detyrimet që i ngarkohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Komisioni i AK-së brenda IA-së, ngrihet nga drejtori i institucionit, nëse në institucion ndjek mësimin, qoftë dhe vetëm një nxënës me AK. Në institucionet ku nuk ka nxënës me AK, ngritja e komisionit nuk është e nevojshme.

Komisioni mund të ngrihet çdo fillim të vitit shkollor, nëse vlerësohet nevoja për ndryshimin e anëtarëve të tij ose në momentin kur në IA, regjistrohet për herë të parë, një nxënës me AK.

Kryetar i komisionit për AK-së të shkollës është punonjësi i shërbimit psiko-social.

Në institucionet arsimore, ku ka më shumë se një punonjës (psikolog dhe punonjës social), kryetar i komisionit është psikologu, kurse punonjësi social mund të jetë anëtar i komisionit.

**Modeli 29. Ngritja së komisionit për AK në shkollë**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _______**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ______**

**SHKOLLA "_____________________"**

**NGRITJA E KOMISIONIT PËR NXËNËSIT ME AK KOMISIONI I INSTITUCIONIT ARSIMOR TË ZAKONSHËM**

Nr.prot______ Datë ____/___/_____

Bazuar në urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", kreun XIV, neni 83, pika 1, komisioni përbëhet nga:

| NR. | EMRI MBIEMRI | POZICIONI | DETYRA |
|---|---|---|---|
| 1. | | Psikolog i shkollës | Kryetar/e |
| 2. | | Punonjës social | Anëtar/e |
| 3. | | Mësues AF | Anëtar/e |
| 4. | | Mësues AMU | Anëtar/e |
| 5. | | Mësues AMU | Anëtar/e |
| 6. | | Mësues ndihmës | Anëtar/e |

**Drejtor**

**Funksionimi i komisionit të ak-së në shkollë**

Komisioni i AK-së brenda IA-së, mblidhet disa herë gjatë vitit shkollor (sipas nevojave dhe në interesin më të lartë të fëmijës). Veprimtaria e komisionit të AK në IA, përfshin:

A. Hartimin dhe miratimin e planit vjetor të komisionit të IA-së për AK-në.
B. Udhëzimin e mësuesve lëndorë dhe mësuesve mbështetës, për hartimin e planeve PEI, për nxënësit me AK, pasi i ka njohur ata me specifikat e diagnozës dhe me vlerësimin psiko-social të fëmijës.
C. Miratimin nga komisioni të planit PEI, pasi prindi i fëmijës ka dhënë miratimin dhe dakordësinë për përmbajtjen e tij. Në rastet kur prindi nuk është dakord me përmbajtjen e PEI-t, komisioni shqyrton pretendimet e prindit, bën ndryshimet e nevojshme dhe plani konsiderohet i miratuar.
D. Vlerësimin e ecurisë së fëmijës me AK, sipas planit PEI, tri herë në vit, në fund të çdo periudhe.

Komisioni merr vendime, duke vlerësuar nevojat e fëmijës, për lejimin ose jo, të shoqërimit të nxënësit me AK, në mjedisin e shkollës, nga prindi ose nga persona të kujdesit të autorizuar prej tyre.

Për rastet kur komisioni del me vendimin për lejimin e shoqërimit të fëmijës nga prindi ose nga persona të autorizuar, komisioni depoziton pranë drejtorisë së IA-së, dokumentacionin përkatës:

a. Kërkesën e prindit për shoqërimin e fëmijës me arsyetimin dhe me autorizimin për personin përkatës.
b. Vendimin e komisionit për lejimin e tyre.
c. Dëshminë e penaliteti
d. Fotokopje të mjetit të identifikimit të personit që e shoqëron.
e. Deklaratën e personit që merr përsipër shoqërimin e fëmijës brenda shkollës (për ato raste kur shoqërues nuk është prindi).
f.

**Modeli 30. Vendimi i komisionit AK në shkollë**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ________**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**SHKOLLA "____________________"**

Data _____/_____/________

**Lënda: Vendim i komisionit të shkollës për nxënësit me aftësi të kufizuara.**

Mbështetur në udhëzimin nr… datë……., për fillimin e vitit shkollor ___________, komisioni i shkollës për nxënësit me aftësi të kufizuara, pasi vëzhgoi ecurinë dhe nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollë, shqyrtoi kërkesa të prindërve, diskutoi situatën rast pas rasti dhe vendosi:

1. Nxënësit e mëposhtëm do të shoqërohen nga prindërit ose nga shoqëruesit:

| Nr. | Emri mbiemri i nxënësit | Klasa | Orari | Emri mbiemri i prindit/shoqëruesit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | |
| 2 | | | | |
| 3 | | | | |
| 4 | | | | |

Për shembull:

2. *Nxënësi A.A, (CSA) klasa IX, i rivlerësuar me dosje në muajin qershor, ka paraqitur vështirësi në frekuentimin e shkollës. Nga komunikimi me prindin dhe me mësuesen kujdestare rezulton se A refuzon të dalë nga banesa, ndaj*

*do të rekomandohet për rivlerësim, me qëllim krijimin e kushteve për mësim në shtëpi ose në distancë.*

3. *Për nxënësit me AK do të ketë fleksibilitet në orarin e hyrjes dhe të daljes nga shkolla.*

1. Kryetar/e
2. Anëtar/e
3. Anëtar/e
4. Anëtar/e
5. Anëtar/e

**Modeli 31. Plani vjetor të komisionit AK**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR______**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR ______**

**SHKOLLA "_________________"**

**PLANI I KOMISIONIT TË SHKOLLËS PËR AFTËSINË E KUFIZUAR**

**(VITI SHKOLLOR)**

Shërbimi psiko-social: ____________________________________

*Në mbështetje të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", kreu XI, të udhëzimit të përbashkët _____, datë _________ "Për vitin shkollor ________ në sistemin arsimor parauniversitar", urdhrin nr.31, datë 28.01.2020, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", kreun XIV, si dhe në përputhje me të gjitha kartat e të drejtave të njeriut dhe me Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, është hartuar plani vjetor i shkollës, me qëllim përcaktimin e hapave konkretë dhe të veprimtarisë së komisionit të shkollës për AK.*

**Qëllimi:**

- Integrimi dhe gjithëpërfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara, në procesin e mësimdhënies. Fëmijëve t'iu krijohet mundësia, për të zhvilluar potencialet e tyre fizike dhe mendore, duke krijuar mjedis mbështetës dhe ndihmues në klasë dhe në shkollë.

**Rezultatet e pritshme:**

- Realizon identifikimin nxënësve me aftësi të kufizuara, mbi bazën e analizës sociale të shkollës.
- Realizon identifikimi e vështirësive, i problematikave konkrete që shfaqin nxënësit.
- Vlerëson nevojat dhe vështirësitë e përshtatjes së tyre në shkollë.
- Lehtëson dhe të mbështet mësuesit ndihmës, me qëllim integrimin të plotë të nxënësit në klasë dhe në shkollë.
- Eliminon paragjykimet dhe diskriminimet, si pasojë e aftësisë së kufizuar.

**Personat mbështetës:** Komisioni i IA-së për nxënësit me AK.

| **Nr** | **Aktiviteti** | **Rezultatet e pritshme** | **Koha e realizimit** | **Personi përgjegjës/në bashkëpunim** |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Formimi i grupit mbështetës për nxënësit me AK. | Bashkërendimi i punës dhe bashkëpunimi me njëri-tjetrin, me qëllim arritjen e mirëqenies psiko-emocionale të nxënësve. | Shtator ______ | Drejtoria e IA/Shërbimi Psiko-Social. |
| 2 | Evidentimi i nxënësve me AK për secilën klasë.<br><br>Krijimi i bazës së të dhënave. | Planifikimi i planeve të punës, i ngarkesës mësimore për mësuesit ndihmës.<br><br>Njohja e nxënësve të rinj në IA. | Shtator-tetor ____ | Komisioni i AK/mësuesi kujdestar. |
| 3 | Realizimi i PEI-t, në përshtatje me vështirësinë që nxënësit paraqesin. | Hartimi i planit të punës për vitin e ri shkollor.<br><br>Vendosja e rezultateve të pritshme përshtatur me nevojat që paraqet nxënësi. | Tetor ______ | Mësues kujdestar/komisioni i AK-së. |
| 4 | Takim me prindërit e | Të dhënat demografike të nxënësit me AK. | Sipas nevojave të paraqitura. | Psikolog/punonjës social |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | nxënësve me AK. | Vështirësitë specifike që ka secili nxënës, historiku i zhvillimit, terapi të bashkërenduara që nxënësi ndjek jashtë shkolle. | | Mësues kujdestar<br><br>Mësues mbështetës. |
| 5 | Vlerësimi i nxënësve me AK. | Vlerësim i zhvillimit dhe i nevojave. Vëzhgim i detajuar i këtyre nxënësve, gjatë procesit të mësimdhënies dhe në ambientet e shkollës.<br><br>Sjellja e fëmijës.<br><br>Sjellja e të tjerëve ndaj fëmijës.<br><br>Sjellja e fëmijës ndaj të tjerëve. | Shtator-tetor ________ | Komisioni i AK/prindër të fëmijëve. |
| 5 | Vlerësimi i ecurisë së PEI-it, bazuar në realizimin e rezultateve të pritshme të vendosur për periudha tremujore. | Vlerësim i arritjeve dhe i realizimit të rezultateve të pritshme të vendosura në planin e hartuar dhe ndryshime në disa prej rezultateve të pritshme fillestare, për t'iu përshtatur sa më mirë nevojave dhe aftësive të fëmijëve. | Dhjetor_____<br><br>Mars ______<br><br>Qershor _____ | Komisioni i AK-së. |
| 6 | | | | |

**Bashkëpunimi i komisionit të AK-së me drejtorinë e IA-së**

Komisioni i AK-së, në bashkëpunim me drejtorinë e IA-së, paraqet në çdo fillim të vitit shkollor, kërkesën për vlerësim dhe për rivlerësim nevojash, për çdo nxënës me AK, që ndjek mësimin në atë institucion.

Komisioni i AK-së vlerëson në vazhdimësi, nevojat e nxënësve dhe paraqet kërkesë për rivlerësim nevojash, në çdo moment të vitit shkollor, kur vlerëson se nevojat e nxënësit kanë ndryshuar.

Komisioni i AK-së në bashkëpunim me drejtorinë e IA-së, organizon ndarjen e mësuesve ndihmës, orarin mësimor, në përputhje me rekomanimet e komisionit multidisiplinar të ZVAP-së.

Institucioni arsimor siguron brenda shkollës një mjedis, i cili shërben si klasë burimore ose relaksi, për nxënësit me AK. Nxënësi me AK e përdor këtë mjedis, vetëm sipas rekomandimeve të KMD-së, pranë ZVAP-së.

**Vlerësimi periodik i nxënësve me AK**

Komisioni i AK-së në shkollë kryen vlerësimin periodik të nxënësve me AK, kur ata janë vlerësuar nga KMD-ja dhe është dhënë rekomandimi të ndiqen me PEI, pavarësisht nëse punojnë me mësues ndihmës ose jo. Në rastet kur nxënësi me AK, nuk punon me mësues ndihmës, planin PEI e harton mësuesi lëndor, në bashkëpunim me punonjësin e shërbimit psiko-social.

Vlerësimi periodik i nxënësit me AK nga komisioni i shkollës, përfshin vlerësimin për arritjen e rezultateve të pritshme lëndore dhe sjellore. Vlerësimi kryhet nga komisioni, duke plotësuar një format tip.

Për nxënësit të cilët nuk paraqesin nevojë të punojnë me PEI, dokumenton ecurinë e nxënësit për periudhën, duke përdorur elemente nga formati tip, në përputhje me specifikat e rastit (sjellore, përshkrimin e arritjeve, treguesit e tjerë të arritjeve, etj.).

**Modeli 32. Vlerësimi i ecurisë për nxënësit me AK**

**Lënda: Vlerësimi i ecurisë së nxënësve me AK**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri Mbiemri:** | | **Klasa:** | **Gjinia:** |
| **Periudha:** | **Diagnoza:** | | |
| **Viti shkollor:** | **Numri i orëve me mësues ndihmës __________:** orë/javë. | | |
| **Lloji i raportit:** | | | |

| **Fusha** | **Rezultatet e pritshme të PEI-t** | Do të përforcohet rezultati i të nxënit? Po/Jo | **Niveli i arritjeve të PEI-t (1-5)** |
|---|---|---|---|
| **Gjuhët dhe komunikimi** | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| **Matematikë** | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| **Shkencat e natyrës** | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| **Shoqëria dhe mjedisi** | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| **Arte** | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

| **Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti** | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |

Përshkrimi i niveleve të arritjeve**:**

______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
_

| **Nr.** | **Treguesi i vlerësuar** | **Niveli i arritjeve** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | APK (1) | ANP (2) | AK (3) | ASHK (4) | ASH (5) |
| 1. | Frekuentimi i shkollës. | | | | | |
| 2. | Qëndrimi në klasë (koha e plotë, e pjesshme etj ). | | | | | |
| 3. | Sjellja në klasë gjatë mësimit. | | | | | |
| 4. | Aftësia verbale/shprehëse. | | | | | |
| 5. | Aftësia njohëse/konjitive. | | | | | |
| 6. | Aftësia për të shkruar me të diktuar. | | | | | |
| 7. | Aftësia për të shkruar me të kopjuar. | | | | | |
| 8. | Pjesëmarrja, sjellja dhe qëndrimi në aktivitete. | | | | | |
| 9. | Kujdesi ndaj vetes dhe higjiena personale. | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10. | Arritja e përgjithshme e rezultateve të të nxënit. | | | | | |
| 11. | Arritja e përgjithshme e rezultateve të pritshme sjellorë. | | | | | |

Komisioni i AK-së

| NR | EMRI MBIEMRI | POZICIONI | DETYRA | FIRMA |
|---|---|---|---|---|
| 1. | | Psikolog i shkollës | Kryetar/e | |
| 2. | | Punonjës social | Anëtar/e | |
| 3. | | Mësues AF | Anëtar/e | |
| 4. | | Mësues AMU | Anëtar/e | |
| 5. | | Mësues AMU | Anëtar/e | |
| 6. | | Mësues ndihmës | Anëtar/e | |

**Modeli 33. Vlerësimi i ecurisë për nxënësit me AK që nuk ndiqen me PEI**

**Lënda: Vlerësimi i ecurisë së nxënësve me AK që nuk ndiqen me PEI.**

| | | |
|---|---|---|
| **Emri Mbiemri:** | **Klasa:** | **Gjinia:** |
| **Periudha:** | **Diagnoza:** | |
| **Viti shkollor:** | **Numri i orëve me mësues ndihmës __________:** orë/javë. | |
| **Lloji i raportit:** | | |

**Përshkrimi i ecurisë dhe i niveleve të arritjeve:**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

_

| Nr. | Treguesi i vlerësuar | Niveli i arritjeve | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | APK (1) | ANP (2) | AK (3) | ASHK (4) | ASH (5) |
| 1. | Frekuentimi i shkollës. | | | | | |
| 2. | Qëndrimi në klasë (koha e plotë , e pjesshme etj.). | | | | | |
| 3. | Sjellja në klasë gjatë mësimit. | | | | | |
| 4. | Aftësia verbale/shprehëse | | | | | |
| 5. | Aftësia njohëse/konjitive. | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6. | Aftësia për të shkruar me të diktuar. | | | | | |
| 7. | Aftësia për të shkruar me të kopjuar. | | | | | |
| 8. | Pjesëmarrja, sjellja dhe qëndrimi në aktivitete. | | | | | |
| 9. | Kujdesi ndaj vetes dhe higjiena personale. | | | | | |
| 10. | Arritja e përgjithshme e rezultateve të të nxënit. | | | | | |
| 11. | Arritja e përgjithshme e rezultateve të pritshme sjellorë. | | | | | |

Komisioni i AK-së

| NR | EMRI MBIEMRI | POZICIONI | DETYRA | FIRMA |
|---|---|---|---|---|
| 1. | | Psikolog i shkollës | Kryetar/e | |
| 2. | | Punonjës social | Anëtar/e | |
| 3. | | Mësues AF | Anëtar/e | |
| 4. | | Mësues AMU | Anëtar/e | |
| 5. | | Mësues AMU | Anëtar/e | |
| 6. | | Mësues ndihmës | Anëtar/e | |

# Punonjësi SHPSSH-së ndërhyn në dy mënyra:

A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë.

B. Ndërhyrje e tërthortë.

**A. Ndërhyrje e drejtpërdrejtë**

Ndërhyrje në nivel individual

- Ndihmohen prindërit të identifikojnë detyrat që mund të zhvillojë nxënësi dhe ato detyra që nuk mund të kryejë në mënyrë që prindërit të kenë pritshmëri realiste mbi arritjet e nxënësit.
- Prindërit inkurajohen të dallojnë dhe lavdërojnë sa më shpesh nxënësin për sjelljet pozitive që bën.
- Nxënësit i caktohen disa detyra bazë në shtëpi ose në shkollë në mënyrë që të përmirësojë vlerësimin për veten ndërkohë që merr disa përgjegjësi.
- Nxënësit i mësohet aftësi komunikimi bazë për të përmirësuar aftësinë e tij në shprehjen e mendimeve, ndjenjave dhe nevojave në mënyrë sa më të qartë. Përmes udhëzimit, lojës dhe modelimin i mësohet rëndësia e dëgjimit të mirë, mbajtjes së kontaktit me sy, respektimit të ndjenjave dhe sendeve të të tjerëve etj.
- Nxënësi mësohet të identifikojë, të etiketojë dhe të shprehë emocionet e ndryshme
- Prindërit mësohen të përdorin teknika të efektshme të menaxhimit të sjelljes për të shmangur shpërthimet e zemërimit dhe veprimet agresive. Prindërit mësohen të menaxhojnë këto sjellje duke përdorur heqjen e privilegjeve ose duke caktuar ndëshkime të logjikshme dhe të natyrshme në rast se nxënësi përfshihet në sjellje të papërshtatshme Psikoedukim me prindërit ku orientohen të zbatojnë teknika të menaxhimit të sjelljes. Psh prindërit mësojnë të injorojnë sjelljet e papërshtatshme, lavdërimin e sjelljeve pozitive dhe caktimin e rutinave të shëndetshme.
- Hartohet një sistem shpërblimi për ta ndihmuar nxënësin të përmirësojë aftësitë sociale dhe reduktuar sjelljet agresive.

- Organizohen takime me familjarë ku ata të shprehin ndjenjat dhe vështirësitë që hasin ndërsa rrisin një fëmijë me aftësi të kufizuar. Prindërit nxiten të marrin pjesë në aktivitete mbështetëse për familjet e personave me vështirësi zhvillimore.
- Familja inkurajohet të përfshijë aktivitete të shpeshta me fëmijën në rutinën e tyre dhe të komunikojnë shpesh me të.
- Prindërit inkurajohen ta përfshijnë nxënësin në aktivitete jashtë shkollore për të përmirësuar komunikimin me moshatarët.
- Mund të përdoret terapia e artit dhe vizatimet për ta ndihmuar nxënësin të shprehë ndjenjat dhe nevojat e tij/saj.

**B. Ndërhyrje e tërthortë (nivel klase)**

*Metodat e mësimdhënies të përshtaten në bashkëpunim me mësuesit lëndor, kujdestar, ndihmës duke zbatuar hapat e mëposhtëm, për t'i ardhur në ndihmë fëmijës:*

- Ngritja e një grupi mbështetës për nxënësin me aftësi të kufizuar që të mund të ndihmojnë me socializimin e tij dhe përfshirjen në aktivitete sociale.
- Takime ndërgjegjësuese në nivel klase mbi temën e socializimit, përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara dhe përmirësimit të komunikimit dhe aftësive të tyre sociale.
- Marrëdhënia mësues-nxënës, përmirësimi i marrëdhënieve pozitive dhe të afërta mësues-nxënës.
- Peer-tutoring (bashkëshoqërimi)- ulja në bankë me nxënës që janë ndihmues dhe mbështetës.
- Paraqitja vizuale - krijimi dhe paraqitja vizuale e proceseve të të nxënit (projektor, vizatime, paraqitja në kartona, vendosja e materialeve vizuale në ambientet e klasës).
- Metoda bashkëkohore të mësimdhënies- duke përfshirë aktivitete argëtimi gjatë procesit të të nxënit, si: ngjyrosje, vizatim, shoqërimi i mësimit me lëvizje ose me muzikë.
- Ndarja e detyrave në pjesë të vogla.
- Identifikimi i fushës/ave së/të interesit dhe angazhimi i fëmijës më tepër në këtë aspekt.

- Përforcimi i arritjeve dhe i shpërblimeve verbale të shpeshta, për të rritur motivimin e fëmijës.

**C. <u>Ndërhyrje e tërthortë (nivel shkolle)</u>**

- Aktivitete psiko-edukuese me mëues e prindër për rritjen e njohurive dhe të informacionit, në lidhje me aftësinë e kufizuar.
- Aktivitete masive në bazë shkolle mbi temat e shëndetit mendor, në kuadër të ditëve ndërkombëtare të përcaktuara në udhëzimin e fillim vitit shkollor.
- Aktivitete sociale, sportive dhe kulturore ku të përfshihen nxënësit me aftësi të kufizuar.

# REFERIMI

Për problematika sjellore, të ndeshura në mjedisin shkollor, duhet dhe është e nevojshme që punonjësi i shërbimit psiko-social dhe i gjithë stafi mësimor i institucionit arsimor, të ndërmarrin çdo hap brenda shkollës dhe të shfrytëzojnë çdo mundësi, për të ofruar ndërhyrje efektive. Kur vlerësohet e nevojshme ose kur nxënësi ndodhet në një situatë ku ka nevojë për mbrojte, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, duhet të referohet për konsulta dhe duhet të bashkëpunohet me shërbime jashtë shkolle.

# Referimi për mbrojtje

Punonjësi i shërbimit psiko-social ka detyrimin ligjor, të bëjë raportimin, pranë drejtorit të IA-së, drejtuesit të njësisë së shërbimit psiko-social, NJMF-ës dhe/ose organeve të policisë sipas rastit.

Raportimi i fëmijës në nevojë për mbrojtje, bëhet me çdo mjet komunikimi, me telefon (vetëm në rast emergjence dhe më pas, dokumentohet referimi në formë zyrtare), me e-mail, me postë dhe/ose në formë shkresore.

Në rastet kur punonjësi i SHPSSH-ës ftohet të bëhet pjesë e grupit teknik ndërsektorial pranë bashkisë, e ka për detyrë të marrë pjesë dhe të përfshihet në detyra dhe në përgjegjësi (brenda shkollës), që ndikojnë në mirëqenien psiko-sociale të fëmijës.

Drejtuesi i shërbimit psiko-social duhet të vihet në dijeni në çdo rast raportimi.

Drejtuesi i shërbimit psiko-social duhet të monitorojë ndjekjen e çështjes dhe të sigurohet për mirëfunksionimin e bashkëpunimit të shërbimit psiko-social dhe të NJMF-ës.

Formati i raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, është standard dhe i miratuar me VKM. Gjeni më poshtë formularin:

**Modeli 34. Formulari i raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje**

| **FORMULARI I RAPORTIMIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE** |
|---|

<table>
<tr><td>Emri/Identiteti i fëmijës:</td><td>Data e lindjes:<br><br>_____/_____/________</td><td colspan="2">Gjinia:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Emri dhe adresa e prindit/kujdestarit:</td><td colspan="2">Vendndodhja e fëmijës/Adresa ku po qëndron nxënësi:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Shenjat e abuzimit/neglizhimit/dhunës së mundshme:<br><br>(shenja fizike, sjellja e fëmijës, informacione të tjera për gjendjen e fëmijës)</td><td colspan="2">Lloji i abuzimit i dyshuar/konstatuar:<br><br>☐ dhunë fizike<br>☐ dhunë seksuale<br>☐ dhunë psikologjike<br>☐ shfrytëzim ekonomik<br>☐ trafikim<br>☐ fëmijë në situatë rruge<br>☐ neglizhim</td></tr>
</table>

**Të dhëna të tjera mbi situatën e fëmijës**

*Përmblidh informacione të tjera që sugjerojnë se fëmija është në situatë rreziku dhe burim i rrezikut.*

**Arsyet për raportim - shqetësimi për mbrojtjen e fëmijës**

| | | |
|---|---|---|
| **Emri dhe detajet e kontaktit të personit që ka bërë identifikimin:** | **Emri dhe detajet e kontaktit të personit që bën raportimin:** | |
| **Firma** | **Emri dhe kontaktet e personit/institucionit të cilit i dërgohet formulari:** | **Formulari është dërguar:**<br><br>▪ **E-mail:**<br><br>______________________<br><br>▪ **Postë:**<br>▪ **Data:**_____/_____/________ |

# Referimi për shërbime

Punonjësi i shërbimit psiko-social duhet të disponojë një hartë të shërbimeve sociale, për zonën ku ai/ajo punon.

Punonjësit e shërbimit psiko-social duhet të bashkëpunojnë dhe duhet të koordinojnë punën, me çdo institucion që kontribuon në interesin më të lartë të fëmijës si PMF/NJM, agjenci të tjera, për të siguruar shërbime të përshtatshme për nxënësit.

Punonjësi i shërbimit psiko-social, pasi ka identifikuar një nxënës, nevojat e të cilit i tejkalojnë kompetencat e tij/saj, ka detyrimin ta referojë fëmijën, për të marrë shërbime të tjera të specializuara.

Nxënësit me aftësi të kufizuara referohen pranë qendrave që japin shërbime të specializuara.

Kur punonjësi i shërbimit psiko-social, por kryesisht psikologu në atë IA, ku janë dy punonjës, vlerëson te nxënësi problematika të zhvillimit, problematika të shëndetit mendor ose elemente të çrregullimeve te ndryshme, të cilat nuk janë evidentuar ose nuk janë pranuar nga prindi/kujdestari ligjor, punonjësi i referon me shkrim (duke përdorur formularin e pasqyruar në modelin 27.) dhe pret nga prindi përgjigjen mbi rekomandimin e dhënë.

Në rastet kur mungon bashkëpunimi i prindit, pas referimit nga punonjësit e SHPS-së dhe problematikat që manifeston nxënësi, vendosin në rrezik atë vetë ose nxënës të tjerë, punonjësi i SHPS-së duhet të bëjë referim të rastit pranë NJMF-ës, për neglizhim.

**Modeli 35. Referimi për shërbime**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _______**

**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _________**

**SHKOLLA__________________________**

REFERIM TE SPECIALISTI I SHËNDETIT MENDOR

Datë____________

Nxënësi: ________________________________________________

(Emër, atësi, mbiemër)

Klasa _____________ Datëlindja: ____________

**I. Shqetësimet që paraqet nxënësi:**

- ▫ Sjellje të papërshtatshme
- ▫ ADHD
- ▫ Sjellje agresive
- ▫ Mendime negative
- ▫ Simptoma të depresionit
- ▫ Çrregullim i ankthit
- ▫ Problematika të tjera emocionale
- ▫ Ide të përndjekjes
- ▫ Sjellje antisociale
- ▫ Çrregullime të të ngrënit
- ▫ Problematika të zhvillimit, të padiagnostikuara më parë
- ▫ Tjetër_______________________

**II. Mënyra se si manifestohen problematikat nga nxënësi:**

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

**III. Vlerësimi i nevojës për konsultë:**

1. E menjëhershme 2. Brenda javës së referimit 3. Brenda muajit të referimit

Punonjësi i shërbimit psiko-social

# PJESA E DYTË

# FUNKSIONIMI I NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL

Njësia e Shërbimi Psiko-Social në Shkolla ngrihet dhe funksionon sipas Udhëzimit të ministrit të arsimit. Në përmbërje ka psikologë dhe punonjës socialë me licencë për ushtrimin e profesionit përkatës, numri i të cilëve përcaktohet sipas normave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit.

Njësia e shërbimit psiko-social ka një drejtues, i cili  kryen këto detyra:

a. harton planin vjetor të njësisë, i cili miratohet nga titullari i DRAP;
b. organizon mbledhjet e njësisë;
c. bashkëpunon me njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, për të trajtuar çështje të abuzimit dhe të mbrojtjes së fëmijëve;
d. komunikon rregullisht me drejtorin e DRAP, të ZVAP-së, supervizorin e NJSHPS-ës dhe me koordinatorin/specialistin në DRAP, për çdo problematikë të këtij shërbimi, për një monitorim sa më të mirë të punës dhe për rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar;
e. komunikon me drejtorin e DRAP dhe të ZVAP-së për rastet e fëmijëve në rrezik dhe me vështirësi sociale dhe ekonomike;
f. njofton me shkrim drejtorin e DRAP dhe të ZVAP-së për çdo rast të provuar apo të dyshuar për abuzimin e nxënës-it/-ve;
g. mbikëqyr dhe mbështet veprimtaritë e psikologëve/punonjësve socialë të NJSHPS-së përkatëse në bashkëpunim me supervizoret sipas nevojës dhe numrit të punonjësve të njësisë;
h. harton raporte vjetore për çdo vit shkollor për titullarin e DRAP, ku përshkruan veprimtarinë e NJSHPS-së dhe propozon përmirësime të shërbimit psiko-social.

Drejtuesi harton planin vjetor të njësisë, në të cilin planifikohet veprimtaria e njësisë së shërbimit psiko-social për gjatë gjithë vitit shkollor. Në planifikimin vjetor, pasqyrohet:

- organizimi i njësisë, struktura dhe ndarja e punonjësve sipas supervizorëve;
- shpërndarja e punonjësve në institucionet arsimore (numri i institucioneve që mbulon, ngarkesa e numrit të nxënësve, grafiku javor i shërbimit në institucione);
- plani i veprimtarive për zhvillimin e brendshëm profesional (shpërndarja në grupe, sipas drejtuesve të rrjeteve dhe grafiku i veprimtarive kualifikuese);
- rezultatet e pritshme të njësisë për vitin shkollor.
- veprimtari dhe aktivitete, me natyrë parandaluese,vlerësuese ose ndërhyrje të unifikuara, në përmbushje të rezultateve të pritshme të njësisë për vitin shkollor.
- Të dhëna mbi veprimtarinë e Komisioneve Multidisiplinare për nxënësit me aftësi të kufizuara për çdo ZVAP.

Plani vjetor i njësisë, hartohet në përputhje me udhëzimin e ministrisë për vitin shkollor përkatës, dhe më pas, miratohet nga titullari brenda muajit shtator.

Drejtuesi i njësisë organizon mbledhjet mujore të njësisë dhe informon për problematikat e hasura, titullari i DRAP-it ose te supervizori i NJSHPS-së, në varësi të problematikës dhe natyrës së saj.

Drejtuesi bashkëpunon me njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, për të trajtuar çështje të abuzimit dhe të mbrojtjes së fëmijëve. Komunikon rregullisht me drejtues të IA-ve, drejtuesit e ZVAP-së dhe supervizorët e NJSHPS-së, për çdo problematikë të këtij shërbimi, për një monitorim sa më të mirë të punës dhe për rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar.

Rekomandon, për çdo ZVAP psikologun/punonjësin social që mund të drejtojë komisionin multidisiplinar në varësi të numrit të komisioneve që ZVAP parashikon të ngrejë.

DRAP përcakton për drejtuesin e njësisë numrin e ditëve javore të punës, për të kryer detyrat e sipërcituara, në varësi të numrit të punonjësve që ka në mbulim.

# Monitorimi i shërbimit psiko-social

Sipas kalendarit të monitorimit, të hartuar në fillim të vitit shkollor, drejtuesi i NJSHPS-ës, monitoron dhe mbikqyr punonjësit e njësisë, lidhur me zbatimin e standardeve profesionale, të parimeve etike, për dokumentimin e punës brenda

institucionit arsimor dhe për cilësinë e shërbimit të ofruar, përmes takimeve me përfitues të shërbimit (punonjës arsimorë, nxënës, persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore) dhe monitorimit të dokumentacionit përkatës.

Në varësi të tematikës së monitorimit dhe/ose problematikave të shfaqura, drejtuesi i njësisë e zhvillon procesin e monitorimit edhe në bashkëpunim me supervizorët.

Gjetjet dhe përfundimet e monitorimeve të kryera nga drejtuesi i njësisë, pasqyrohen në raportet vjetore të punës dhe në rast vlerësimi problematikash, rast pas rasti, raportohen në mënyrë të menjëhershme te drejtuesi i ZVAP-së dhe drejtuesi i DRAP-it.

Drejtuesi i njësisë kryen vlerësime për punonjësit e shërbimit psiko-social në shkolla, pas përfundimit të periudhës së provës, sipas shtojcës 1, dhe, pasi njihet edhe me vlerësimin e drejtuesit të institucionit arsimor sipas shtojcës 2, i përcjell drejtuesit të DRAP-it, vlerësimin përfundimtar për emërimin në detyrë ose jo, të punonjësit.

# FUNKSIONIMI I PROCESIT TË SUPERVIZIMIT

## Detyrat dhe funksioni i supervizorit të njësisë së shërbimit psiko-social

Supervizori i njësisë udhëzon nga ana profesionale psikologët/punonjësit socialë, në kryerjen e detyrave të tyre.

Monitoron punën e psikologëve/punonjësve socialë, në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë dhe dokumenton rregullisht çdo monitorim të kryer individualisht dhe në grup, duke hartuar raporte çdo 3 muaj, për drejtuesin e njësisë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe adresimin e problemeve të identifikuara rast pas rasti.

Mban kontakte dhe informon vazhdimisht, drejtuesin e NJSHPS-së, mbi veprimtarinë dhe problematikat në grupin e punonjësve që supervizon dhe raporton për çdo problematikë të hasur.

Bashkëpunon me drejtuesit e ZVAP-ve ose me specialistët e angazhuar me shërbimin psiko-social në ZVAP dhe DRAP, për problematikat e hasura dhe për zgjidhjet që ofrohen në shërbim të nxënësve, të mësuesve dhe të komunitetit.

Realizon analizën e nevojave të grupit të psikologëve/punonjësve socialë që supervizon dhe i adreson ato te drejtuesit e njësisë me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Për realizimin e detyrave dhe të përgjegjësive të tij/saj, supervizori i NJSHPS-ës, do të ketë ditë pune në javë, pranë ZVAP/DRAP ku është emëruar dhe pjesën tjetër të ngarkesës do ta plotësojë, si punonjës i shërbimit psiko-social në shkollë.

Supervizori realizon veprimtarinë e tij/saj për supervizim profesional të punonjësve në grup dhe/ose individualisht, sipas planifikimit në kalendarin vjetor dhe sipas nevojave të punonjësve. Supervizimi në shërbimin psiko-social përfshin supervizimin profesional dhe administrativ përmes një procesi të vazhdueshëm, sistematik dhe bashkëpunues midis supervizorit dhe punonjësit të shërbimit. Ky

proces fokusohet në promovimin e rritjes dhe zhvillimin e praktikave profesionale duke ndikuar  në rritjen e performancën.

**Supervizimi administrativ** – përfshin supervizimin në lidhje me dokumentimin dhe organizimin e punës në zbatimin e parimeve etike dhe standardet profesionale si dhe në aktet  ligjore dhe nënligjore.

**Supervizimi profesional** – i referohet mbikëqyrjes profesionale të punonjësve me qëllim mbështetjen, promovimin e aftësive, mentorimin në zhvillimin e praktikave dhe standardeve profesionale duke përmirësuar shërbimin e ofruar.

Teknikat e supervizimit përfshijnë vlerësimin, udhëzimin, modelimin, vëzhgimin, këshillimin, rishikimin e dokumentacionin që kanë të bëjnë me vlerësimet psikologjike dhe psiko-edukative, me trajtimin e rasteve konkrete etj. Të gjitha shkollat krijojnë kushte të përshtatshme që punonjësit të marrin pjesë në seancat e supervizimit në grup dhe individual për të siguruar zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional dhe mbështetje për raste të ndërlikuara. Supervizimi realizohet në bazë të një kalendari të miratuar nga drejtuesi i njësisë SHPS,  për të cilin punonjësit informohen paraprakisht. Kalendari përmban:

- Supervizim administrativ të punonjësve në institucione, duke përcaktuar institucionin, qëllimin dhe objektivin supervizimit.
- Takimet e planifikuara me grupe punonjësish ose individualisht me punonjës ku supervizori trajton problematika të ndryshme të punës të vlerësuar si të nevojshme.
- Supervizimin profesional në grup ose individual për trajtimin e rasteve sipas nevojave të punonjësve.

Gjatë punës supervizori dokumenton veprimtarinë e tij, takimet me punonjësit, etj., dhe mbështetur në të dhënat e grumbulluara harton raport çdo tre muaj për drejtuesin e njësisë së shërbimit psiko-social. Raporti  i hartuar nga supervizori përmban:

- Të dhëna statistikore mbi takimet e zhvilluara, në grup dhe individuale.
- Të dhëna statistikore mbi supervizimet adiministrative dhe profesionale.
- Gjetje dhe konstatime nga procesi i supervizimit administrativ dhe profesional.
- Rekomandime për përmirësimin e shërbimit.

Supervizimi si proces, realizohet në një nga mënyrat: i drejtpërdrejtë ose online, përmes platformave të komunikimit ose përmes komunikimit elektronik me e-mail, duke plotësuar formatin e supervizimit individual online. Për rastet kur supervizimi individual realizohet i drejtëpërdrejtë, formulari plotësohet fizikisht gjatë takimit.

Në procesin e supërvizimit, gjatë të cilit diskutohen të dhëna sensitive apo shqyrtohet dokumentacion që përmban të dhëna mbrojtura me ligj, supervizori lejohet të ketë akses në këto të dhëna dhe ka detyrimin për trajtimin e tyre në mënyrë konfidenciale.

**Modeli 36. Kërkesa për supervizim**

1. **KERKESË PËR SUPERVIZIM (individual)**

| | | |
|---|---|---|
| **Detajet e rastit**<br><br>**(Plotësohet nga punonjësi i SHPS)** | | |
| **Shkolla:** | **Punonjësi SHPS:** | **Supervizor:** |
| **Data e identifikimit:** __/_____/________ | **Data e raportimit:** _____/_____/________ | |
| **Përshkrimi i rastit ( specifiko situatën, personat e përfshirë në identifikim dhe menaxhim, kohëzgjatjen, nivelin e riskut )** | | |
| | | |
| **Hapat e menjëhershëm për menaxhimin e rastit nga psikologu/punonjësi social dhe peronat e tjerë** | | |
| | | |

| Vlerësimi i supervizorit për menaxhimin e rastit<br><br>(Plotësohet nga supervizori) |
|---|
| *Ndërhyrje të tjera të nevojshme:* |
| |
| **Trajtimi i rastit specifiko komunikimet, datat si dhe zgjidhjet e mundshme për situatën pas komunikimit fillestar** |
| |
| **Data e mbylljes** _____/_____/________ |

2. **Formular i supervizimit në grup**

**FORMULAR PËR SUPERVIZIM NË GRUP**

Data: _____/_____/________

Qëllimi:____________________________________________________________________________

___________________________________________________________________________

Çështjet kryesore të diskutuara: ______________________________________________________

_____________________________________________________________________________________

_____________________________________________________________________________________

_____________________________________________________________________________________

_____________________________________________________________________________________

_____________________________________________________________________________________

_____________________________________________________________________________________

____________________________________

Konkluzione:

_________________________________________________________________________________

**Supervizori**

**Shënim: Bashkëlidhur lista e punonjësve të supervizuar**

# VEPRIMTARIA E KOMISIONIT MULTIDISIPLINAR PËR AFËSINË E KUFIZUAR PRANË ZVAP-SË

## FUNKSIONIMI I KOMISIONIT MULTIDISIPLINAR PËR VLERËSIMIN E AK-SË

**Ngritja e komisionit**

Komisioni multidisiplinar (KMD) për AK pranë ZVAP-së, ngrihet, funksionon dhe zbaton detyrimet që i ngarkohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për arsimimin e fëmijëve me AK. Kryetar i KMD-së është drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social pranë ZVAP-së.

**Veprimtaria e KMD-së**

Komisioni mblidhet të paktën 3 herë gjatë vitit shkollor, për kryerjen e veprimtarive, si:

a. Hartimin e planit vjetor të komisioni multidisiplinar për AK-në, i cili miratohet nga drejtuesi i ZVAP-së.
b. Shqyrtimin e kërkesave të sjella nga IA-ja dhe nga prindërit e fëmijëve më AK, të paktën 2 javë para fillimit të procesit të vlerësimit, sipas njoftimit për fillimin e procesit nga ZVAP-ja.
c. Informimin e IA-së, për grafikun e vlerësimit të nxënësve (datën, orën dhe vendin), pas shqyrtimit të kërkesave dhe të dokumentacionit përkatës.
d. Vlerësimin dhe rivlerësimin e nevojavedhe të ecurisë së fëmijës me AK dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse për: llojin e arsimit që do të ndjekë nxënësi, nevojën për mësues ndihmës, orët përkatëse, rezultatet e të nxënit dhe sjellorë të PEI-t, si dhe shërbime të tjera që mund t'i ofrohen fëmijës, brenda dhe jashtë IA-së.

KMD-ja mund të mblidhet edhe për vlerësimin e rasteve urgjente, sipas kërkesës së IA-së ose të prindërve. KMD-ja i përcjell ZVAP-së, rekomandimet me orët e caktuara për çdo fëmijë, në fund të procesit të vlerësimit.

**Trajtimi i rasteve të veçanta**

Në rastet kur KMD-ja, referuar nevojave të fëmijës, ka rekomanduar që nxënësi të ndjekë arsimin special dhe prindi e ka refuzuar, KMD-ja ndjek procedurën, si vijon:

A. Rivlerëson nevojën e fëmijës në arsimin e zakonshëm.
B. Jep rekomandime për orët që do të mbështetet me mësues ndihmës, kohën e qëndrimit në IA (në varësi të mundësive të fëmijës dhe të specifikave të diagnozës), rezultatet e të nxënit dhe sjellorë të PEI-it, shërbime të tjera që mund t'i ofrohen fëmijës brenda dhe jashtë IA-së.

KMD-ja ruan në dosjen e fëmijës, të dy rekomandimet e dhëna, si dhe refuzimin me shkrim të prindit për ndjekjen e arsimit special.

# PJESA E TRETË–SHTOJCA

Instrumentet në vijim përdoren si një nga mënyrat (krahas vëzhgimit, intervistës, konsultimit etj.), për të ndihmuar dhe për të orientuar punonjësit e SHPS-së, në punën e tyre vlerësuese në shkolla. Këto instrumente lehtësojnë vlerësimin në një kohë të shkurtër, identifikimin e problematikave që lidhen me mirëqenien psiko-emocionale të nxënësit, me sjelljet problematike, me sjelljet e varësisë, me vetëvlerësimin, me fenomenin e bullizmit, me dhunën etj.

Listat e kontrollit përdoren për të ndihmuar punonjësit, të identifikojnë dhe të verifikojnë problematika, lidhur më vështirësitë në të nxënë, problemet që lidhen me gjendjen emocionale të nxënësit etj. Listat e kontrollit nuk përdoren për të diagnostikuar, por janë në funksion të vlerësimit fillestar të situatës, të hartimit të ndërhyrjes, të ndjekjes së ecurisë dhe/ose të referimit rast pas rasti.

Pyetësorët përdoren për të grumbulluar të dhëna në grupe të mëdha për problematika të ndryshme, me të cilat ndeshet sot komuniteti shkollor. Si një nga instrumentet më të përdorshme, pyetësorët mund të administrohen me nxënës, me mësues dhe me prindër. Të dhënat e grumbulluara nga pyetësorët, duhet t'i shërbejnë, jo vetëm identifikimit të problematikave dhe të dhënies së rekomandimeve, por edhe rivlerësimit pas ndërhyrjeve të realizuara.

# Shtojca 1: VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NGA DREJTORIA

**VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË PUNONJËSIN E SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NGA DREJTORI I IA-SË**

Vlerësimi për: ▫ **Periudhën 3-mujore të provës: ______________**

▫ **Performacën vjetore të punës**

**Emri i punonjësit: ____________________________** ▫ Psikolog

▫ Punonjës social

| Nr. | TREGUESIT | Shkalla e vlerësimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | DOBËT<br>0 pikë | MJAFTUESHËM<br>1 pikë | MIRË<br>2 pikë | SHUMË MIRË<br>3 pikë |
| 1 | Ka respektuar orarin dhe kohën e qëndrimit në punë. | | | | |
| 2 | Ka respektuar kodin e veshjes dhe etikën e komunikimit me nxënësit, me mësuesit, me drejtuesit dhe me prindërit, brenda institucionit arsimor. | | | | |
| 3 | Ka identifikuar dhe ka vlerësuar, në bashkëpunim me mësuesit dhe me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, nxënësit me probleme të sjelljes ose me vështirësi në të nxënë, si dhe ka hartuar e zbatuar për këta | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | nxënës, plane individuale parandaluese ose rehabilituese. | | | | |
| 4 | Ka informuar punonjësit e IA-së për zhvillimet e moshës tipike të nxënësve dhe për problemet tipike që hasin nxënësit gjatë të mësuarit dhe të nxënit. | | | | |
| 5 | Ka ofruar ndihmë ndaj punonjësve arsimorë, personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe nxënësve, në parandalimin ose në eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj punonjësve arsimorë dhe të abuzimeve të vetë nxënësve me duhanin, alkoolin, me drogën etj. | | | | |
| 6 | Ka ndihmuar mësuesit kujdestarë dhe mësuesit lëndorë, për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, në klasat e IA-së. | | | | |
| 7 | Ka plotësuar dosjet individuale për rastet e nxënësve që kanë përfituar nga shërbimi psiko-social. | | | | |
| 8 | Ka raportuar me shkrim për çdo rast (nëse ka pasur), të provuar apo të dyshuar për abuzim, të nxënësve nga punonjës arsimorë dhe nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | nxënësit, te drejtuesi i NjShPS-ës dhe te drejtori i IA-së. | | | | |
| 9 | Ka treguar gatishmëri të bashkëpunojë me institucionin arsimor, sipas nevojave të paraqitura. | | | | |
| 10 | Ka treguar korrektesë në plotësimin dhe në dorëzimin e dokumentacionit: plane, relacionemujore, relacione veprimtarish etj. | | | | |
| | SHUMA E PIKËVE PËR NIVEL | | | | |
| | **TOTAL** | | | | |

| PIKËT | 0 - 6 | 7 - 15 | 16 - 24 | 25 - 30 |
|---|---|---|---|---|
| VLERËSIMI | DOBËT | MJAFTUESHËM | MIRË | SHUMË MIRË |

Vlerësimi përfundimtar: ___________________

**DREJTORI**

# Shtojca 2: VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NGA DREJTUESI I NJËSISË

VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NGA DREJTUESI I NJËSISË

Vlerësimi për: ▫ **Periudhën 3-mujore të provës: _______________**

▫ **Performacën vjetore të punës**

SHKOLLA ______________________________________________________________

Emri i punonjësit: ______________________________ ▫ Psikolog

▫ Punonjës social

| Nr. | TREGUESIT | Shkalla e vlerësimit | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | N.1<br>*0p* | N.2<br>*1p* | N.3<br>*2p* | N.4<br>*3p* |
| **I.** | **VLERËSIMI** | | | | |
| 1 | Formulon thelbin e procesit të vlerësimit, si proces i grumbullimit të të dhënave dhe argumenton nevojën e vlerësimeve. | | | | |
| 2 | Është i vetëdijshëm se informacioni i vlerësimeve ndihmon për përcaktimin e nevojave, për raportimin dhe për planifikimin e ndërhyrjeve. | | | | |
| 3 | Ilustron përdorimin e teknikave kryesore për grumbullimin e të dhënave për vlerësime, si: vëzhgimi, intervista, fokus grupi, anketimi, testimi. | | | | |
| 4 | Fillon planifikimin e vlerësimit individual të nxënësve, vetëm pas marrjes me shkrim të referimit. | | | | |
| 5 | Kryen konsultë fillestare me përfaqësues të palëve të interesuara, përpara procesit të vlerësimit. | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Asiston në identifikimin e hershëm të problemeve të nxënësve, që lidhen me përshtatjen dhe të nxënit. | | | | |
| 7 | Është pjesë e ekipeve multidisiplinare në kryerjen e vlerësimeve të nxënësve me aftësi të kufizuara apo me nevoja të tjera të veçanta. | | | | |
| 8 | Bashkëpunon me prindërit, me stafin e institucionit dhe me persona të tjerë që kanë informacion të vlefshëm, për vlerësimin e situatave të vlerësuara. | | | | |
| 9 | Disponon dokumente që tregojnë vlerësimet e kryera. | | | | |
| 10 | I jep drejtorisë së IA-së, rekomandime me shkrim, për menaxhimin e problematikave të vlerësuara. | | | | |
| 11 | Merr masat për ruajtjen e të dhënave dhe për respektimin e të drejtave të personave që vlerëson. | | | | |
| **II.** | **Ndërhyrja** | | | | |
| 12. | Planifikon veprimtaritë e shërbimit, bazuar në planin vjetor të miratuar nga drejtoria e IA-së dhe planifikon/realizon vlerësimet sipas nevojave gjatë vitit. | | | | |
| 13 | Dëshmon se planifikimi mbulon fushën e vlerësimit, të konsultimit, të këshillimit dhe të zhvillimit profesional të aktorëve. | | | | |
| 14 | Identifikon dhe përdor teknika të parandalimit të dukurive të padëshirueshme. | | | | |
| 15 | Ka planifikuar dhe ka realizuar veprimtari parandaluese/informuese (me nxënës, me mësues dhe me prindër), bazuar në planifikimin vjetor dhe mujor. | | | | |
| 16 | Ka dokumentuar veprimtaritë e kryera me relacionet përkatëse. | | | | |
| 17 | Psikologu/punonjësi social, në bashkëpunim me mësuesit dhe me prindërit, identifikon nxënësit me probleme të sjelljes dhe me vështirësi në të nxënë | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | dhe harton e zbaton për ta, plane individuale parandaluese ose rehabilituese. | | | | |
| 18 | Psikologu/punonjësi social bashkëpunon me punonjësit arsimorë, me prindërit dhe me nxënësit, për parandalimin dhe për eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve dhe të nxënësve ndaj njëri-tjetrit. | | | | |
| 19. | Njeh sistemin e referimit të rastit, kufijtë e ndërhyrjes në shkollë dhe i zbaton ato, për rastet që tejkalojnë kompetencat e tij profesionale apo për rastet që kanë nevojë të trajtohen në mjedise të përshtatshme. Aplikon referimin sipas rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ose për vlerësim të shëndetit mendor, brenda dhe jashtë IA-së. | | | | |
| 20. | Psikologu/punonjësi social disponon dosje individuale/formular konsultimi për çdo nxënës që përfiton shërbim psiko-social. | | | | |
| 21. | Psikologu/punonjësi social ruan dosjet me informacionet individuale, në një mjedis të posaçëm dhe të sigurt. | | | | |
| 22. | Zhvillon seancat këshilluese me nxënës, me mësues dhe me prindër, në mjedis të përshtatshëm, në të cilin ruhen parimet e konfidencialitetit. | | | | |
| **III.** | **Aftësia e kufizuar** | | | | |
| 23. | Psikologu/punonjësi social bashkëpunon me mësuesit kujdestarë dhe me mësuesit lëndorë, për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. | | | | |
| 24. | **Psikologu** drejton dhe organizon punën e komisionit AK, të IA-së, bashkëpunon në hartimin e PEI-t dhe vlerëson ecurinë e çdo tremujori.<br><br>**Punonjësi social** vlerëson nevojat në aspektin social të nxënësit me AK dhe planifikon e zbaton ndërhyrjet sipas rastit. | | | | |

| IV. | **Zhvillimi profesional dhe cilësia e shërbimit** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 25 | Ofron shërbimin psiko-social në mjediset e IA-së,në përputhje me parimet profesionale dhe etike në komunikim, në paraqitje, në korrektesë. | | | | |
| 26. | Ofron shërbimin në një mjedis, mikpritës, miqësor, të përshtatshëm, për grupmoshën me të cilën punon. | | | | |
| 27 | Promovon rëndësinë e shërbimit psiko-social, duke prezantuar informacione ndërgjegjësuese, parandaluese, informuese në mjedisin e IA-së (kënd, publikim online etj.). | | | | |
| 28 | Psikologu/punonjësi social merr pjesë në rrjetet e zhvillimit profesional. | | | | |
| 29 | Psikologu/punonjësi social merr pjesë në takimet mujore të njësisë dhe të grupeve të punës. | | | | |
| 30 | I përgjigjet në kohë kërkesave të njësisë, për plotësimin e të dhënave dhe për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar. | | | | |
| | PIKË PËR NIVEL | | | | |
| | TOTAL | | | | |

| NIVELI | N.1 | N.2 | N.3 | N.4 |
|---|---|---|---|---|
| PIKËT | 0 - 20 | 21 - 46 | 47 - 72 | 73 - 90 |
| VLERËSIMI | DOBËT | MJAFTUESHËM | MIRË | SHUMË MIRË |

Vlerësimi përfundimtar: ____________________ **Drejtues i NJSHPS**

# Shtojca 3: LISTA E KONTROLLIT PËR VLERËSIMIN FILLESTAR TË SITUATËS SË NXËNËSIT ME SJELLJE RADIKALE/EKSTREMISTE

**Lista e kontrolli për vlerësimin fillestar të situatës së nxënësit me sjellje radikaliste/ekstremiste**

Një fëmijë kalon një pjesë të konsiderueshme të ditës në shkollë. Roli ynë si punonjës arsimorë është të mbështesim nxënësit, të krijojmë mjedise të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, për të mësuar e për t'u zhvilluar, gjithashtu të ruajmë një partneritet të shëndetshëm me prindërit dhe me komunitetin, në funksion të mirëqenies së fëmijës. Marrëdhëniet pozitive me mësuesit dhe me stafin e shkollës, mund të zvogëlojnë dhunën dhe sjelljet antishoqërore si bullizmi, përfshirjen në grupime me ideologji radikale etj., dhe mund të rrisin mbrojtjen ndaj fëmijës.

Kjo listë kontrolli do të shërbejë si një instrument vlerësues, për situatën në të cilën ndodhet nxënësi, në momentin e referimit/identifikimit të tij, si një nxënës me risk për t'u përfshirë në sjellje me natyrë radikaliste/ekstremiste. Instrumenti plotësohet nga punonjësi i shërbimit psiko-social shkollor, për të regjistruar dhe për të dokumentuar shqetësime të lidhura drejtpërdrejt me nxënësin, në bazë të të cilave do ndiqen hapat e nevojshëm në vazhdimësi.

Inicialet e nxënësit/Kodi:___________________________________

Mosha:_________________________________________________

Gjinia:_________________________________________________

PSHPSSH: _______________________________________________

Data e vlerësimit: _____/_____/________

Arsyeja e vlerësimit:______________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

Shkallët e matjes variojnë nga 1-5 (5 shumë shqetësuese dhe 1 asnjë shqetësim), si më poshtë:

1- Asnjë shqetësim
2- Shqetësim i vogël, rritje e vogël, nevojitet ndryshim
3- Pak shqetësim, nevojitet rritje dhe ndryshim
4- Shqetësime të rëndësishme, problematike, nevojitet ndërhyrje
5- Shqetësime ekstreme, shumë problematike, nevojitet ndërhyrje e menjëhershme.

| Pikët | Situata në të cilën ndodhet nxënësi | Komente |
|---|---|---|
| | Nxënësi pëson rënie të menjëhershme në arritjet shkollore. | |
| | Referohet nivel i ulët tolerance, nxënësi mendon se pikëpamjet e tij janë të veçanta dhe nuk e pranon qasjen ndryshe. | |
| | Nxënësi shfaqet me një ndryshim të qenësishëm dhe të menjëhershëm të veshjes, të stilit të tij/saj. | |
| | Nxënësi shfaq ndryshime në qëndrime dhe në sjellje kundrejt të tjerëve, duke reaguar me komente antisociale, kundërshtim të autoritetit etj. | |
| | Referohen mungesa të herëpashershme të nxënësit në shkollë nga mësuesi. | |
| | Ndodh shpesh që nxënësi të vijë me vonesë në shkollë edhe pas hapave të ndërmarrë. | |
| | Nxënësi shfaq sjellje agresive ndaj bashkëmoshatarëve dhe të rriturve. | |
| | Nxënësi përfshihet në situata konfliktuale herë pas here. | |
| | Shfaq vetëvlerësim të ulët, vetëfajësohet si frikacak, dështak dhe i pazot. | |
| | Nxënësi refuzon pjesëmarrjen në aktivitetet e shkollës, sidomos kur bëhet fjalë për veprimtari kulturore. | |

| | | |
|---|---|---|
| | Referohen kontakte të pakta të prindit të fëmijës në shkollë. | |
| | Nxënësi vizaton simbole ekstremiste, në ambiente të shkollës dhe jashtë saj. | |
| | Tenxënësi vihet re mbyllje në vetvete. | |
| | Referohet/vëzhgohet rënie në mësime, distancohet nga aktivitetet e klasës dhe të shkollës. | |
| | Nxënësi mund të jetë pre e bullizmit (ndihet i/e përjashtuar, ndihet i/e papranuar në shoqëri, i/e braktisur dhe pa mbrojtje). | |
| | Nxënësi mund të shfaq sjellje bullizuese ndaj të tjerëve. | |
| | Nxënësi mund të mos mbajë kontakt me sy kur komunikon me të rriturit. | |
| | Referon ndërveprim të kufizuar social, nuk kërkon ndihmë tek i rrituri. | |
| | Identifikohet si një fëmijë me trauma në të shkuarën, të pashëruara. | |
| | **TOTAL** | |

**Rezultati**

**Niveli minimal i pikëve është 19.**

**Niveli maksimal i pikëve është 95.**

Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi i SHPS-ës vlerëson nivelin e riskut.

# Shtojca 4: LISTA E KONTROLLIT PËR VLERËSIMIN E SJELLJES SË NXËNËSVE

*Kjo listë e kontrollit do të shërbejë si një instrument për të vlerësuar marrëdhënien ndërpersonale të nxënësve dhe për të dokumentuar shqetësimet e caktuara, për të cilat mund të ndërtohen plane pune me qëllim përmirësimin.*

Emri nxënësit: ____________

Klasa: ____________

Data e vlerësimit: _____/_____/________

Punonjësi i SHPSSH: ____________

Arsyeja e vlerësimit:

______________________________________________________________________

__________________________________________________________

Shkallët e matjes variojnë nga 1-5 (5 shumë shqetësuese dhe 1 asnjë shqetësim), si më poshtë:

1- Asnjë shqetësim
2- Shqetësim i vogël, rritje e vogël, nevojitet ndryshim
3- Pak shqetësim, nevojitet rritje dhe ndryshim
4- Shqetësime të rëndësishme, problematike, nevojitet ndërhyrje
5- Shqetësime ekstreme, shumë problematike, nevojitet ndërhyrje e menjëhershme.

| **Sjellja** | **Pikët** | **Komente** |
|---|---|---|
| **Pjekuria sociale** | | |
| Aftësia për të ndërtuar dhe për të mbajtur një marrëdhënie bashkëpunimi me mësuesin. | | |
| Aftësia për të ndërtuar dhe për të mbajtur një marrëdhënie bashkëpunimi me shokët. | | |
| Aftësia për të respektuar rregulloren e klasës. | | |
| Aftësia për të ndarë me të tjerët. | | |
| Aftësia për të menaxhuar situatat e vështira sociale | | |

| | | |
|---|---|---|
| Motivimi për të qënë i/e përgjegjshme. | | |
| Aftësia për vendimmarrje dhe për respektim të kufijve personal tëgjithsecilit. | | |
| **TOTALI** | | |
| **Pjekuria emocionale** | | |
| Aftësia për të kuptuar veprimin dhe ndërveprimin me të tjerët. | | |
| Aftësia për të vendosur distanca të përshtatshme sociale. | | |
| Aftësia për të zgjidhur problemet. | | |
| Aftësia për vet-rregullim emocional | | |
| Aftësia për të komunikuar nevojat personale. | | |
| Aftësia për të menaxhuar ngarkesën emocionale në lidhje me të mësuarit. | | |
| Aftësitë komunikuese dhe ato të bashkëveprimit. | | |
| Aftësia për të bashkëvepruar dhe për të reaguar në mënyrën e duhur me mësuesit dhe të rriturit e tjerë ne shkollë | | |
| Aftësia për të bashkëvepruar dhe për të reaguar në mënyrën e duhur me shokët/shoqet. | | |
| Aftësia për të filluar një dialog të qartë, të drejtpërdrejtë, të hapur dhe të pranueshëm. | | |
| Kupton dhe reagon mirë në situatat sociale. | | |
| Ka aftësi të ndjekë dialogun në klasë dhe të kontribuojë pozitivisht në të. | | |
| **TOTALI** | | |
| **Aftësitë mësimore** | | |
| Aftësia për të pasur arritje mësimore të kënaqshme. | | |
| Aftësia për t'u përfshirë dhe për të kuptuar diskutimet në klasë. | | |
| Aftësia për të kuptuar dhe për të realizuar detyrat që i jepen. | | |
| **TOTALI** | | |

- **Pjekuria sociale**

Niveli minimal i pikëve është **7**;

Niveli maksimal i pikëve është **35**.

- **Pjekuria emocionale**

Niveli minimal i pikëve është **12;**

Niveli maksimal i pikëve është **60.**

- **Aftësitë mësimore**

Niveli minimal i pikëve është **3;**

Niveli maksimal i pikëve është **15.**

**Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi i SHPS-së vlerëson nivelin e riskut për sjellje problematike.**

# Shtojca 5: Lista e kontrollit për reagimin ndaj konfliktit

*Lista e kontrollit do të shërbejë si një instrument vlerësues për situatën në të cilën ndodhet nxënësi, në momentin e referimit/identifikimit të tij/saj, si një nxënës i përfshirë në një konflikt/konflikt të mundshëm. Lista e kontrollit plotësohet nga punonjësii SHPSSH-së, për të regjistruar dhe për të dokumentuar shqetësimet e lidhura me situatën konfliktuale.*

Inicialet e nxënësit/Kodi:___________________________________

Mosha:_________________________________________________

Gjinia:_________________________________________________

PSHPSSH: _______________________________________________

Data e vlerësimit: _____/_____/________

Arsyeja e vlerësimit:

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

Shkallët e matjes variojnë nga 1-5 (5 shumë shqetësuese dhe 1 asnjë shqetësim), si më poshtë:

1- Asnjë shqetësim
2- Shqetësim i vogël, rritje e vogël, nevojitet ndryshim
3- Pak shqetësim, nevojitet rritje dhe ndryshim
4- Shqetësime të rëndësishme, problematike, nevojitet ndërhyrje
5- Shqetësime ekstreme, shumë problematike, nevojitet ndërhyrje e menjëhershme.

| Pikët | Reagimi i fëmijës ndaj konfliktit | Komente |
|---|---|---|
| | Nxënësi përpiqet të gjejë zgjidhje me kompromis, duke kërkuar bashkëbisedim. | |

| | | |
|---|---|---|
| | Nxënësi është i vendosur të arrijë atë që dëshiron, duke u munduar që t'i dalë gjithmonë e tija. | |
| | Nxënësi fokusohet te nevojat e veta, duke mos marrë parasysh nevojat e tjetrit. | |
| | Nxënësi vazhdimisht kërkon ndihmën e palës tjetër në zgjidhjen e konfliktit. | |
| | Nxënësi përpiqet të shtyjë problemin që të marrë kohë të mendojë, duke shmangur tensionet e panevojshme të momentit. | |
| | Nxënësi përpiqet të shmangë qëndrime që mund të shfaqin polemika përballë konfliktit. | |
| | Nxënësi propozon një zgjidhje të ndërmjetme, duke respektuar logjikën e arsyetimit të tjetrit. | |
| | Nxënësi përpiqet të zgjidhë menjëherë mosmarrëveshjet, duke gjetur një kombinim të drejtë midis përfitimit dhe humbjes. | |
| | Nxënësi shpreh aftësi të pakta emocionale, ndaj vetes dhe tjetrit. | |
| | Nxënësi përpiqet të mos shqetësohet për dallimet në arsyetim. | |
| | **TOTALI** | |

**Pikëzimi**

Niveli minimal i pikëve është 10.

Niveli maksimal i pikëve është 50.

Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi i SHPS-së vlerëson reagimin ndaj konfliktit.

# Shtojca 6: Lista e kontrolli për rregullimin emocional (mosha 6-11vjeç)

*Lista e kontrollit plotësohet nga prindërit, për të kuptuar shprehitë emocionale të fëmijës, në momentin kur identifikohet/referohet me vështirësi emocionale.*

**Pikëzimi**

Shkallët e matjes variojnë nga 1-5 (5 shumë shqetësuese dhe 1 asnjë shqetësim), si më poshtë:

1- Asnjë shqetësim
2- Shqetësim i vogël, rritje e vogël, nevojitet ndryshim
3- Pak shqetësim, nevojitet rritje dhe ndryshim
4- Shqetësime të rëndësishme, problematike, nevojitet ndërhyrje
5- Shqetësime ekstreme, shumë problematike, nevojitet ndërhyrje e menjëhershme.

| Pikët | Pohimet | Komente |
|---|---|---|
| | Nxënësi reagon në mënyrë pozitive ndaj ndihmës që i jepet. | |
| | Mund të shfaqë gjendje emocionale të paparashikueshme. | |
| | Nxënësi përballon me lehtësi ndryshimin e situatës. | |
| | Nxënësi shfaq aftësi emocionale rikuperuese pas ngjarjeve shqetësuese. | |
| | Nxënësi pret me qetësi situatat që do të ndodhin dhe nuk shfaq gjendje ankthi. | |
| | Nxënësi nuk shfaq sjellje “ngjitëse” ndaj prindërve. | |
| | Nxënësi i përjeton ekstremisht emocionet (ekzaltim i tepruar ose sjellje shkatërruese). | |

| | | |
|---|---|---|
| | Nxënësi e ka të vështirë të pranojë kufizimet që i vendosen nga i rrituri. | |
| | Vihen re ndjesitë, si: trishtim, apati, impulsivitet, frikë e tepruar, zemërim etj. | |
| | Nuk pranon të përfshihet në lojë me bashkëmoshatarët. | |
| | Shqetësohet për emocionet e të tjerëve dhe e shpreh atë me fjalë. | |
| | Ndihet i bezdisur, por nuk reagon për të mbrojtur veten, kur drejt tij shfaqen sjellje ngacmuese. | |
| | **TOTALI** | |

**Rezultati**

Niveli minimal i pikëve është 12.

Niveli maksimal i pikëve është 60.

Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi i SHPS-ës vlerëson nivelin e reagimit emocional te fëmijët e grupmoshës 6-11 vjeç.

# Shtojca 7: Lista e kontrollit për shprehitë emocionale (mosha 12 - 15 vjeç)

Lista e kontrollit përdoret nga punonjësit e shërbimit psiko-social, për të kuptuar shprehitë emocionale të fëmijës, në momentin kur identifikohet/referohet me vështirësi emocionale.

Shkallët e matjes variojnë nga 1-5 (5 shumë shqetësuese dhe 1 asnjë shqetësim), si më poshtë:

1- Asnjë shqetësim
2- Shqetësim i vogël, rritje e vogël, nevojitet ndryshim
3- Pak shqetësim, nevojitet rritje dhe ndryshim
4- Shqetësime të rëndësishme, problematike, nevojitet ndërhyrje
5- Shqetësime ekstreme, shumë problematike, nevojitet ndërhyrje e menjëhershme.

| Pikët | Pohimet | Komente |
|---|---|---|
| | Nxënësi has vështirësi në identifikimin e emocioneve të tij. | |
| | Nxënësi has vështirësi në shprehjen/verbalizimin e emocioneve të tij. | |
| | Nxënësi shfaq emocione jo në përshtatje me kontekstin. | |
| | Nxënësi nuk arrin të kuptojë emocionet e veta. | |
| | Nxënësi nuk i shfaq ose nuk i verbalizon ndjesitë kur është i mërzitur. | |
| | Nxënësi nuk e kupton arsyen e zemërimit. | |
| | Nxënësi has vështirësi në menaxhimin e emocioneve të veta. | |

| | | |
|---|---|---|
| | Nxënësi i përjeton me intensitet të lartë emocional, situatat e ndryshme. | |
| | Nxënësi shfaq ndjesi që nuk i kupton te vetja. | |
| | Nxënësi has vështirësi në reciprocitetin emocional (qesh kur tjetri është i mërzitur, nuk reagon kur tjetri gëzohet etj.). | |
| | Nxënësi e ka të vështirë të përshkruajë gjendjen emocionale të tjetrit, në situata të caktuara. | |
| | Nxënësi has vështirësi në ofrimin e mbështetjes emocionale për të tjerët. | |
| | **TOTALI** | |

**Rezultati**

Niveli minimal i pikëve është 12.

Niveli maksimal i pikëve është 60.

Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi i SHPS-ës vlerëson shprehitë emocionale të grupmoshës 12-15 vjeç.

# Shtojca 8: Lista e kontrollit për vlerësimin fillestar mbi problematika të humorit te fëmijët e grupmoshës 6-12 vjeç

**Lista e kontrollit për vlerësimin fillestar mbi problematika të humorit te fëmijët e grupmoshës 6-12 vjeç**

*Në përshkrimin e punës së tij, PSHPSSH-ja ka në fokus vlerësimin fillestar të situatës, për problematika të ndryshme të referuara/ identifikuara, hartimin e planeve ndërhyrëse dhe krijimin e marrëdhënieve bashkëpunuese, në funksion të mirëqenies së fëmijës dhe mbarëvajtjes së tij në shkollë dhe në shtëpi.*

*Kjo listë e kontrollit vjen në ndihmë të PSHPSSH-së, për të realizuar një vlerësim fillestar të situatës në të cilën gjendet nxënësi i referuar/identifikuar me problematika të humorit dhe mbi të cilën do të hartohet ndërhyrja në vazhdimësi të ndjekjes së rastit.*

Inicialet e nxënësit/Kodi_________________________________

Mosha:_______________________________________________

Gjinia:_______________________________________________

PSHPSSH: _____________________________________________

Data e vlerësimit: _____/_____/________

Arsyeja e vlerësimit:

_____________________________________________________________________________

_______________________________________________________________

Shkallët e matjes variojnë nga 1-5 (5 shumë shqetësuese dhe 1 asnjë shqetësim), si më poshtë:

1- Asnjë shqetësim
2- Shqetësim i vogël, rritje e vogël, nevojitet ndryshim

3- Pak shqetësim, nevojitet rritje dhe ndryshim
4- Shqetësime të rëndësishme, problematike, nevojitet ndërhyrje
5- Shqetësime ekstreme, shumë problematike, nevojitet ndërhyrje e menjëhershme.

| Pikët | Situata në të cilën ndodhet nxënësi | Komente |
|---|---|---|
| | Nxënësi shfaqet me nivel kritiketë lartë ndaj vetes, mërzitet kur bën gabime. | |
| | Nxënësi qan pa shkak konkret. | |
| | Nxënësi ndihet i palumtur. | |
| | Nxënësi ka vështirësi të mbledhë veten, edhe pas ndërhyrjeve mbështetëse nga i rrituri. | |
| | Te nxënësi vihen re mekanizma jo të përshtatshëm në përballjen me problemet. | |
| | Kalon kohë të konsiderueshme të ditës i/e mërzitur në shkollë. | |
| | Kalon kohë të konsiderueshme të ditës i/e mërzitur në shtëpi. | |
| | Nxënësi shfaqet i paqartë për qëllimet dhe për dëshirat e veta. | |
| | Nxënësi fokusohet në mendime të parëndësishme që i kalojnë nëpër mend, që shkaktojnë mërzitje tek ai/ajo. | |
| | Nxënësi shfaqet shumë vigjilent dhe i shqetësuar, në raport me shkollën, bashkëmoshatarët, familjen. | |
| | Nxënësi ndihet i pashpresë, i plogësht dhe me vetëvlerësim të ulët. | |
| | Nxënësi shprehet se është i frikësuar, por përpiqet të mos e shfaqë. | |
| | Nxënësi shqetësohet për gjëra të cilat nuk kanë ndodhur. | |
| | Nxënësi shfaq irritueshmëri dhe zemërim të tepruar. | |
| | Nxënësi referon problematika me gjumin (nevojë e madhe për gjumë ose pagjumësi). | |

| | | |
|---|---|---|
| | Nxënësi shprehet se ka disa ndjesi në stomak. | |
| | Nxënësi referon problematika me ushqimin. | |
| | Nxënësi shfaq mungesë dëshire, për t'u përfshirë në detyra të përshtatshme për moshën. | |
| | Nxënësi shfaqet hiperaktiv, përfshirje e tepërt në aktivitete që japin kënaqësi. | |
| | Nxënësi e ka të vështirë të ndjekë shpjegimin e mësuesit, për shkak të mbingarkesës emocionale. | |
| | **TOTALI** | |

**Rezultati**

Niveli minimal i pikëve është 20.

Niveli maksimal i pikëve është 100.

Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi i SHPS-ës vlerëson nivelin e riskut rrethproblematikave të humorit.

# Shtojca 9: Vlerësimi i riskut për vetëvrasje

*Në punën e tij të përditshme, PSHPSSH-ja përballet me raste të cilët shfaqin problematika të humorit dhe jo rrallë, të shoqëruara me mendime/tentativë për të lënduar veten. Arsyet mund të jenë të shumta dhe është me shumë rëndësi, vlerësimi i situatës për të kuptuar, nëse ky veprim/mendim ka si qëllim kërkimin e vëmendjes, mungesën e shpresës së fëmijës për të jetuar apo qëllime të tjera. Cilado qoftë arsyeja, nëse i rrituri gjendet përballë kësaj situate me fëmijën, në çdo rast duhet marrë në konsideratë.*

*Instrumenti i vlerësimit të riskut për vetëvrasje, i vjen në ndihmë PSHPSSH-së si një mënyrë efikase e vlerësimit fillestar të situatës, ndihmon për të përcaktuar riskun aktual të vetëvrasjes dhe mund të përdoret nga PSHPSSH-ja.*

Inicialet e nxënësit/Kodi:______________________________

Mosha:___________________________________________

Gjinia:___________________________________________

PSHPSSH: ________________________________________

Data e vlerësimit: _____/_____/________

Arsyeja e vlerësimit:_____________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

Shkallët e matjes për **faktorët e riskut** variojnë nga 1-5 (5 shumë shqetësuese dhe 1 asnjë shqetësim), si më poshtë:

1- Asnjë shqetësim
2- Shqetësim i vogël, rritje e vogël, nevojitet ndryshim
3- Pak shqetësim, nevojitet rritje dhe ndryshim
4- Shqetësime të rëndësishme, problematike, nevojitet ndërhyrje

5- Shqetësime ekstreme, shumë problematike, nevojitet ndërhyrje e menjëhershme.

Shkallët e matjes për **faktorët e mbrojtjes** variojnë nga 1-5 (1 shumë shqetësuese dhe 5 asnjë shqetësim), si më poshtë:

1- Shqetësime ekstreme, shumë problematike, nevojitet ndërhyrje e menjëhershme
2- Shqetësime të rëndësishme, problematike, nevojitet ndërhyrje
3- Pak shqetësim, nevojitet rritje dhe ndryshim
4- Shqetësim i vogël, rritje e vogël, nevojitet ndryshim
5- Asnjë shqetësim

| Pikët | | Komente |
|---|---|---|
| | **Faktorët e riskut** | |
| | Nxënësi ndihet i pashpresë. | |
| | Nxënësi ndihet i plogësht, pa fuqi, ka fjalor të varfër. | |
| | Mendonse çdo veprim i tij nuk çon në një rrugëzgjidhje. | |
| | Raportohen të qara pa shkak konkret. | |
| | Raportohen sjellje impulsive, agresive. | |
| | Raportohen/vëzhgohen dëmtime fizike, gërvishtje sipërfaqësore (ndrydhje, gjakrrjedhje). | |
| | Raportohen/vëzhgohen mbajtje të sendeve, ilaçeve në mjediset e shkollës, në shtëpi, si mënyrëpër të dëmtuar veten. | |
| | Nxënësi ka mendime për të lënduar veten. | |
| | Nxënësi ka një plan specifik për të lënduar veten. | |
| | Raportohen raste të përsëritura për të tilla problematika. | |
| | **TOTALI** | |
| | **Faktorët e mbrojtjes** | |
| | Identifikon arsye për të jetuar. | |

| | | |
|---|---|---|
| | Ndien se ka mbështetje nga familja. | |
| | Ka frikë nga vdekja për shkak të dhimbjes. | |
| | Besimi se vetëvrasja bie ndesh me parimet dhe me vlerat e shoqërisë. | |
| | Është pjesë e angazhimeve në aktivitetet e shkollës. | |
| | Nxënësi kërkon ndihmë tek i rrituri. | |
| | Nxënësi ka aftësi shprehëse emocionale. | |
| | **TOTALI** | |

**Pikëzimi**

- **Faktorët e riskut**

Niveli minimal i pikëve është **10;**

Niveli maksimal i pikëve është **50.**

- **Faktorët e mbrojtjes**

Niveli minimal i pikëve është **7;**

Niveli maksimal i pikëve është **35.**

**Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi i SHPS-ës vlerëson nivelin e riskut të sjelljeve vetëvrasëse.**

*Në momentin e vlerësimit fillestar të situatës, në rast identifikimi/referimi të tentativave për vetëvrasje, punonjësi i SHPSSH-së merr në konsideratë totalin e pikëve për faktorët mbrojtës dhe i përdor ato si pikë e fortë në punën me fëmijën. Punonjësi në këtë rast, vlerëson pozitivisht mbledhjen e sa më shumë pikëve në këtë sesion.

# Shtojca 10: Inventari i depresionit i Beck-ut

Emri: ________________

Mosha:_____________

**Udhëzim**

*Ky pyetësor konsiston në 21 pohime dhe zbatohet për nxënës 13-18 vjeç. Nxënësi të lexojë me vëmendje dhe për çdo grup pohimesh, të përzgjedhë pohimin brenda secilës çështje që përshkruan më saktë mënyrën se si ata janë ndjerë, përgjatë 2 javëve të fundit, përfshirë ditën e sotme (kur zhvillohet inventari).*

*Nxënësit duhet të qarkojnë numrin përkrah pohimit të përzgjedhur. Nëse brenda së njëjtës çështje, janë disa pohime të vërteta të barasvlershme, atëherë ata duhet të qarkojnë numrin më të lartë për atë grup. Nxënësit nuk duhet të zgjedhin më shumë se një pohim për çështje.*

| | | |
|---|---|---|
| 1. Trishtimi | 0 | Nuk ndihem i trishtuar. |
| | 1 | Ndihem i trishtuar. |
| | 2 | Ndihem i trishtuar gjatë gjithë kohës dhe nuk lirohem dot nga kjo gjendje. |
| | 3 | Jam kaq i trishtuar e i palumtur, saqë nuk mund ta duroj dot. |
| | | |
| 2. Pesimizmi | 0 | Nuk më dekurajon e ardhmja. |
| | 1 | Ndihem i dekurajuar nga e ardhmja. |
| | 2 | Ndiej se nuk pres gjë nga e ardhmja. |
| | 3 | E ndiej se e ardhmja është pa shpresë dhe se gjërat nuk mund të përmirësohen. |
| | | |
| 3. Dështimi i së shkuarës | 0 | Nuk ndiej të jem i dështuar. |
| | 1 | E ndiej se kam dështuar më shumë se një person i zakonshëm. |

| | | |
|---|---|---|
| | 2 | Kur i hedh një vështrim prapa jetës sime, shikoj dështime të shumta. |
| | 3 | E ndiej se jam tërësisht i dështuar si person. |
| | | |
| 4. Pakënaqësia | 0 | Marr po aq kënaqësi, sa më parë, nga gjërat që më pëlqejnë. |
| | 1 | Nuk më shijojnë më gjërat, sa më parë. |
| | 2 | Marr fare pak kënaqësi nga gjërat që më parë më pëlqenin. |
| | 3 | Jam i pakënaqur dhe i mërzitur nga çdo gjë. |
| | | |
| 5. Ndjenjat e fajit | 0 | Nuk e ndiej veten fajtor. |
| | 1 | Ndihem fajtor pjesën më të mirë të kohës. |
| | 2 | Ndihem fajtor shumicën e kohës. |
| | 3 | Ndihem fajtor gjithë kohën. |
| | | |
| 6. Ndjenjat e ndëshkimit | 0 | Nuk ndiej se jam ndëshkuar. |
| | 1 | E ndiej se mund të kem qenë i ndëshkuar. |
| | 2 | Pres të ndëshkohem. |
| | 3 | E ndiej se jam duke u ndëshkuar. |
| | | |
| 7. Pakënaqësia ndaj vetes | 0 | Ndihem po njëlloj ndaj vetes. |
| | 1 | E kam humbur besimin te vetja. |
| | 2 | Jam i zhgënjyer nga vetja. |
| | 3 | E përbuz veten. |
| | | |
| 8. Kritikat ndaj vetes | 0 | Nuk e kritikoj ose e nuk e fajësoj veten, më shumë se zakonisht. |
| | 1 | Jam më kritik ndaj vetes, sesa kam qenë më përpara. |
| | 2 | E kritikoj veten për të gjitha gabimet e mia. |
| | 3 | E fajësoj veten për çdo gjë të keqe që ndodh. |
| | | |

| | | |
|---|---|---|
| 9. Mendimet ose dëshirat për vetëvrasje | 0 | Nuk kam pasur ndonjë mendim për të vrarë veten. |
| | 1 | Kam menduar të vras veten, por s'do ta bëj. |
| | 2 | Do të doja ta vrisja veten. |
| | 3 | Do ta vras veten, nëse më jepet rasti. |
| | | |
| 10. Të qarët | 0 | Nuk qaj më shumë, sesa më përpara. |
| | 1 | Tani qaj më shumë, se më parë. |
| | 2 | Qaj edhe për gjërat më të vogla. |
| | 3 | Kam nevojë të qaj, por nuk qaj dot. |
| | | |
| 11. Shqetësimi | 0 | Nuk ndihem më i shqetësuar apo i irrituar se zakonisht. |
| | 1 | Ndihem më i shqetësuar apo i irrituar se zakonisht. |
| | 2 | Jam kaq i shqetësuar e i irrituar, saqë e kam të vështirë të qëndroj pa lëvizur. |
| | 3 | Jam kaq i shqetësuar e i irrituar, saqë më duhet patjetër të lëviz apo të bëj diçka. |
| 12. Mungesa e interesit | 0 | Nuk e kam humbur interesin për njerëzit dhe për aktivitetet. |
| | 1 | Jam më pak i interesuar për njerëzit dhe për aktivitetet, sesa më përpara. |
| | 2 | Përgjithësisht, e kam humbur interesin për njerëzit dhe për aktivitetet. |
| | 3 | E kam shumë të vështirë të interesohem për ndonjë gjë. |
| | | |
| 13. Pavendosmëria | 0 | I marr vendimet po aq mirë, sa dhe më parë. |
| | 1 | E kam më të vështirë të marr vendime se zakonisht. |
| | 2 | Kam më shumë vështirësi në marrjen e vendimeve se më parë. |
| | 3 | E kam thuajse të pamundur të marr vendime. |

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| 14. Ndjesia e të qenit i dobishëm | 0 | Nuk mendoj se jam i pavlefshëm. |
| | 1 | Nuk e quaj veten aq të vlefshëm e të dobishëm, sa më përpara. |
| | 2 | Ndihem më pak i dobishëm se njerëzit e tjerë. |
| | 3 | Ndihem tërësisht i padobishëm. |
| | | |
| 15. Mungesa e energjive | 0 | Kam po aq energji, sa më parë. |
| | 1 | Kam më pak energji se më parë. |
| | 2 | Nuk kam mjaftueshëm energji, për të bërë gjërat që duhet të bëj. |
| | 3 | Nuk kam energji për të bërë thuajse asgjë. |
| | | |
| 16. Ndryshime të gjumit | 0 | Nuk kam asnjë ndryshim në gjumë. |
| | 1 | A. Fle diçka më shumë se zakonisht.<br><br>B. Fle diçka më pak se zakonisht. |
| | 2 | A Fle shumë më shumë se zakonisht.<br><br>B. Fle shumë më pak se zakonisht. |
| | 3 | A. Fle pjesën më të madhe të ditës.<br><br>B. Zgjohem 1-2 orë përparadhe nuk fle dot më. |
| | | |
| 17. Nervozizmi | 0 | Nuk jam më i nervozuar se zakonisht. |
| | 1 | Jam më i nervozuar se zakonisht. |
| | 2 | Jam shumë i nervozuar. |
| | 3 | Jam i nervozuar gjithë kohës. |
| | | |
| 18. Ndryshime të oreksit | 0 | Oreksin e kam njëlloj si më parë. |
| | 1 | A Kam më pak oreks se më parë. |

| | | |
|---|---|---|
| | | B. Kam më shumë oreks se më parë. |
| | 2 | A Kam shumë më pak oreks se më parë.<br><br>B. Kam shumë më shumë oreks se më parë. |
| | 3 | A Më ka humbur fare oreksi.<br><br>B. E kam mendjen tek të ngrënët, gjatë gjithë kohës. |
| | | |
| 19. Vështirësi për t'u përqendruar | 0 | Përqendrohem po aq sa zakonisht. |
| | 1 | E kam më të vështirë të përqendrohem se zakonisht. |
| | 2 | E kam të vështirë të mbaj mendjen te ndonjë gjë, për një kohë të gjatë. |
| | 3 | Me duket se nuk mund të përqendrohem dot fare. |
| | | |
| 20. Lodhja | 0 | Nuk ndihem më i lodhur se zakonisht. |
| | 1 | Lodhem më shpejt se më parë. |
| | 2 | Ndihem shumë i lodhur, për të bërë shumë nga gjërat që më parë i bëja. |
| | 3 | Ndihem aq i rraskapitur, sa mund të bëj shumë pak. |
| | | |
| 21. Mungesa e interesit ndaj seksit | 0 | Nuk kam vënë re ndryshime në interesin ndaj seksit. |
| | 1 | Më shkon më pak mendja te seksi. |
| | 2 | Jam shumë më pak i/e interesuar për seksin tani. |
| | 3 | E kam humbur fare interesin ndaj seksit. |

**INTERPRETIMI I TESTIT TË DEPRESIONIT**

Mblidh pikët e 23 pyetjeve, në bazë të përgjigjeve të qarkuara. Totali më i madh i pikëve është 63 pikë. Kjo do të thotë që janë qarkuar të gjitha përgjigjet e fundit. Pikëzimi më i vogël është 0. Do të vlerësoni shkallën e depresionit, në bazë të tabelës.

**Totali i pikëve** **Niveli i depresionit**

| | | |
|---|---|---|
| I ulët | 1-10 | Ulje dhe ngritje normale |
| | 11-16 | Shqetësim i lehtë |
| I moderuar | 17-20 | Depresion në kufi (mbahet në vëzhgim) |
| | 21-30 | Nivel i moderuar depresioni |
| I rëndësishëm | 31-40 | Depresion i rëndë |
| | Mbi 40 | Depresion i thellë |

# Shtojca 11: GAD-7 (instrument për vlerësimin e ankthit)

| **Gjatë 2 javëve të fundit, sa shpesh ju kanë shqetësuar problemet e mëposhtme?** | Asnjë herë | Disa ditë | Më shumë se gjysma e ditëve | Pothuajse çdo ditë |
|---|---|---|---|---|
| 1. Jeni ndjerë nervoz(e), i/e shqetësuar ose i/e trazuar | 0 | 1 | 2 | 3 |
| 2. Nuk keni qenë në gjendje të ndaloni ose të kontrolloni shqetësimin | 0 | 1 | 2 | 3 |
| 3. Shqetësoheni shumë për gjëra të ndryshme | 0 | 1 | 2 | 3 |
| 4. Keni vështirësi të çlodheni | 0 | 1 | 2 | 3 |
| 5. Jeni kaq të shqetësuar sa e keni vështirë të qëndroni në një vend | 0 | 1 | 2 | 3 |
| 6. Jeni zemëruar ose irrituar lehtë | 0 | 1 | 2 | 3 |
| 7. Ndiheni të frikësuar sikur do të ndodhte diçka e tmerrshme | 0 | 1 | 2 | 3 |
| | Totali: | | | |

Pikëzimi GAD

- 0-4 pikë nivel minimal i ankthit
- 5-9 pikë nivel i lehtë i ankthit
- 10-14 pikë nivel i ankthit të moderuar
- 15-21 pikë nivel shumë i lartë i ankthit

Nëse keni shenjuar disa nga shqetësimet, sa të vështirë e kanë bërë këto shqetësime angazhimin tuaj në rutinat e përditshme?

- Aspak të vështirë - Pak të vështirë - Mesatarisht të vështirë - Shumë të vështirë

# Shtojca 12: Intervistë e strukturuar për vlerësimin e simptomave të traumës

*Duke iu referuar intervistës së strukturuar, punonjësi i SHPS-së mund të mbështetet për të mbledhur informacion, në lidhje me simptomat e përjetuara gjatë javës së fundit. Intervista e strukturuar e simptomave të traumës, përdoret si një ndër format për mbledhjen e informacionit dhe përshtatet në varësi të moshës së nxënësit.*

| | |
|---|---|
| 1 | A keni pasur ndjenja/mendime se ngjarja do të ndodhë përsëri? |
| 2 | A keni pasur shqetësime gjatë gjumit (pagjumësi, gjumë i tepruar, makthe etj.)? |
| 3 | A ju ka humbur dëshira për t'u përfshirë në aktivitete që keni pëlqyer më parë? |
| 4 | A ndieni se jeni më shumë vigjilent se zakonisht, ndaj situatave? |
| 5 | A i përjetoni njësoj si më parë, emocionet pozitive dhe negative? |
| 6 | A e keni gjetur veten, duke shmangur ngjarje të cilat ju rikujtojnë situatën e dhimbshme? |
| 7 | A mendoni se jeni fajtor për atë që ju ka ndodhur? |
| 8 | A ndiheni shumë të lodhur dhe të rraskapitur? |
| 9 | A e keni të vështirë t'u besoni të tjerëve? |
| 10 | A ndieni vështirësi për të kryer aktivitetet e jetës së përditshme? |

# Shtojca 13: Vetëvlerësimi te fëmijët (arsimi fillor)

*Instrumenti përdoret nga punonjësi i SHPS-së, për të vlerësuar dhe për të matur nivelin e vetëvlerësimit te fëmijët e arsimit fillor.*

GJINIA: F M

MOSHA: _________

KLASA: __________

| Pohimet | Jam dakord<br><br>1 | Ndonjëherë<br><br>2 | Nuk jam dakord<br><br>3 |
|---|---|---|---|
| 1.Unë nuk kam shumë shokë në shkollë. | | | |
| 2.Mua shpesh më ngacmojnë. | | | |
| 3.Fëmijëve të tjerë iu pëlqen të luajnë me mua. | | | |
| 4.Unë jam personi të cilin i drejtohen për ndihmë, kur janë në telashe. | | | |
| 5.Kam ndjesinë se shokët e klasës nuk do të më zgjidhnin për kujdestar. | | | |
| 6.Askush nuk më kushton shumë rëndësi në shtëpi. | | | |
| 7.Unë jam një person shumë i rëndësishëm në familje. | | | |
| 8.Prindërit e mi ndiejnë se unë mund të mbështetem tek ata. | | | |
| 9.Unë shpesh ndihem i padëshiruar në shtëpi. | | | |
| 10.Prindërit e mi janë krenarë për mua. | | | |
| 11.Unë jam një person i rëndësishëm në klasën time. | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 12.Mësuesja ime pret gjëra të mëdha prej meje. | | | |
| 13.Gjithmonë bëj përpjekjet maksimale me detyrat e mia. | | | |
| 14.Puna në shkollë është më e vështirë për mua, se sa për pjesën tjetër. | | | |
| 15.Mësuesja ime është zakonisht e kënaqur me punën që unë bëj. | | | |
| **TOTALI** | | | |

**Rezultati:**

Lista e kontrollit është e shkallëzuar numerikisht, duke përdorur 1, 2 dhe 3, si më poshtë:

1- i ulët
2- mesatar
3- tregues i lartë.

Rezultati më i ulët i mundshëm është **15** dhe më i larti është **45.**

**Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi i SHPS-së vlerëson nivelin e vetëvlerësimit.**

# Shtojca 14: Instrumenti i vetëvlerësimit

*Instrumenti i vetëvlerësimit përdoret për nxënësit e grupmoshës 13-18 vjeç. Nxënësit duhet të lexojnë me kujdes pohimet dhe të zgjedhin një nga shkallët që i përshtatet.*

Shkalla e pohimeve:

1-Nuk pajtohem

2- Pajtohem rrallë

3- Neutral

4-Pajtohem pak

5-Pajtohem shumë.

GJINIA: F M MOSHA:_________

| POHIMI | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.Kam një person të veçantë që e kam afër kur kam nevojë. | | | | | |
| 2.Kam një person të veçantë me të cilin ndaj gjithmonë gëzimet dhe hidhërimet e mia. | | | | | |
| 3. Familja ime ndihet e lodhur, duke më ndihmuar mua. | | | | | |
| 4.Unë, kur kam nevojë për ndihmë emocionale, kam mbështetje nga familja ime. | | | | | |
| 5. Unë kam një person të veçantë, i cili më krijon vërtet rehati. | | | | | |
| 6. Shoku/shoqja ime përpiqet vërtet të më ndihmojë. | | | | | |
| 7.Unë mund të mbështetem te miqtë e mi, kur gjërat më shkojnë keq. | | | | | |
| 8.Unë flas me familjen time për problemet e mia. | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 9.Unë kam miq me të cilët i ndaj gëzimet dhe hidhërimet e mia. | | | | | |
| 10.Në jetën time ka një person të veçantë që kujdeset për ndjenjat e mia. | | | | | |
| 11.Në vendimet e mia, familja ime është e gatshme të më ndihmojë. | | | | | |
| 12.Unë flas me miqtë e mi për problemet e mia. | | | | | |
| **TOTALI** | | | | | |

**Rezultati**

Niveli minimal i pikëve është 12.

Niveli maksimal i pikëve është 60.

Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi i SHPS-së vlerëson nivelin e vetëvlerësimit.

*Më poshtë, janë disa tipare të personalitetit, që mund të aplikohen ose jo te nxënësit. Ata duhet të zgjedhin një numër për çdo pohim.

Shkalla e pohimeve:

1-Nuk pajtohem

2- Pajtohem rrallë

3- Neutral

4-Pajtohem pak

5-Pajtohem shumë.

**E shoh veten time si:**

1. ________Ekstrovert, entuziast.

2. ________Njeri që bëj sherre, kritik.
3. ________I besueshëm, i disiplinuar.
4. ________Nervoz (në ankth),lehtësisht i acaruar.
5. ________I hapur ndaj përvojave të reja, i ndërlikuar.
6. ________I përmbajtur, i qetë (rri urtë).
7. ________Simpatik (miqësor), i ngrohtë (i afrueshëm).
8. ________I paorganizuar, i pakujdesshëm.
9. ________I qetë, i qëndrueshëm në emocione.

10.________Konvencional, jo krijues.

**Rezultati**

Bazuar nga pohimet që nxënësit janë pajtuar plotësisht, ata mund të dallojnë disa karakteristika të personalitetit të tyre.

**SHKALLA E VETËVLERËSIMIT**

| EMRI | VENDLINDJA |
|---|---|
| GJINIA | SHKOLLA |
| MOSHA | KLASA |

Shkalla e pohimeve:

1. Nuk është aspak e vërtetë
2. Është pak e vërtetë
3. Është shumë e vërtetë.

Nxënësi duhet të vendosi X, në kolonën që përshkruan më mirë ndjenjat e tyre.

| NR | POHIMI | ASPAK | PAK | SHUMË |
|---|---|---|---|---|
| **1.** | Jam një person që ia vlej. | | | |
| 2. | Jam besnik. | | | |
| 3. | Shpreh mendimin tim, vetëm kur kam të drejtë. | | | |
| 4. | Jam i qetë dhe i relaksuar. | | | |
| 5. | Jam i këndshëm me të tjerët. | | | |
| 6. | Më pëlqen mënyra sesi sillem me të tjerët. | | | |
| 7. | Ndiej se kam kontroll mbi veprimet e mia. | | | |
| 8. | Kam sens të mirë humori. | | | |
| 9. | Jam një njeri i lumtur. | | | |
| 10. | Jam një njeri i ndershëm. | | | |
| 11. | Më pëlqen të ndihmoj të tjerët. | | | |
| 12. | Jam i/e kënaqur me arritjet e mia të tanishme. | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 13. | Jam një njeri bujar. | | | |
| 14. | Përgjithësisht u pëlqej të tjerëve. | | | |
| 15. | Njerëzve iu pëlqej kur rri me ta. | | | |
| 16. | Njerëzit më thonë problemet e tyre. | | | |
| 17. | Njerëzit besojnë tek unë. | | | |
| 18. | Zakonisht, kam një gjykim të drejtë mbi njerëzit. | | | |
| 19. | Njerëzit mendojnë se jam i sinqertë në atë që them. | | | |
| 20 | Njerëzit mendojnë se mund të mbështeten tek unë. | | | |
| 21. | Shokët e mi më vlerësojnë. | | | |
| 22 | Njerëzve në shkollë iu pëlqej. | | | |
| 23 | Familja më vlerëson. | | | |
| 24 | Më pëlqen shkolla. | | | |
| 25 | Më pëlqen mënyra sesi jam. | | | |
| 26 | Kam besim te njerëzit. | | | |
| 27 | Ndiej se jam inteligjent. | | | |
| 28 | Aftësia ime për të lexuar është e kënaqshme. | | | |
| 29 | Kam njohuri të mjaftueshme për ngjarjet e fundit. | | | |
| 30 | Jam i kënaqur për atë që kam mësuar deri tani në shkollë. | | | |
| 31. | Mund të reagoj mirë ndaj kritikave. | | | |
| 32 | Jam i aftë të dua të tjerët. | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 33. | Jam shok i mirë për të tjerët. | | | |
| 34. | Zakonisht, shikoj anën e mirë të gjërave. | | | |
| 35. | Më pëlqen mënyra sesi reagoj në situatat me shoqërinë. | | | |

**Rezultati**

Niveli minimal i pikëve është 36.

Niveli maksimal i pikëve është 99.

Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi i SHPS-ës vlerëson nivelin e vetëvlerësimit.

# Shtojca 15: vlerësimi i varësisë nga interneti

*Lisat e kontrollit për varësinë nga interneti, përdoret nga punonjësit e SHPS-ës, për të matur dhe për të vlerësuar kohën e shpenzuar në internet nga nxënësit. Nxënësit duhet të zgjedhin për çdo pohim, një nga alternativat e më poshtme.*

Emër/Mbiemër: ____________

Mosha: ___________________

Klasa: ____________________

Data: _____/_____/________

Alternativat:

1- Asnjëherë
2- Rrallë
3- Ndonjëherë
4- Shpesh
5- Gjithmonë.

| | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Përdor telefonin ose tabletën më tepër sesa më nevojitet. | | | | | |
| 2. Më pëlqen të qëndroj në telefon ose në kompjuter, sesa të flas me të tjerët përreth. | | | | | |
| 3. Më shumë shpenzoj kohë në telefon, sesa mund të ndihmoj të tjerët në shtëpi. | | | | | |
| 4. Performanca në shkollë ndikon nga koha që shpenzoj në internet. | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 5. Persona rreth meje, janë të shqetësuar për kohën që unë kaloj në internet. | | | | | |
| 6. Kur më pyesin se çfarë bëj online, unë preferoj të mos përgjigjem. | | | | | |
| 7. Vëmendja dhe përqendrimi im ndikojnë nga sasia e kohës që harxhoj në internet. | | | | | |
| 8. Kontrolloj rrjetet sociale, mesazhet, sapo zgjohem në mëngjes. | | | | | |
| 9. Bezdisem, sa herë të tjerët më ndërpresin, ndërkohë që po përdor telefonin ose kompjuterin. | | | | | |
| 10. Ndihem në ankth, sa herë që nuk kam telefonin me vete. | | | | | |
| 11. E përdor internetin, për të shmangur kontaktin me të tjerët rreth meje. | | | | | |
| 12. Do të isha më pak interesant/e dhe i/e lumtur, pa internetin. | | | | | |
| 13. Harroj të bëj shumë detyra, punë që kam për të bërë, sepse jam në internet. | | | | | |
| 14. Kur nuk mund të kem telefonin me vete, mendoj shpesh, se çfarë do të isha duke bërë, po të isha online. | | | | | |
| 15. Qëndroj deri vonë në darkë, sepse jam online. | | | | | |
| 16. Do të më pëlqente më shumë të rrija në shtëpi, duke përdorur internetin, sesa të dilja me shokët. | | | | | |
| 17. Jam përpjekur të pakësoj përdorimin e telefonit dhe tëkompjuterit. | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 18. Shqetësohem kur nuk arrij dot të kontrolloj telefonin dhe të di se çfarë po ndodh në internet. | | | | | |
| **TOTALI** | | | | | |

**Rezultati**

Niveli minimal i pikëve është 18.

Niveli maksimal i pikëve është 90.

Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi SHPS-së vlerëson nivelin e varësisë nga interneti.

# Shtojca 16: lista e kontrollit për duhanin grupmosha 13-18 vjeç

*Kjo listë e kontrollit shërben për të kuptuar nivelin e varësisë. që mund të kenë nxënësit, ndaj përdorimit të duhanit.*

*Plotësohet nga punonjësi i shërbimit psiko-social, për të realizuar një vlerësim fillestar.*

*Në bazë të vëzhgimeve, përgjatë qëndrimit të nxënësit në mjedise të shkollës, të referimeve/raportimeve të mësuesve/oficerit të sigurisë/bashkëmoshatarëve, të intervistës me nxënësin, punonjësit e shërbimit psiko-social mbështeten në listën e kontrollit të mëposhtme, për të vlerësuar dhe për të dokumentuar, riskun që ka nxënësi ndaj nikotinës.*

5.Shqetësime ekstreme, shumë problematike, nevojitet ndërhyrje e menjëhershme.

4.Shqetësime të rëndësishme, problematike, nevojitet ndërhyrje.

3.Pak shqetësim, nevojitet rritje dhe ndryshim.

2.Shqetësim i vogël, rritje e vogël, nevojitet ndryshim.

1.Nuk ekziston shqetësim.

| **Pikët** | **Pohimet** | **Komente** |
|---|---|---|
| | Nxënësi pohon se ka varësi ndaj duhanit. | |
| | Nxënësi shfaq dëshira të forta për të pirë cigare, duke cenuar procesin mësimor. | |
| | Nxënësi e sheh pirjen e duhanit, si një metodë qetësimi, në situata me intensitet të lartë emocional apo negative. | |

| | | |
|---|---|---|
| | Nxënësi e ka të vështirë të qëndrojë pa pirë cigare edhe në mjediset e shkollës apo në ambientet ku ndalohet duhani. | |
| | Nxënësi shoqërohet nga bashkëmoshatarë konsumues të duhanit. | |
| | Nxënësi rrethohet nga bashkëmoshatarë ose familjarë, të cilët nuk e tolerojnë konsumimin e duhanit. | |
| | Nxënësi e ka të vështirë t'i thotë "jo", ofrimit të një cigareje nga të tjerët. | |
| | Nxënësi është i vetëdijshëm për dëmin që mund të shkaktojë pirja e duhanit, por vazhdon dhe e konsumon. | |
| | Nxënësi shfaq shenja nervozizmi, në raste kur nuk konsumon duhan, për një kohë të shkurtër. | |
| | Nxënësi e ka të vështirë të përqendrohet në një aktivitet ose në orë mësimore, nëse nuk ka konsumuar një cigare më parë. | |
| | Te nxënësi janë të pranishme ndjenjat e fajit, për shkak të pirjes së duhanit nga ai. | |
| | Nxënësi e konsideron veten të rritur dhe konsumimi i cigares është një veprim prej të rriturish. | |
| | **TOTALI** | |

**Rezultati**

Niveli minimal i pikëve është 12

Niveli maksimal i pikëve është 60

Në bazë të totalit të pikëve të grumbulluara, punonjësi i SHPS-ës vlerëson nivelin e varësisë ndaj duhanit.

# Shtojca 17: Vështirësitë në të nxënë

*Shtojca 16 përmban disa lista të kontrollit, për t'u përdorur nga punonjësit e SHPS-ës, gjatë punës në shkollë. Kur punonjësi SHPS-ës identifikon ose/dhe i referohet një problematike, në lidhje me nxënësin, nga mësuesi, nga prindi apo nga çdo aktor tjetër, ai kryen vëzhgime të nxënësit për një periudhë 2-javore (vlerësimi i parë) dhe të shtrirë në një hark kohor, nga 1-6 muaj, për të verifikuar problematikat që mund të lidhen me vështirësitë në të nxënë. Punonjësi i SHPS-së nuk del në një diagnozë, por mbështetet te këto materiale, për të identifikuar dhe për të verifikuar problematikat që lidhen me vështirësitë e të nxënit. Pasi punonjësi i SHPS-ës vlerëson vështirësitë e nxënësit bën referimin sipas nevojës te specialisti përkatës. Gjithashtu harton ndërhyrjet e nevojshme brenda kontekstit shkollor në bashkëpunim me mësuesin, me prindin, dhe çdo aktor tjetër.*

*Listat e kontrollit të mëposhtme janë referuar materialit të përgatitur nga organizata Save The Children, me titull "Instrumentet e diagnostikimit të çrregullimeve neuro-zhvillimore, te fëmijët e moshës 5-10 vjeç", 2016.*

## Çrregullimet gjuhësore

### Shkalla e vlerësimit për çrregullimet gjuhësore

*Formati i listës së kontrollit për verifikimin e çrregullimeve gjuhësore, përdoret nga punonjësi i SHPS-së, për të vlerësuar problematikën, lidhur me çrregullimet gjuhësore. Shkalla e vlerësimit bëhet, referuar tabelës më poshtë:*

| | |
|---|---|
| **4** | Nxënësi zotëron shprehinë. |
| **3** | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë. |
| **2** | Shprehia është në formim e sipër. |
| **1** | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë. |

| Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V | Lista e kontrollit për verifikimin e çrregullimeve gjuhësore<br><br>(përzgjidh shprehitë që vlerësohen te nxënësi, shëno nivelin, duke përdorur shkallën më sipër) | Matja 1Data: | Matja 2Data: | Matja3 Data: | Komente |
|---|---|---|---|---|---|
| Fjalor i varfër |  Përdor foljet që tregojnë veprime<br><br> Tregon emrin, datën, adresën, familjarët<br><br> Përsërit fjalë me më shumë se 3 rrokje<br><br> Tregon nevojat e tij<br><br> Përshkruan emocionet tek të tjerët<br><br> Krijon dhe shpreh mendim të pavarur<br><br> Tregon një ngjarje reale<br><br> Riprodhon një pjesë të lexuar/dëgjuar | | | | |
| TOTALI | | / | | | |
| Strukturë e varfër e fjalive |  Ndërton fjali të thjeshta<br><br> Ndërton fjali të përbëra (me 2 ose më | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | shumë pjesë)<br><br> Vendos theksin logjik të fjalisë ku duhet<br><br> Ruan strukturën e fjalisë gjatë të folurit<br><br> Këmben vendin e fjalëve në fjali sipas nevojës<br><br> E kthen fjalinë në trajta pyetëse dhe mohore | | | | |
| TOTALI | | / | / | / | |
| Çrregullime të bashkëbisedimit | Fillon bashkëbisedimin<br><br> Kakontakt me sy me bashkëfolësin<br><br> Pret radhën të flasë<br><br> U përgjigjet pyetjeve<br><br> Pyet bashkëbiseduesin me interes<br><br> Qëndron në bashkëbisedim, aq sa është e nevojshme<br><br> Ndahet pa problem nga bashkëbiseduesi | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Paaftësi për të komunikuar përmes gjuhës | • Përdor gjuhën për të shprehur mendimet<br>• Përdor gjuhën për të shprehur nevojat<br>• Përdor gjuhën për të treguar emocionet<br>• Përdor gjuhën për të kërkuar<br>• Përdor gjuhën për të kundërshtuar<br>• Përdor gjuhën për t'u ankuar<br>• Përshtat fjalorin, intonacionin, strukturën | | | | |
| TOTALI | | / | / | / | |
| Mungesë e pjesëmarrjes në grup apo e shoqërimit me të tjerë | • Ulet pranë të tjerëve<br>• Kërkon të marrë pjesë në grup<br>• Diskuton në grup<br>• Ndjek rregullat e punës në grup<br>• Luan me të tjerët në pushim<br>• Kupton qëllimet e të tjerëve në grup<br>• Përshtat reagimin në grup | | | | |
| TOTALI | | / | / | / | |
| Mungesë e arritjeve akademike | • Pëlqen mësimin dhe detyrat<br>• Punon i pavarur për të kryer detyrat në shkollë | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | • Kryen detyrat në kohë<br>• Është krenar për arritjet personale<br>• Ka interes të zgjerojë njohuritë<br>• Është i pavarur dhe krijues<br>• Ndan me të tjerët atë që di | | | | |
| TOTALI | | / | / | / | |
| KRITERET | | / | / | / | |

**Shkalla e vlerësimit për çrregullimet e të folurit:**

*Formati i listës së kontrollit, për verifikimin e çrregullimeve të të folurit, përdoret nga punonjësi i SHPS-ës, për të vlerësuar problematikën lidhur me çrregullimet e të folurit. Shkalla e vlerësimit bëhet, referuar tabelës më poshtë:*

| | |
|---|---|
| **4** | Nxënësi zotëron shprehinë. |
| **3** | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë. |
| **2** | Shprehia është në formim e sipër. |
| **1** | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë. |

| **Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V** | Lista e kontrollit për verifikimin e çrregullimevetë të folurit<br><br>(përzgjidh gjithçka që vëren te nxënësi, trego nivelin, duke përdorurshkallën më sipër) | **Matja1**<br><br>Data: | **Matja 2**<br><br>Data: | **Matja 3**<br><br>Data: | **Komente** |
|---|---|---|---|---|---|
| Paaftësi në prodhimin e tingujve | □ Artikulon zanoret (fonemat)<br>□ Artikulon bashkëtingëlloret (fonemat)<br>□ Artikulon diftongje<br>□ Vendos bashkëtingëllore pranë zanoreve<br>□ Artikulon fjalë me 2-3 bashkëtingëlloreradhë | | | | |
| TOTALI | | | | | |
| Paaftësi në artikulimin e fjalëve | □ Ndërton fjali të thjeshta<br>□ Ndërton fjali të përbëra (me 2 ose mëshumë pjesë)<br>□ Artikulon fjali me intonacionin e duhur<br>□ Përdor pjesët e fjalisë në format eduhura | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
